



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 DHE 19 TETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. I 19. OKTOBRA 2012. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Predlog-Rezolucije o normalizaciji odnosa između Republike Kosova i Republike Srbije,
5. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji amandmana članova Sporazuma Medjunarodnog monetarnog fonda o reformi Izvršnog borda,
6. Razmatranje N/zakona o povećanju kvote Republike Kosova u Medjunarodnom monetarnom fondu,
7. Prvo razmatranje N/zakona o radovima od dragocenih metala,
8. Drugo razmatranje N/zakona o stavljanju van snage članova 37, 38 i 39. Krivičnog kodeksa Republike Kosova,
9. Drugo razmatranje N/zakona o zaštiti potrošača,
10. Razmatranje Izveštaja rada Centralne izborne komisije, za 2011.godinu.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, e shoh të nevojshme, të nderuar deputetë, të ju bëj me dije ju dhe Kabinetit qeveritar: Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pushtetet janë të ndara. Në Kosovë është vendosur rendi demokratik dhe për këtë krenohemi të gjithë. Nuk jemi këtu për të duartrokitur asnjë veprim policor.

Sot, në mëngjes, policia ka hyrë, nuk e di me urdhrin e kujt, në hapësirat e Kuvendit, pa e njoftuar kryetarin e Kuvendit. Ia bëj me dije Kabinetit qeveritar dhe ministrit që ka urdhëruar: Parlamenti drejtohet nga kryetari i tij dhe pa urdhrin e tij nuk guxon askush, asnjë njësiti policor, të hyjë në Kuvend, prandaj kërkoj nga Kabineti qeveritar, kryeministri dhe ministri, që të mos i keqpërdorin ata djem dhe vajza që janë për ta mbrojtur demokracinë, për ta mbrojtur lirinë dhe për ta mbrojtur dinjitetin e vet dhe dinjitetin e institucioneve të Kosovës.

Të mos i përdorim ata djem dhe vajza për interesa private të askujt, dhe askush s'ka drejtë t'i përdorë ata për interesa private. Ju e dini se kjo ndërtesë shpeshherë është rrethuar nga forca policore dhe deputetët janë detyruar të marrin vendime jashtë tij. Ju gjithashtu e dini se ne, për ta mbrojtur lirinë dhe demokracinë në këtë vend, kemi marrë nga 10 e më shumë vjet burg. Natyrisht, që ne kemi pas humbur atëherë, por e kemi pasur një humbje me dinjitet, se kemi qenë të bindur se jemi në të drejtën tonë, duke e mbrojtur lirinë tonë dhe demokracinë e vendit dhe të popullit tonë dhe humbës kanë qenë ata që kanë ardhur këtu dhe janë detyruar të shkojnë andej.

Ky vend nuk ka nevojë për dhunë policore, as për forcë policore, as shef policor. Ky vend ka nevojë për drejtësi, e drejtësinë nuk e bën Bajram Rexhepi, që dëshiron t'i burgosë edhe Presidentin, edhe kryetarin e Parlamentin, edhe të gjithë. Kush ia dha atë të drejtë? Edhe një herë po them: Kosova i ka institucionet e veta të ndara, i ka pushtetet e ndara, e ka edhe institucionin, i cili e merr përgjegjësinë nëse rrezikohet siguria, se si merret ajo. Një ministër nuk mund ta urdhërojë asnjë polic të hyjë në Kuvendin e Kosovës. Kjo dihet. Prandaj, është momenti i fundit që njerëzit që e kanë këtë përgjegjësi të japin përgjegjësi, përndryshe me policë brenda, që s'dihet kush i ka urdhëruar, me policë që e kanë rrethuar, s'di me çfarë urdhri e me çfarë arsye, ndërtesën e Kuvendit; Kuvendi nuk mund ta mbajë seancën e tij plenare.

Prandaj, unë kërkoj që nga Kuvendi të hiqen forcat policore, që e kanë rrethuar dhe e vazhdojmë seancën pas një ore.

(Vazhdimi i seancës plenare, në orën 11:15.)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta. Fillojmë!

Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi. Nuk është këtu. Atëherë fjalën e ka deputeti Goran Marinković. As Gorani nuk është këtu. Fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Në emër të grupit e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Javën e kaluar, opinionimi publik u sulmua me një dezinformatë, e kamufluar si lajm, në një nga mediat e Kosovës, e si për rrjedhojë edhe nga disa të tjera. Pra, u trondit edhe një herë opinionimi, jo thjesht me një lajm, por me një propagandë dhe dezinformatë të qëllimshme për të krijuar efekte politike dhe në drejtësi.

Si materie e këtij sulmi propagandistik u përdor apo u keqpërdor njëra nga plagët më të rënda të shoqërisë sonë të pasluftës. U përdor pra emri dhe vrasja e Xhemajl Mustafës, njërit nga intelektualët dhe njerëzit më të shquar të shqiptarëve të Kosovës, i vrarë nga dora e krimit të pasluftës në Kosovë. Opinioni kishte të drejtë të ishte i tronditur, të ndihej i tronditur, i hutuar dhe i lënduar, po aq sa ka të drejtë edhe të mos jetë i manipuluar dhe i dezinformuar. Ky medium tha: “Prokuroria Speciale e Kosovës ka arritur t’i identifikojë të dyshuarit për vrasjen e Xhemajl Mustafës dhe shumë shpejt pritet të bëjnë edhe arrestimin e tyre”. Burimet e këtij televizioni thonë se njëri nga të dyshuarit është aktualisht deputet i Parlamentit të Kosovës, përderisa i dyshuari tjetër është pjesëtar i Policisë së Kosovës. Madje, ky medium u thirr edhe në burime të sigurta.

Brenda të njëjtit skenar, një portal informativ i krijuar vetëm për këso rastesh shkroi se deputeti i dyshuar për këtë vrasje është nga radhët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, bëjnë të ditur burimet e këtij portali, të cilat theksojnë se tashmë është përgatitur edhe fletarresti për të. Edhe ky farë portali thirret në burime të sigurta, në këtë rast brenda EULEX-it. Por, çfarë ndodhi në të vërtetë me këtë lajm? Pse pra nuk u arrestua asnjë deputet dhe asnjë polic për këtë gjë?! Opinioni publik duhet ta dijë se, as Prokuroria e EULEX-it, siç thuhet, as Policia e Kosovës nuk kanë asnjë të dyshuar, as të hetuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e aq më pak ndonjërin nga deputetët e saj në lidhje me vrasjen e Xhemajl Mustafës.

Ky nuk ishte lajm, por një dezinformatë e medieve të SHIK-ut për llogari të krerëve të SHIK-ut, me qëllim që në skenën e dikurshme të krimit të krijojë skena të reja të eliminimeve, jo tashmë fizike, por edhe politike. Të parët që do të duhej të reagonin janë

EULEX-i dhe Policia e Kosovës. Ata ose duhej ta arrestonin atë farë deputeti vrasës, ose të mos i lejonin mediet e SHIK-ut që të manipulojnë me misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë. Kjo fushatë propagandistike, përveç që është e ligë, në aspektin etik është e pamoralshme, në aspektin emocional është shumë e ndjeshme, në aspektin juridik e kundërligjshme dhe për publikun e pabesueshme, e cila në të njëjtën kohë si dezinformatë paraqet formën më të vrazhdë të manipulimit me publikun. Opinioni duhet ta dijë, po ashtu, se e gjithë kjo që dëgjoi dhe lexoi javën e kaluar në lidhje me këtë rast ishte thjesht vetëm një gënjeshtër e lëshuar qëllimshëm për opinion për të krijuar efekte politike me motive të eliminimeve politike dhe në të njëjtën kohë kishte për qëllim edhe sabotimin e hetimeve në lidhje me këtë rast dhe rastet e ngjashme të pazbuluara ende në Kosovë.

Deri këtu, pra, ka arritur të manipulohet me opinion, e në këtë rast edhe me ndjenjat e lënduara rëndë të familjes Mustafa dhe të miqve të tij. Vrasësit dhe urdhërdhënësit për rastin më të rëndë në Kosovë, siç ishte ajo e Xhemajl Mustafës, një ditë do të zbulohen dhe duhet të dalin para drejtësisë. Vetëm atëherë kur fajtorët dhe kriminelët vrasës të jenë prapa grilave, ky vend do të frymojë ndryshe, normalisht më lirshëm.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryetar i Parlamentit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Me brengosje më duhet të konstatoj se Kosova vazhdon të jetë eksportuesi më i madh i parasë. Këtë e tregon qartë deficitit tregtar, i cili vazhdon të rritet. Në korrik ishte 209 milionë euro, kurse në gusht 217 milionë euro. Me këtë rast nuk dua të flas për shërbimin e mallrave me botën, por për një dukuri, e cila me pak kujdes dhe racionalitet mund të eliminohet ndoshta tërësisht.

Fjalën e kam për traditën se seminarët, trajnimet, konferencat dhe work-shopet e ndryshme që mbahen jashtë vendit, kryesisht në Maqedoni, apo në Shqipëri. Madje, nëse ka mundësi organizatorët nuk hezitojnë që takimet e këtilla t'i mbajnë edhe në Bullgari dhe në Greqi, po në këto vende ato mbahen me radhë për shkak të problemit me vizat. Për shpenzimet e këtilla, kryesisht prijnë qeveritë lokale, të cilat nuk e kanë shumë problem që t'i dërgojnë në bregdet grupet punuese për hartimin e dokumenteve të zakonshme. Kjo mënyrë e sjelljes nuk është asgjë tjetër, pos turizëm dhe shfrytëzim pa kontroll i parasë nga buxheti. Për fat të mirë, sektori privat ka bërë mjaft investime për ngritjen e kapaciteteve hoteliere në shumë qendra turistike në Kosovë, si në: Rugovë, Prevallë, Brezovicë, Batllavë etj. Një numër i madh i objekteve hoteliere ka salla për kongrese apo për takime të tjera zyrtare, të pajisura me tërë teknikën e nevojshme, por ato nuk shfrytëzohen meqenëse më shumë preferohet bregdeti apo Liqeni i Ohrit, ose malet e Mavrovës, edhe pse atje nuk ka kushte për punë dhe akomodim shumë më të mirë sesa në Kosovë, por atje shkohet edhe për shkak të mëditjeve të larta. Në anën tjetër, nuk di se dikush nga Maqedonia, Shqipëria apo cilido vend tjetër e ka organizuar ndonjë seminar, kongres apo work-shop në Kosovë.

Nëse bëhemi realë, ata nuk kanë pse të vijnë në Kosovë, meqenëse së pari ne me ofertën vendore nuk po bëhemi shembull se si të shfrytëzohen potencialet tona më mirë, kurse paraja që del nga buxheti për këto qëllime sa më shumë që të jetë e mundur të qarkullojë brenda vendit. Sa më kujtohet mua, ekziston një vendim që e rregullon çështjen e udhëtimeve jashtë vendit dhe qëllimet e tyre, mirëpo as ajo nuk respektohet, meqenëse qeveritarët dhe zyrtarët e Pushtetit Lokal nuk mund të heqin dorë nga bregdeti dhe mëditjet e larta. Unë insistoј që kjo rregullore të zbatohet me përpikëri, madje edhe të merren masa disiplinore ndaj atyre që nuk e respektojnë atë. Nëse ka nevojë të bëhet plotësimi i saj, që të mos nxirren pa nevojë paratë jashtë vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovane kolege poslanici,

Poštovani ministri,

Kao po nekom nepisanom pravilu, srpski poslanici uvek javljaju da govore na određenom temu, i ona je uvek ista: rad policije Kosova.

Zašto je tema uvek ista? Zašto ne govorimo o nekim drugim temama? Zar Srbi na Kosovu imaju samo jedan problem, koji uvek proizilazi iz sfere sigurnosti, a koji se odnosi na rad policije ili bolje rečeno na njen nerad, ili još bolje rečeno na zloupotrebu službenog položaja pojedinaca u policiji.

Nama srpskim poslanicima je zamerano da često govorimo o ovoj temi i da se suviše bavimo time. Ja sada vas pitam, da li mislite da je nama ta tema toliko draga, i da ne znamo o nečem drugom da govorimo? Mislite da mi ne možemo da govorimo o ekonomskoj situaciji, o zapošljavanju, o nekom drugom problemu? Pa naravno da možemo ali tek kada se neko seti da reši prvi osnovni problem koji danas imamo, a to je rad policijskih službenika, koji svojim radom krše zakon i tako nanose štetu celom kosovskom društvu, kao i imidu policije.

Mnogo je policijskih službi koje su u svojim redovima iskusile različite vrste ili predrasuda u odnosu na određeno grupu stanovništva. Najčešće vrste predrasude zastupljenih u policiji su rasizam, seksizam, homofobija, potcenjivanje starih ljudi.

U našem slučaju najčešće imamo policijski rasizam, što može biti neka vrsta korupcije, jer podrazumeva zloupotrebu položaja, jer u sebi nosi moguće posledice po bezbednost, a mi znamo koliko je važno neizazivati neprijateljstvo manjinskog stanovništva koje je tradicionalno živela na prostoru Kosova.

Da sve ovo govorim sa određenim razlogom i da bezrazložno ne govorimo, govore nam statistički podaci ili bolje rečeno sve veće nezadovoljstvo kosovskih Srba koji koriste granični prelaz na Merdaru. Pojedini granični policajci oduzimaju vozačke dozvole izdate od strane MUP-a Srbije, oduzimaju registarske tablice iako nisu javne istaknute, oduzimaju saobraćajne dozvole koje su u novčanicima a sa time oduzimaju i dostojanstvo jednom narodu.

Poštovani kolege poslanici, danas ću vam dati jedan primer gde pojedini policajci krše i zakon i Ustav Kosova, još i koriste takvu retoriku da je to sasvim neprimereno jednom takvom službeniku koji bi trebao da bude primer za sve nas ovde koji sedimo i da pokaže svu profesionalnost, nepristrasnost i bude odličenje demokratskih promena na Kosovu, to jest ogledalo društva u kojem živi.

Jedan od takvih slučajeva izneo sam Komisiju za bezbednost a kasnije lično sam išao kod sudije za prekršaje, koji je bio zgranut bakatošću pojedinih policajaca na koje se zakoni pozivaju, i naravno, odbio tužbu koju su pogranični policajci napisali i vratio...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Lajmërohu me kohë. Regjia vazhdoja në emër të grupit.

GORAN MARINKOVIĆ: A sada su preći na primer koji imamo kao novi. Dana 03.10.2012., posle 17 časova, oduzeta je saobraćajna dozvola pod brojem 2785111 i registarske tablice UR-002-C izdate od strane MUP-a Srbije. Prilikom oduzimanja ovih dokumenta dali su potvrdu o privremeno oduzetim predmetima a na osnovu člana 201. stav 2. tačke 7, 244 i 247 člana privremenog krivičnog Zakona Kosova, međutim član 201, stav 2. tačka 7. privremenog kaznenog zakona Kosova govori o omogućavanju prostitucije, član 242. odnosi se na falsifikovani novac, član 247. odnosi se na organizovani kriminal. Iz ovog možemo da vidimo da pomenuti članovi nikako ne mogu biti uzrok da se oduzmu lična dokumenta.

Vršeći pretragu u smislu da je potvrda povezana sa nekim drugim zakonom, kao što je Zakon o privremenom krivičnom postupku Kosova, i ako uzmemo iste članove koji su navedeni u potvrdi dolazimo do gotovo istog zaključka da ni po tom zakonu i tim članovima ne mogu se oduzeti dokumenta, jer član 201. kaže - ako postoji osnovna sumnja da izvršeno krivično delo za koje se goni po službenoj dužnosti, policija je dužna da preduzme određene korake da počinioce pronađe ili uhapsi, kako ne bi mogli da pobegnu. Sada se postavlja pitanje - zašto ga nisu uhapsili, nego su mu bezpravno oduzeli tablice i saobraćajnu.

I ostali članovi koji sam gore pomenuo, isto nisu dovoljno validni i da policija nije mogla da se na njih pozove kako bi oduzela navedene predmete. I tako, gospodo poslanici, postavlja se pitanje: dokle će sve ovo da ide, da li tom javašluku i samovolji pojedinaca neko može da stane na put?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë do të flas shkurt për kushtet e punës në Departamentin e Biologjisë në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit të Prishtinës.

Fjala është për objektin në mes të Institutit Albanologjik dhe Bibliotekës së re Universitare, përkatësisht Institutit të Historisë. Kushtet teknike dhe sanitare në këtë objekt janë jashtëzakonshëm të këqija, kurse është folur shumë për transferimin e këtyre studentëve dhe të personelit arsimor nga ky objekt, por deri më tani nuk ka ndodhur asgjë. Prandaj, është kohë e fundit që menaxhmenti i ri i Fakultetit të Shkencave, menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës, por do ta lusja edhe ministrin e Arsimit, pasi tani është këtu, le të urdhërojnë ta vizitojnë atë objekt dhe të marrin masa, në mos për tjetër, atëherë për ta ruajtur shëndetin e studentëve dhe të personelit arsimor. Nëse, i nderuar ministër, bashkë me rektorin e ri dhe me dekanin e ri të Fakultetit të Shkencave do të shkoni atje, ju vetë do të bindeni se në çfarë kushtesh punohet në atë objekt të Universitetit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Unë do ta ngre një çështje shqetësuese, e cila është shndërruar në një fenomen po aq të dëmshëm, por mund ta quaj edhe po aq kriminal. Ka të bëjë me fenomenin “fajde”, të cilit çdo ditë e më shumë po i shtohen rastet, sidomos në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit, dhe konkretisht po flas për komunën e Deçanit me rrethinë.

Dhe, jo vetëm me pasoja të zhytjes në borxhe, por edhe me pasoja tragjike, konflikte të armatosura, tentim-vrasje, vrasje e deri në vetëvrasje. Dhe, si rezultat i këtyre apo i këtij segmenti, i cili mund të quhet lirshëm pjesë e krimit të organizuar dhe të cilit, fatkeqësisht, aspak nuk po i kushtohet vëmendje nga organet e drejtësisë, për qytetarët e atjeshëm është krijuar përshtypja se fajde-dhënësit dhe ata që marrin para nga këta vepronë lirisht, pavarësisht nga pasojat, ndërkaq këta të fundit çdo ditë po zhyten në mjerim dhe në borxhe. Kësaj dukurie tragjike i ka ndihmuar dhe po i ndihmojnë edhe bizneset, të cilat veprimtarinë e tyre e kanë në lojërat e fatit, apo kazinotë, të cilat pothuajse janë të shtrirë në çdo dhjetë metra të kësaj komune dhe trevës, në përgjithësi. Dhe, në të shumtën ata që provojnë apo janë pjesë e këtyre, jo rrallëherë janë duke u ndarë me pasoja fatale. Vetëm në javët e kaluara e kemi një vrasje mu në qendër të Deçanit, kemi tentim-vrasje, e po ashtu dhe vetëvrasje.

Dëshmitarët frikësohen të deklarojnë, sepse edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës dyshohen që janë pjesë apo e ndihmojnë këtë veprimtari të dëmshme dhe kriminale, prandaj unë e bart një shqetësim, i cili është duke u bërë gangrenë e qytetarëve të varfër, gangrenë e njerëzve të ndershëm, të cilët çdo ditë e më tepër janë duke i bartur këto pasoja për shkak të mos-sundimit të ligjit dhe për shkak të infiltrimit edhe të strukturave politike, e thashë edhe policore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë e kisha përgatitur një fjalim prej tre minutash në emër timin, por të cilin unë nuk do të mund ta lexoj të tërin ashtu, pas deklarimit të kryetarit të Kuvendit. Por, unë do doja vetëm në disa pika t'i përmendja disa pjesë të tjera, por nuk mbetet për t'u thënë pas asaj që e tha kryetari i Kuvendit. Është vetëm aspekti ligjor, pra janë dy ligje që i përcaktojnë: 1.) të drejtat e deputetit dhe 2.) marrëdhënien ndërmjet Policisë dhe Ministrisë. Është Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe Ligji i Policisë së Kosovës.

Te neni 11 i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit qartësohet: "Kartela e identitetit, e lëshuar për deputetët, garanton hyrje të lirë në të gjitha organet shtetërore dhe të Administratës Publike. Në përputhje me rregulloret e lëshuara, ministrinë kompetente të Qeverisë, deputeti mund të jetë gjithashtu i autorizuar të hyjë në zonat e shërbimit të forcave të armatosura vendore, në shërbimet e sigurisë, të Policisë dhe forcave të Policisë së Kosovës". Po ashtu, në pikën dy thuhet: "Organet e Administratës Publike janë të obliguara të sigurojnë ndihmë për deputetin në përmbushjen e mandatit dhe ta japin informacionin e duhur që kërkohet për punën e tyre". Pra, deputeti e ka të drejtën të futet në institucione dhe e ka të drejtën të ketë qasje në informacionin, madje organet e administratës duhet ta ndihmojnë një gjë të tillë, sepse ai këtë e bën në përputhje me obligimet që i ka si deputet.

Një gjë e tillë nuk është lejuar dje, e më e keqja është që së pari nuk është lejuar nga truporjat, e pastaj kur është pritur intervenimi nga Policia që të lirohet rruga që deputetët të futen brenda, me urdhrin e ministrit janë urdhëruar truporjat dhe Policia që t'i heqin deputetët. Tash po e lexoj nenin 5 të Ligjit të Policisë së Kosovës për marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe Ministrisë, i cili thotë: "Policia funksionon nën autoritetin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtorit të përgjithshëm të Policisë". Dhe qartëson, "Autoriteti i ministrit nuk përfshin menaxhimin operacional të Policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e Policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata dhe raporte atij sipas mënyrës së përcaktuar me ligj".

Më tej, i qartëson të drejtat e ministrit që janë: të zhvillojë politika, të mbikëqyrë koordinimin ndërmjet Policisë dhe autoriteteve tjera publike, të mbikëqyrë bashkëpunimin ndërmjet Policisë dhe agjencive tjera, organizatave ndërkombëtare, t'i zhvillojë dhe t'i zbatojë strategjitë për marrëdhëniet me publikun dhe marrëdhëniet me organet tjera përgjegjëse në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, të mbledhë, të mbajë dhe të analizojë të dhëna statistikore dhe informata dhe të kryejë funksione që lidhen me përgatitjet për rastet emergjente, siç është përcaktuar me këtë ligj.

Pra, është shumë e qartë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Unë do të shkëpus disa pjesë të fjalës së përgatitur me rastin e interpelancës së ministrit të Punëve të Jashtme dhe do t'ia përshtati temës aktuale dhe rendit të ditës së sotme.

Kabinet qeveritar, deputete dhe deputetë të nderuar,

Në OKB është një shtet me të drejtë veto, që dëshiron rikthimin e dominimit në regjionin tonë, si në shumë pjesë të tjera të globit. Ngaqë këtë nuk mund ta bëjë në këtë kohë, duke e penguar anëtarësimin e Republikës së Kosovës në OKB, dëshiron t'i kundërvihet dominimit të miqve tanë në këto hapësira. Njëherësh, edhe Kosovën me preferencë euroatlantike synohet ta pengojë në rrugën e konsolidimit të shtetësisë. Duke qenë kështu, para nesh janë disa alternativa, të cilat do të duhej t'i përpunojnë institucionet tona paralelisht. Ideja reale se pa njohjen nga Serbia dhe pa përkrahjen e Rusisë, Kosova nuk mund të anëtarësohet në OKB, nuk guxon të na shtyjë në idejimin e ndonjë projekti për koncesione Beogradit zyrtar, përkatësisht Moskës, apo mos thëntë Zoti të krijojmë një diskurs filo-rus.

Meqenëse Republika e Kosovës është krijuar në zemrën e këtij populli dhe është mbëltuar me flijime biblike, e ka fituar përkrahjen e botës së emancipuar. Pasi spektakli 78-ditësh, i zhvilluar nga toka, uji dhe ajri, më 1999, i forcës së ndërgjegjes perëndimore, ka lidhur shpirtërisht popullin tonë me këto shtete dhe me popujt e tyre, kjo mirënjohje dhe kjo miqësi duhet të jetë reciprokisht e përrjetshme. Institucioneve të politikëbërjes strategjike dua t'ua bëj më të qartë se nëse anëtarësimi i Republikës së Kosovës në OKB njëherë për njëherë është i pamundur, atëherë një anëtarësim në BE dhe në NATO, duke i shmangur kriteret për anëtarësim, do ta relativizonte njohjen në OKB dhe do të krijonte një precedent në marrëdhënien ndërkombëtare. Kështu, rasti i Kosovës do të bëhej shembull në doktrinat ushtarake, në vizionet politike dhe në leksionet diplomatike. Nëse edhe kjo është e pamundur dhe gjithashtu edhe anëtarësimi në OKB është rrugë sizifiane për shpërblim të së drejtës dhe aspiratës për liri të popullit tonë dhe për hir të paqes për të qenë faktor stabiliteti i sigurisë në regjion, Republika e Kosovës le të inkurajohet, të hyjë në projektet e integritetit të mundshëm politik me shtetet tjera në regjion, me të cilin do të mund të arrihej vullneti i dyanshëm. Nëse kjo mund të arrihet ashtu siç ekzistojnë premiset, atëherë do të bëhej një zgjidhje e problemit të njohjeve dhe identitetit tonë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Para se kjo të bëhet platforma e agjendave shtetërore, shtete mike me ndikim në glob duhet t'i ndajnë për lobim rolet në sferat e ndikimit tyre për këtë projekt të vetëm që e kemi tani - anëtarësimin e Republikës së Kosovës në OKB. Pastaj, ky projekt nëse nuk ecën, të mobilizohemi për projektin tjetër alternativ për identitetin tonë ndërkombëtar dhe për të cilin mund të themi me bindje të plotë se është një stabilizator i fizibilitetit të sigurisë në regjion. Kjo kërkon vetëm krijimin e vullnetit të qendrave të vendosjes në glob dhe logjika racionale thotë se është më lehtë koordinimi i aktiviteteve politike se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju faleminderit! Nuk kemi të lajmëruar të tjerë. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti në një mbledhje mund të parashtojë më së shumti 2 pyetje parlamentare. Kemi gjithsej 5 pyetje. Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Nuk do ta bësh pyetjen? Urdhëro! Fjalën e ka deputetja.

ALMA LAMA: Po përsëritet rituali. Kryeministri prapë është larguar nga seanca në kohën e pyetjeve. Si duket, ai me të vërtetë ka tmerr nga pyetjet e mia. Faleminderit!

KRYETARI: E ke të drejtën edhe për një pyetje tjetër. Do ta bësh pyetjen tjetër?

ALMA LAMA: Edhe pyetja tjetër lidhet me vizitën e kryeministrit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mbledhjen e 67-të të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, në të cilën, e përsëris, kryeministri shkoi me një ushtri zyrtarësh, vetëm e vetëm për ta shpenzuar buxhetin. Pyetja ishte: Cili është efekti i asaj vizite? Por, duke pasur parasysh që ai ka frikë të japë përgjigje, po e themi ne - efekti ishte zero. Faleminderit!

KRYETARI: Tani është radha e dy pyetjeve për të shkuar në revistën “Kuvendi”. Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila. A është këtua deputetja? Nuk është. Vazhdojmë! Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Bedri Hamza. A është deputetja këtua? E ke fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Pyetja praktikisht ka të bëjë me kryeministrin zotin Hashim Thaçi, por meqenëse ai nuk është i pranishëm asnjëherë në këtë sesion të seancës, atëherë unë ia kam drejtuar pyetjen ministrit të Financave, zotit Bedri Hamza.

Më 17 shtator të këtij viti, kryeministri zoti Hashim Thaçi, me rastin e përrurimit të objektit të ri të shkollës fillore “Shaban Jashari” në Skenderaj, tha: “Nga këtua, në Skenderaj, e kam një mesazh për të gjithë mësimdhënësit e Republikës së Kosovës se do të ketë një rritje tjetër të pagave gjatë këtij mandati, për së paku 50%”. Pyetja është se, a e ka konsultuar kryeministri ministrin e Financave para se ta japë një premtim të tillë, a ka mundësi të ndodhë kjo? Pasi në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013-2015, në tërësi parashihet një rritje 8% e faturës së pagave, e cila shpjegohet shumë mirë se do të shkojë kryesisht në vitin 2013 për implementimin e reformës së Administratës Publike. Do të thotë, prej nga do të vijnë këto para për një rritje tjetër të 50% të pagave për mësimdhënësit, dhe pse nuk do të ketë rritje edhe për kategoritë tjera, por vetëm për mësimdhënësit? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e do fjalën?

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari kryetar i Kuvendit!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

E nderuara deputete Bajrami, faleminderit për pyetjen!

Qeveria e Republikës së Kosovës me rastin e caktimit të prioriteteve, një nga to e ka vendosur edhe në përmirësimin e mirëqenies sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe posaçërisht atyre që përfitojnë nga Buxheti i Kosovës. Siç jeni në dijeni, deputete e nderuar, nëse e shikoni raportin e ekzekutimit të buxhetit nga viti 2007, në vitin 2012 shohim se kemi pasur rritje të faturës së pagave për 100%. Gjithashtu, siç jeni në dijeni, në vitin 2011 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për një përmirësim sinjifikant të pagave dhe të gjithë atyre që përfitojnë nga Buxheti i Kosovës, kështu që janë rritur pagat për punëtorët shëndetësorë 30%, për Policinë e Kosovës 40%, për shërbimin civil 30%, për arsimtarët 50%, për kategoritë e dala nga lufta, në këtë rast për invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve 50% dhe, gjithashtu, deputete e nderuar, siç e shihni në informacion, Qeveria e Kosovës këto ditë ka marrë një vendim shumë të rëndësishëm, që është vendimi për rritjen e pensioneve dhe atë për kategorinë e pensionistëve kontribut-dhënës 40% dhe për kategorinë e pensioneve bazike dhe pensioneve të personave me aftësi të kufizuar, 33%.

Gjithashtu, ne, edhe në të ardhmen do të vazhdojmë në këtë drejtim. Jeni gjithashtu në dijeni, e nderuara deputete, se procesi buxhetor nis në fillim të vitit fiskal për vitin vijues. Nxirren indikatorët e hershëm makroekonomikë, nxirret deklarata e prioriteteve të Qeverisë, hartohet korniza afatmesme e shpenzimeve, që është një dokument i cili vazhdimisht rifreskohet dhe i reflekton ndryshimet që kanë ndodhur gjatë asaj periudhe dhe sigurisht që edhe në të ardhmen do të jemi të kujdesshëm që brenda mundësive reale buxhetore të ketë përmirësim të pozitës materiale të të gjithë atyre që përfitojnë nga Buxheti i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E bën pyetjen shtesë deputetja, përgjigjet kryeministri.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit shumë ministër i Financave, por definitivisht nuk je përgjigjur në pyetje. Do të thotë, ke folur diçka për të kaluarën, që nuk të kam pyetur. Ju përgëzoj që i keni rritur pagat gjatë këtij mandati, por keni premtuar një rritje, e cila nuk është e planifikuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ju thashë që figuron se buxheti do të rritet për vitin 2013-2015, vetëm 8% fatura e pagave, dhe kjo rritje shkruan shumë mirë se do të shkojë për implementim të reformës në Administratën Publike. Aty nuk shkruan që ju do t'i rritni pagat gjatë këtij mandati edhe për 50%/ Atëherë, ju duhet të thoni që korniza afatmesme e shpenzimeve 2013-2015 nuk është një dokument i qëndrueshëm, se ne kemi plane tjera.

Sa u përket pensioneve, pensionistëve u keni borxh, sepse buxheti është ndarë dhe është votuar nga ky Kuvend edhe në vitin 2011, për këtë rritjen 5 euro dhe 20 euro që e përmendët, por ju keni marrë një vendim Qeverisë që vetëm në vitin 2012 ta implementoni këtë. Kështu që atyre ua keni borxh edhe pensionet me rritje për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, urdhëro! Atëherë, urdhëro kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara ministre, në fakt deputete, se ministre nuk e besoj se do të bëhesh,

Ministri jua dha përgjigjen shumë qartë. Po është e vërtetë që kam deklaruar dhe ju e dini se unë zotimet i mbaj, por desha të shtoj se nuk do të ndodhë rritja vetëm për arsimtarët, por do të ndodhë siç ka ndodhur për punëtorët universitarë mbi 100% gjatë këtij mandati. Po, po, dhe ju e dini shumë mirë se vetë juve u është rritur rroga. E dini sa keni filluar si asistente, dhe ku keni arritur.

Për të gjithë punëtorët e shkollave fillore dhe të mesme, 50%. Edhe atëherë keni qenë shumë kritikë se po dëmtohet buxheti, por rritja ka ndodhur. Për të gjithë pjesëtarët e FSK-së 40%, për të gjithë shërbyesit civilë 30%, për shëndetësinë 30%, për familjet e dëshmorëve 50%, për invalidët 50%, për pensionistët tani në fund 40%, për zjarrfikësit 50%. Jemi duke nxjerr ligjet për pensionet dhe veteranët. Prandaj, unë dua t'i siguroj të gjitha kategoritë e shoqërisë kosovare se rritje të pagave do të ndodhin dhe tani kam arritur ta niveloj punëtorin kosovar me atë të rajonit dhe të jeni të bindur dhe u siguroj se do ta arrij pagën e punëtorit kosovar me atë të punëtorit të vendeve të Bashkimit Evropian. Mos u shqetëso! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, lexojeni Rregulloren se si zhvillohet kjo pikë e rendit të ditës. Jo, jo. Deputete, po e bëjmë një lëshim, e ke pyetjen e tretë për ministrin Enver Hoxhaj. Alma Lama, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

ALMA LAMA: Po pres përgjigjen e kryeministrit. Meqë u shkel Rregullorja, të shkelet edhe për atë.

KRYETARI: Rregullorja nuk është shkelur, pyetje tjera nuk ka. Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura, më 3,4 dhe 11 tetor

Keni vërejtje në këto procesverbale? Të pranishëm janë 95 deputetë. Halit Krasniqi, urdhëro.

HALIT KRASNIQI: Po! Faleminderit, kryetar!

Nëse e nënkuptoni tani edhe transkriptin, në fjalën time është bërë një ndryshim në lidhje me politikën “nebulizitetit”, aty ka dalë “nervozitetit të Qeverisë” dhe e ka ndërruar kuptimin krejt fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Vetëm desha të theksoj se ka një kohë që nuk po i marrim transkriptet e mbledhjeve të Kuvendit. Meqenëse transkripti është pjesë përbërëse e procesit, do të kisha kërkuar që t'i kemi edhe këto transkripte në të ardhmen më rregullisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Janë shpërndarë nëpër kuti, por i keni edhe në adresë elektronike. Në ueb-sajt po thonë se janë. Po, ju vijnë edhe nëpër kuti, pa vonesë. A ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka! Urdhëro, Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Jo për procesverbalin, veç desha t'i them ministrit, nëse thirrja ministre më herët ishte thirrje për koalicion, përgjigjja është "jo". Edhe SHIK-u nuk po i punon mirë - se nuk jam më asistente, jam bërë profesoreshë.

KRYETARI: Mirë! Urime, pra! Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Dola vetëm të ta uroj gradimin shkencor. Me meritë apo pa të, e di vetë.

KRYETARI: Konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjeve të 3, 4 dhe 11 tetorit. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i Koalicionit për Kosovë të Re, SLS-ja dhe Grupi "6+", dhe këta të pavarurit të LBD-së, kanë parashtruar në Kuvend një propozim-rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur, më 15 tetor 2012, propozim-rezolutën e lartshënuar e ka radhitur në rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare. E ftoj deputetin Adem Grabovci, në cilësinë e propozuesit të çështjes. Për procedurë, Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zotni ministra, kryeministër dhe deputetë,

E kam marrë një tekst projekt-rezolute, i cili tekst është regjistruar në Kuvend më 15.10.2012, i cili është trajtuar në Kryesi në të njëjtën ditë, më 15.10.2012, që i bie një urgjencë e jashtëzakonshme.

Unë vetëm kërkoj që të zbatohet Rregullorja e Kuvendit. Ne e kishim një diskutim të kësaj natyre para një jave rreth punës së mocioneve, të datave, sa duhet të jenë në qarkullim te deputetët. Edhe me këtë rast të zbatohet Rregullorja e Kuvendit, sepse unë mendoj që s'ka kurrfarë urgjence ose situatë të jashtëzakonshme që të kalohet ky afat, domethënë të zbatohet Rregullorja e Kuvendit për mocionet e shkruara dhe rezolutat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë jam i obliguar të njoftoj që në mbledhjen e Kryesisë, në të cilën kanë qenë edhe grupet parlamentare, ua kam tërhequr vërejtjen për mungesën e kohës, por me përjashtim

të “Vetëvendosjes”, të gjitha grupet tjera parlamentare e kanë pranuar që të shkojë kjo Rezolutë gati si me urgjencë, dhe Rregullorja lejon edhe parashtrimin e çështjeve me urgjencë. Tani e do ta kenë fjalën, pas Adem Grabovcit, grupet parlamentare dhe le ta thonë fjalën e tyre. Fjalën e ka për parashtrësë deputeti, kryetar i grupit, Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeverisës,

Zoti kryeministër,

Rezoluta të cilën do ta paraqes sot është harmonizuar nga liderët politikë të Kosovës.

E kam paraqitur në mbledhjen e Kryesisë dhe kam kërkuar me mirëkuptim, jo me urgjencë. Por, e ka atë urgjencën që jemi dakorduar që të gjithë, siç tha edhe kryetari, edhe ai e vërtetoi. Prandaj, unë sot po e paraqes këtu para jush dhe jemi ata që duhet të vendosim bashkërisht.

Rezoluta për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë parasheh normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, dhe është në interes të zgjidhjes së problemeve ndërmjet dy shteteve fqinje dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Kosova e ka pikësynim zhvillimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit, si dhe dhënien e kontributit për realizimin e agjendës së BE-së për një rajon stabil, demokratik, të integruar në strukturat euroatlantike. Në këtë funksion duhet parë edhe rezoluta për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e cila e rikonfirmon parimin se ky proces ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë lehtësohet dhe udhëhiqet nga Bashkimi Evropian dhe mbështetet fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është siguria dhe garancia jonë. Meqenëse integrimi në Bashkimin Evropian është synim i përbashkët, intensifikimi i nivelit të bashkëpunimit me vendet e rajonit, në këtë kuadër normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë mbetet qenësor për rajonin.

Normalizimi i relacioneve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë mund të realizohet brenda kuadrit të frymës së integriteteve euroatlantike. Ky hap i Kosovës demonstroi në praktikë qëllimin tonë paqësor të forcimit të klimës bashkëpunuese dhe stabilitetit rajonal, si dhe të avancimit të agjendës evropiane. Kjo rezolutë nuk ka të bëjë vetëm me bisedimet, por në rend të parë ka të bëjë me normalizimin e marrëdhënieve ndërfqinjësore ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane. Pavarësia e Kosovës tashmë është e pakthyeshme, prandaj Serbia nuk ka rrugë tjetër, herët apo vonë, duhet ta pranojë pavarësinë e shtetit të Kosovës. Natyrisht, ky është kusht edhe për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian.

Për mendimin tim, si shef i Grupit Parlamentar të PDK-së, kjo rezolutë është shumë e dobishme për Kosovën dhe kjo shihet qartë edhe nga mënyra se si është formuluar, pasi aty thuhet qartë se rezultatet duhet të jenë në përputhje me sovranitetin e Kosovës. Kjo shihet nga pika 2 e rezolutës, ku thuhet se Kuvendi i Republikës së Kosovës e rikonfirmon parimin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuara nga Bashkimi Evropian dhe të

mbështetura fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Veçanërisht në pikën 3 precizohet se dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues.

Republika e Kosovës nuk ka asnjë arsye t'i frikësohet dialogut, aq më tepër kur ky dialog me Serbinë tani zhvillohet nga pozita të barabarta, si dy shtete sovrane.

Të nderuar kolegë deputetë,

Normalizimin e raporteve fqinjësore e shohim si një element kyç për konsolidimin e shtetit të Kosovës. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është po ashtu i rëndësishëm për stabilizimin e brendshëm të Kosovës dhe për stabilizimin e kësaj pjese të Evropës Juglindore. Normalizimi i raporteve Kosovë-Serbi do të çojë edhe në largimin e pranisë ilegale të Serbisë në veri të Kosovës. Po ashtu, ky normalizim nënkupton edhe njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia. Pra, këtu kemi të bëjmë me normalizimin e raporteve ndërmjet dy shteteve fqinja dhe sovrane.

Është e qartë se ky normalizim politik nuk do të nënkuptojë menjëherë raporte të ngushta, sepse askush nuk pret që Kosova dhe Serbia të kenë marrëdhënie të mira, pasi për këtë duhet të pritët me vite. Një përmirësim i qëndrueshëm i raporteve Kosovë-Serbi mbetet kërkesë kyçe për hapin e ardhshëm të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Aasociimit dhe, në përgjithësi, të rrugëtimit tonë drejt Bashkimit Evropian. Me këta hapa, ne do ta lehtësojmë pozicionin e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Për shumicën e partnerëve tanë ndërkombëtarë, normalizimi i relacioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nënkupton madje bashkëpunimin në shumë fusha, duke hyrë në një etapë të re, të paprovuar më parë, për shkaqe të njohura nga të gjithë ne, për shkak se Beogradi ndoqi politikë ekspansioniste territoriale dhe të shtypjes.

Dialogu për ne është vlerë dhe standard evropian. Ne të gjithë pa dallim, dhe etnitë tjera, ju ftoj që në këto vlera ta mbështetni këtë rezolutë të përbashkët. Ju faleminderit!

Unë po e paraqes edhe rezolutën, e cila, siç thashë në fillim, është harmonizuar nga liderët politikë të PDK-së, LDK-së, AAK-së, SLS-së, AKR-së dhe Grupit “6+”. Në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6.1 dhe 52.2 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, duke e respektuar dhe kujtuar gjithmonë të kaluarën e hidhur dhe luftën e përgjakshme të popullit tonë për liri e pavarësi, të përkushtuar për ta ndërtuar një të ardhme në paqe dhe në harmoni me fqinjët tanë, të vendosur për të punuar bashkërisht në integrimin e shpejtë të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO, i propozojmë Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë seancë, grupet parlamentare të poshtë nënshkruara: PDK, AAK, AKR, SLS dhe “6+” ta miratojmë këtë rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e mbështet procesin për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, në

- interes të zgjidhjes së problemeve ndërmjet dy shteteve, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për të dyja shtetet dhe për rajonin,
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës e rikonfirmon parimin që ky proces ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të lehtësohet nga BE-ja dhe të mbështetet fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
 3. Dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin brendshëm kushtetues të Kosovës,
 4. Kuvendi i Republikës së Kosovës e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës që ta udhëheqë këtë proces me pjesëmarrje të komisioneve të nevojshme të Kuvendit të Kosovës,
 5. Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar që të raportojë për procesin e normalizimit të relacioneve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në Kuvendin e Kosovës rregullisht,
 6. Rezultati final i procesit të normalizimit ndërmjet dy shteteve do të ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kjo ishte rezoluta e propozuar, prandaj ju ftoj të gjithëve që ta përkrahim. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën për rezolutën? Nuk ka. Atëherë, radha është të përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së foli Ademi Grabovci. Radha është e Grupit Parlamentar të LDK-së. Kush e do fjalën? Zoti Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit zoti nënkryetar dhe kryesues i kësaj seance!

Kolegë deputetë,

I nderuari kryeministër,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar

Paraqes qëndrimin e Grupit Parlamentar. Më lejoni t'i them disa çështje që lidhen me këtë proces dhe me këtë angazhim që nënkupton edhe rolin e liderit të LDK-së në këtë rezolutë, i cili është deleguar te Kryesia e LDK-së, tek organet e LDK-së, siç është Grupi Parlamentar dhe nënkryetari i saj, që është edhe nënkryetar i këtij Kuvendi, e jo të lejohen forma të tilla kur grupet tjera politike flasin në emër të liderëve që në fakt nuk kanë qenë të përfshirë në këtë formë që u tha këtu.

Atëherë, me lejen e Grupit Parlamentar sot, më lejoni t'i paraqes edhe tri çështje që janë në interes të sqarohen, të rregullohen apo të harmonizohen në mënyrë që qëndrimi ynë të jetë sa më konsensual në këtë çështje.

E para, ne të hënën, në Kryesi, nuk kemi kërkuar shumë sqarim, por sot kryetari e tha një lloj sqarimi më të vogël, por mbi nevojën e procedurave dhe urgjencës në këtë rezolutë.

Ndoshta edhe sponsorizuesi i kësaj rezolute, edhe përgjegjësit nga ana e Qeverisë, kanë mund ta sqarojnë, nëse jo atë ditë, sot nevojën e urgjencës në procedurë dhe në miratim, a lidhet kjo me agjendën, me urgjencën që agjenda po e kërkon? A lidhet kjo me nevojën që Kuvendi duhet ta ketë qëndrimin sa më shpejt në mënyrë që Qeveria të përgatitet për nevoja që po shihen, sepse sponsorizuesit kërkojnë mandatin e këtij Kuvendi për të deleguar të drejtën për të biseduar, negociuar apo për të folur në emër të vendit, që është e qartë.

Nën dy, ne mendojmë që për të arritur një konsensus, i bie institucionit kushtetues të jetë sponsor, e jo grupeve politike, sepse ne raportin e ndërtuar brenda këtij Kuvendi, pozitë - opozitë, na pamundëson të mbërrijmë konsensus për çështje të mëdha të vendit, institucioni është organ kushtetues si në këtë rast Qeveria, ka mund të jetë sponsor dhe të kërkojë nga grupet politike harmonizim të qëndrimeve në rezolutë. Është më e lehtë, është më e drejtë dhe më e mundshme që të mbërrihet, sepse apriori po shihet që grupet politike janë pjesë e Qeverisë, ndërsa pjesë e opozitës ka mbetur në këtë rrafsh që jemi sot.

Dhe çështja e tretë lidhet me qëndrimin tonë të LDK-së që dëshirojmë ta bëjmë të qartë, sikur që kemi qenë gjithmonë, sepse e kemi promovuar dialogun si mjet të vetëm dhe tepër të rëndësishëm në funksion të paqes, të stabilitetit politik dhe zgjedhjes së problemeve.

Si parti e përgjegjshme karshi qytetarëve të Kosovës, elektoratit të saj, të institucioneve të Republikës, LDK-ja e mbështet debatin në institucionin e vendit për çështje të mëdha e në veçanti për çështjen që po flasim sot.

LDK-ja e konsideron si të vetmen mënyrë debatin e hapur, transparent që mund të arrihet një zgjidhje për mbrojtjen e interesave të vendit.

Lidhur me bisedimet në raport me Serbinë, LDK-ja ka pasur qëndrim konsistent duke kërkuar nga Qeveria: platformë, agjendë, transparencë, sjellje kushtetuese, shtetërore, të përgjegjshme në raport me Kuvendin e Republikës dhe qytetarët e saj.

Duke i ndjekur gjithmonë parimet e veta, qëndrimin politik dhe duke pasur përherë parasysh interesin e vendit, LDK-ja në parim përkrah dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dy shtete sovranë, të barabarta, por rolin e BE-së dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të domosdoshëm në këtë proces.

LDK-ja nuk e pranon asnjë lloj dialogu që do të kishte temë statusin e Republikës, territorin e saj, rregullimin e brendshëm të saj dhe çështjet që janë pjesë e shtetësisë.

LDK-ja e Kosovës e konsideron qenësore ruajtjen e unitaritetit të institucioneve të saj dhe konform angazhimeve të saj në këtë drejtim, shtrirjen dhe funksionalizimin e institucioneve të Republikës në tërë territorin e vet.

Atëherë, unë këtu po e përfundoj për ta lënë hapur debatin nga radhët e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe mundësinë që në fund t'i harmonizojmë qëndrimet për rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën zoti Konjufca

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryesues!
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Partia në pushtet po e degradon Kuvendin e Republikës së Kosovës në agjenci vendimmarrëse të Qeverisë.

Miratimi i kësaj rezolutës të Partisë Demokratike, do të thotë zhvlerësim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse Kuvendi e ka në fuqi Rezolutën për kushtëzimin e çfarëdo negociatave me Serbinë nëpërmjet kthimit të 1 800 të pagjeturve.

Çka ka ndryshuar tash, shtrohet pyetja, pas 5 muajve që dikush këtu po i han fjalët?

Ne kemi pasur votim demokratik në Kuvend atë ditë, më 10 maj të këtij viti, Kuvendi dhe deputetët kanë votuar që bisedimet me Serbinë të kushtëzohen me kthimin nga ana e Serbisë e 1 800 të pagjeturve të rrëmbyer nga lufta dhe tash ka gatishmëri që të shkelni mbi vullnetin e juaj, që të shkelni mbi votën e juaj vetëm pse kështu po jep urdhër Qeveria.

Unë mendoj që kjo është shkelje e demokracisë, zhvleftësim i Kuvendit dhe zhvleftësim i vetës tuaj.

Kjo rezolutë e shkatërron dinjitetin e deputetit që ka votuar për Rezolutën e majit. Deputeti duhet ta ketë në mendje së pari interesin e popullit, e jo të një Qeverie të korruptuar, sepse qeveritë shkojnë e vijnë, po populli është ai që mbetet gjithnjë.

Ju po veproni sikur t'i detyroheni vetes tuaj vetëm prej kësaj Qeverie, prandaj edhe po i ndihmoni atë deri sa ndoshta të rrëzoheni bashkë me të.

Për disa deputetë të cilët nuk shohin asnjë interes qytetar përtej urdhrave të Qeverisë, kjo na tregon më së miri edhe se si dikush ka ardhur në këtë Kuvend.

Por, deputeti së pari kujdeset për dinjitetin e Kuvendit dhe fytyrën e vet, e pastaj për atë të Qeverisë.

Njëherë ky Kuvend votoi për reciprocitet me Serbinë, e mbani në mend, pastaj Qeveria i detyroi deputetët e kontrolluar që ta sjellin një mocion kundër reciprocitetit me Serbinë.

Njëherë ky Kuvend votoi amendamente për t'i definuar të pagjeturit, pastaj me urdhër të Qeverisë, ato amendamente u kthyen dhe u hedhën poshtë.

Njëherë ky Kuvend, pra, po ashtu votoi Rezolutë që i kushtëzon bisedimet me Serbinë nëpërmjet kthimit të pagjeturve, kurse sot po na sjell një rezolutë që e shkel atë të mëhershmen.

Gjithnjë, që këto tri veprime, të cilat me të vërtetë janë të turpshme për jetën parlamentare në Kosovë, që të tria këto po zhvleftësohen me urdhër të Qeverisë.

Ky është një turp që nuk e shlyen asgjë.

Tash është bërë në modë edhe kjo shprehja, siç u tha këtu, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Marrëdhëniet me Serbinë, deputetë, normalizohen vetëm në dy mënyra. Dy mënyra janë se si normalizohen marrëdhëniet me Serbinë, nuk ka më shumë. Ose duhet ta kompletojmë sovranitetin tonë, pra kjo do të thotë shpërbërje e strukturave të paligjshme të Serbisë, t' i marrim kufijtë nën kontroll, ta kontrollojmë integritetin tonë territorial në gjithë territorin e Kosovës, t' i bllokojmë mallrat e Serbisë, pra të kemi reciprocitet të plotë, e kështu me radhë. Dhe, çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që shtetësia jonë për Serbinë bëhet një fakt i kryer dhe i paprekshëm, ose rruga tjetër, që është nënshtrim ndaj kërkesave të Serbisë dhe për t' ia akomoduar interesat e saj brenda territorit të Kosovës, që është për ta pranuar Serbinë si hise në veri, për t' ia vendosur vetvetes fusnotën, të bëjmë marrëveshje me Serbinë që nuk ia kontestojnë asaj kushtetutën e saj dhe këtu janë dy rrugë.

Veç këto dy rrugë janë, janë e para - rruga e Kroacisë dhe e dyta rruga e Bosnjës. Është shumë kollaj.

Mua po më duket që Qeveria është përcaktuar për rrugën e dytë. Dhe, kjo është e qartë po sikur drita e diellit.

Për të shkuar tash në negociata Qeverisë po i duhet edhe opozita. Prandaj po duan ta krijojnë një grup të ri të unitetit, por ky do të jetë një grup i pazarit.

Në kohën kur pushtetit sot po i lëkundën themelet dhe i ka më ngushtë se kurrë punët me legjitimitet, me numra dhe me pakënaqësi të përgjithshme të njerëzve, dhe pikërisht tash kur më shumë se kurrë kemi nevojë për ta rrëzuar këtë Qeveri të pandershme, pikërisht këta tash po duan unitet të ri, edhe me opozitën.

Dhe për të qëndruar në këmbë, e ashtu që ta vazhdojnë keqqeverisjen e tyre, patericë shpeshherë po i bëhet edhe dikush nga opozita.

Kur e mori kjo Qeveri pushtetin, në mes tjerash, erdhi në pushtet edhe me premtje se do ta shtrijsë sovranitetin në veri dhe në gjithë territorin e Kosovës. Por për të shkuar në negociata me Serbinë, ku sipas të gjitha gjasave do të bisedohet edhe për veriun e Kosovës. Ky është një vendim aq kapital, saqë duhet të testohet në popull edhe një herë.

Qeverisë pra, që po dëshiron të shkojë të negociojë për një pjesë të territorit të Kosovës i duhet mandat i ri, se ky është një vendim kapital.

Gjatë zgjedhjeve të fundit qeveritarët nuk i thanë popullit se do të negociojmë për tokën tonë. Nuk mund të vish në pushtet me vota të manipuluar, e me premtimin për krijimin e 100 mijë vendeve të reja të punës, e krejt çka bën pastaj, janë negociatat me Serbinë dhe shitja e pasurisë publike të Kosovës për shuma të cilat janë fyese për qytetarët e Kosovës.

Le të dalin partitë e mocionit, që na e kanë sjellë këtë rezolutë, le të bëhen të gjitha bashkë në një koalicion të përbashkët, dhe le të bëjnë fushatë me një moto: na e jepni votën o qytetarë të Kosovës, sepse do të shkojmë të negociojmë me Serbinë dhe le ta shohim se sa vota do t'i merrnin nga qytetarët e Kosovës. Pra, le të tregojnë drejt.

Në çdo shtet normal demokratik të botës, kur qeveria i hyn një plani kapital për të cilin qytetarët nuk e kanë ditur në momentit e votimit, qeveria i nënshtrohet rivlerësimit prej qytetarëve. Kjo ndodh gjithkund në botë.

Pasi e kanë parë mirë qytetarët se çka ka bërë kjo Qeveri gjatë këtyre dy vjetëve të fundit, ata kanë nevojë të rizgjedhin edhe një herë, sepse kjo është njëra prej mënyrave se si ata mund ta shpëtojnë vendin e tyre, jo vetëm nga korrupsioni, por edhe negociatat me Serbinë.

Prandaj, të gjithë atyre deputetëve që kanë votuar për t'i kushtëzuar bisedimet me Serbinë nëpërmjet kthimit të pagjeturve, më 10 maj të këtij viti, i lusim edhe një herë, i lusim, që t'i bëjnë thirrje ndërgjegjes së tyre kur kanë votuar atëherë dhe të votojnë sërish në përputhje me vullnetin e tyre, e të mos e ndërrojnë këtë vullnet sipas tekave të Qeverisë dhe sipas urdhrave të dikujt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka Blerim Shala.

BLERIM SHALA: I nderuar kryesues,

Deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Rezoluta për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e cila është paraqitur sot në Kuvendin e Kosovës, qartëson para qytetarëve të Kosovës dhe opinionit ndërkombëtar tri çështje kryesore.

Së pari definon qartë interesin e Kosovës për të normalizuar marrëdhëniet me Serbinë duke e respektuar në plotëni Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Së dyti përcakton Qeverinë e Kosovës si bartëse të kësaj ndërmarrjeje politike, e cila nuk ka si të mos klasifikohet si problematike, e mundimshme, e rrezikshme.

Së treti rikonfirmon që Kuvendi i Kosovës është autoriteti suprem në përcjelljen e këtij procesi prej fillimit e deri në fund, duke përfshirë edhe vendimmarrjen për rezultatin e këtyre bisedimeve.

Roli i Kuvendit të Kosovës në trajtimin dhe vendimmarrjen lidhur me çështjet e këtilla është i pazëvendësueshëm. Askush prej nesh nuk mund t'i ikë përgjegjësisë në trajtimin e kësaj çështjeje gjithsesi të ndjeshme politike, e cila na rikujton që kontesti njëshekullor në mes të Kosovës dhe Serbisë, akoma nuk e ka marrë vulën finale, në trajtën e normalizimit të marrëdhënieve midis këtyre dy shteteve.

Duhet thënë hapur, ky dialog njeh shumë rreziqe, por rreziku më i madh është të besojmë se vetë prej vetes do të adresohen dhe zgjidhen probleme të mëdha në relacionet Kosovë, Serbi të cilat këmbë e krye janë shkaktuar prej Beogradit zyrtar.

Në fazën konkluduese, normalizimi i raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë gjithsesi nënkupton njohjen e shtetit të Kosovës nga Serbia. Këtë duhet ta themi fare qartë. Nuk mund të ketë normalizim të mirëfilltë të marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë, pa njohjen e Kosovës nga Serbia si shtet në kufijtë e njohur.

Jemi të bindur se është koha e fundit që të kryhen punët e papërfunduara politike dhe historike në ndërtimin e shtetit të Kosovës, të cilat kanë bërë që Republika e Kosovës, të mos e ketë të stabilizuar rendin kushtetues në veri të Kosovës, të mos e ketë të konsoliduar pozicionin ndërkombëtar, të mos jetë në gjendje të bëhet anëtare e OKB-së, e OSBE-s, organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe ta ketë të vështirësuar tej mase rrugëtimin e saj në drejtim të Paktit NATO dhe të Bashkimit Evropian.

Tashmë nuk ka dilema askund se kush është përgjegjës për gjendjen e rëndë në veri të Kosovës. Çfarë duhet të ndodhë atje, shpërbërja e strukturave ilegale të Serbisë, në radhë të parë, kush e mban peng procesin e normalizimit të raporteve midis Kosovës dhe Serbisë dhe kush ka pamundësuar deri tash qytetarët serbë të kësaj pjese të Kosovës të ndjekin shembullin shumë të mirë të qytetarëve tjerë të Kosovës, integrimin e tyre në shoqërinë dhe institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës, është një veprim i suksesshëm që duhet të zbatohet edhe në veri të Kosovës.

Ne duhet të tregohemi të përgjegjshëm, të matur, pra të vendosur që të mbërrihet tek normalizimi i marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, gjithnjë duke i mbrojtur interesat jetike të shtetit të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës si bartëse e autorizuar e këtij dialogu nga Kuvendi i Kosovës, do të duhej sa më parë që është e mundur të përgatitë një dokument të detajuar se çka dëshirohet të mbërrihet me këto bisedime, gjithnjë duke e respektuar rezolutën e Kuvendit të Kosovës.

Pos tjerash, në këtë dokument të Qeverisë së Kosovës do të duhej të spikateshin edhe këto elemente.

1. Afati i qartë kohor për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut teknik në Bruksel;

2. Temat të cilat jo vetëm që duhen të trajtohen, por edhe të zgjidhen më në fund e që janë interes jetik i qytetarëve të Kosovës. Këtu çështja e parë që duhet të bie ndër mend, është gjithsesi ajo e të pagjeturve, e cila duhet të ketë prioritet të madh tek pala kosovare.
3. Afati kohor brenda të cilit do të duhej të përmbylleshin këto bisedime;
4. Afati i synuar dhe i koordinuar me lehtësuesit dhe përkrahësit ndërkombëtarë të këtij dialogu për shpërbërjen e strukturave ilegale në veri të Kosovës;
5. Plani për zëvendësimin e këtyre strukturave në pajtim të plotë me propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari dhe me Kushtetutën e Kosovës;
6. Garantuesit ndërkombëtarë për zbatimin e marrëveshjes eventuale për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës e Serbisë;
7. Propozimin për një pako të veçantë financiare zhvillimore për veriun e Kosovës, dhe
8. Synimin e definuar qartë se çfarë rezultatesh për konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës do të duhej të sillte normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë.

Për ne nuk ka dilema që ky normalizim duhet të mundësojë që Kosova të bëhet anëtare e OKB-s, e OSBE-s dhe e të gjitha mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë brenda një periudhe afatshkurtër kohore dhe që Kosova të vendosë më në fund raporte të mirëfillta kontraktuale me BE-në, duke iu shmangur solucioneve hibride që janë sot në fuqi.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, kryetarja e Grupit, e ka fjalën zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Duke marrë parasysh se Republika e Kosovës, si shtet i pavarur, me këtë jetëgjatësi të saj, e ka Kushtetutën e saj, e cila sqaron mjaft qartë rregullimin e brendshëm dhe të jashtëm në raport me fqinjë, mund të themi se Republika e Kosovës është duke kaluar në procesin më të rëndësishëm të konsolidimit të saj si shtet, veçanërisht pas përmbylljes së mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës.

Dhe në rast se e marrim rezolutën, e cila është propozuar sot, së bashku edhe nga grupi ynë parlamentar, mund të themi se i jep mundësi shumë të qartë Qeverisë që të vendosë në proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, së bashku me Kuvendin, gjë që është kërkuar nga të gjithë deputetët e këtij Kuvendi të dihet çka po ndodhë në procesin e bisedimeve teknike mes Kosovës dhe Serbisë dhe kjo të japë mundësinë që Kuvendi i Kosovës të

autorizojë Qeverinë e Kosovës edhe që të raportojë në Kuvend dhe në këtë proces të jetë edhe pjesëmarrëse edhe në komisionet e nevojshme të Kuvendit të Kosovës.

Mund të themi se, si grup parlamentar, e përkrahim këtë rezolutë dhe njëkohësisht shohim se në këtë kontekst institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara dhe të përkushtuara që të respektojnë dhe të plotësojnë kriteret e BE-s për fqinjësi dhe raporte të mira me vendet e rajonit. Mirëpo, jemi edhe për normalizimin e marrëdhënieve me Republikën e Serbisë duke respektuar sovranitetin e shtetit, integritetin territorial, ku me këtë çështje edhe Republika e Serbisë do ta njohë Republikën e Kosovës, dhe rregullimin e brendshëm të Kosovës, në mbështetje të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kjo do të jetë ndoshta edhe e gjithë esenca që Kuvendi dhe Qeveria të jenë me një gjuhë të përbashkët, duke marrë parasysh se të gjithë e përfaqësojmë Kosovën në vija politike, pavarësisht opozitë-pozitë.

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, zoti Miletic.

PETAR MILETIĆ: Poštovani gospodine predsedniče,
Poštovani predsedniče Vlade, članovi Vlade,
Koleginice i kolege poslanici,
Prilikom otpočinjenja prvog dela dijaloga između Prištine i Beograda, bezrezervno smo podržali proces, duboko verujući da nema drugog načina da se uspostavi trajan mir i stabilnost, kako bi stvorili uslove za bolji život građana.

Iako su dosadašnji pregovarači postigli određene dogovore, svedoci smo da dobar deo njih nije implementiran. To nas ne sme obeshrabriti da podržimo nastavak dijaloga i da bi svaki zastoј u ovom procesu skupo platili upravo građani.

Zato će Samostalna liberalna stranka ponovo podržati dijalog Prištine i Beograda, kako bi bili postignuti novi dogovori i kako bi u najskorije vreme počela implementacija dogovorenog.

Normalizacija odnosa Prištine i Beograda, nije u interesu samo pregovaračkih strana nego i šireg regiona, i smatram da je krajnje vreme da se situacija stabilizuje, da konačno krupnim koracima krenemo ka Evropskoj Uniji i vrednostima koje ona sa sobom nosi.

Potpuno smo svesni osetljivosti tema i trenutka i da će ovo biti dijalog u kome će se meriti svaka reč. Zato će na Vladi biti velika odgovornost, koju joj danas poverava Skupština, i svi oni koji budu učestvovali u razgovorima, bez sumnje će imati težak zadatak da naprave dogovore koje će voditi ka napretku društva.

Sasvim je sigurno da će biti onih koji će želeti da ovi razgovori ne uspeju i da ne donesu željene rezultate. Od njih očekujem kritiku dijaloga i pokušaje da dođu do jevtinih i populističkih poena.

Ohrabrujem zato Vladu da hrabro uđe u dijalog i da ne nasede na demagoške napade, jer sam siguran da će građani prepoznati napor da se situacija stabilizuje.

Poštovane kolegice i kolege,

Kao predstavnici Srba u Skupštini Kosova, izuzetno nam je stalo da ovaj dijalog uspe jer zbog nesređenih odnosa čini nam se najviše trpe naši sunarodnici.

Iskustvo iz dosadašnjih razloga Prištine i Beograda nam govori da su sve teme najviše ticale Srpske zajednice. Zato smatramo da bi uloga kosovskih Srba u budućem dijalogu mogla da bude od izuzetne važnosti za kvalitet procesa.

Doprinos koji mi kao legitimni predstavnici svoje zajednice u institucijama Kosova možemo da pružimo, proizilazi iz činjenice da se svakodnevno susrećemo sa svim problemima i izazovima koje ima naša zajednica i da ih u potpunosti osećamo.

Mi se stavljamo na raspolaganju Vladi, sa svim svojim kapacitetima kako bi dijalog dao rezultat i našim sunarodnicima ali i svim građanima Kosova olakšao život.

Treba izvući pouke iz dosadašnjeg dijaloga. Očekujemo da učesnici u pregovorima budu hrabri, transparentni i postignu dogovore koji se realno mogu implementirati.

Više je nego očigledno da je evropski put Kosova i Srbije uslovljen normalizacijom njihovih odnosa i zato pozdravljamo inicijativu Evropske Unije kao i podršku Sjedinjenih Američkih Država da se dijalog nastavi kako jedne druge ne bi spoticali na evropskom putu.

Treba iskoristiti posvećenost međunarodnih partnera da nam pomognu da rešimo probleme u oblasti energetike, telekomunikacija, situacije na severu Kosova, jer nam je za rešavanje ovih i sličnih problema njihova pomoć neophodna.

Otvaranje političkog dijaloga Samostalna liberalna stranka vidi kao potvrdu ispravnosti politike koju zastupa od svog osnivanja, a to je politika dijaloga, kompromisa i suživota. Od uspeha ovog dijaloga u mnogome će zavisići budućnost našeg evropskog puta, a samim tim i kvaliteta života svih građana na Kosovu, Srbiji i regionu. I zato, svima onima koji budu učestvovali u ovom procesu, želim puno uspeha.

KRYESUESI: Faleminderit! 6+, zonja Shinik.

MUFERA ŞINIK: Teşekkür ederim.

Sayın Başbakan, Bakanlar ve Milletvekilleri

Kosova-Sırbistan ilişkilerinin normalleşmesinin hem Kosova, hem bölge için çok önemli olduğu bilinmektedir. En son Başkanlık Kurulunda grup şefleri ile bu Rezolüsyonu n bugün Meclis oturumunda görüşülmesi kararı alınmıştır. Bu Rezolüsyonun önemini gözönünde bulundurarak ve durumun stabilleşmesiyle birlikte, Sırbistanın da diğer kalan ülkelerle birlikte Kosovayı tanıyacağına inanarak, 6+ Parlamenter Grubu önceden de imzamızla belli ettiğimiz gibi bu Rezolüsyonu destekleyecektir. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetëve. Sipas radhës, zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë,

Të respektuar deputetë,

Pas përfundimit të procesit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, Kosova po hyn në një fazë të re, në fazën e integritetit evropian. Në këtë proces, që është proces nacional dhe shumë i rëndësishëm, është shumë me rëndësi që Kosova, tani pa mbikëqyrjen ndërkombëtare, të ruajë partneritetin strategjik me partnerët kryesorë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian.

Dhe, fillimisht, më lejoni të shpreh falënderimin që ky proces i diskutimit dhe miratimit të kësaj rezolute, është konsultuar dhe diskutuar me partnerët kyç dhe ka arritur një shkallë të madhe të konsensusit nacional duke u përkrahur nga shumica e partive politike, që tregojnë se kur janë në pyetje interesat nacionale dhe shtetërore, ne dimë të udhëheqim politika shtetërore.

Tani më lejoni t'ju uroj për strukturën e kësaj rezolute dhe për qasjen institucionale dhe unë i shoh dy momente, dy momentume politike që janë shumë të rëndësishme në diskutimin tonë për këtë rezolutë.

E para, kjo rezolutë po diskutohet dhe propozohet të miratohet në një momentum shumë të përshtatshëm për Kosovën, në kohën kur Bashkimi Evropian i ka qartësuar pozicionet e veta në ruajtje të integritetit territorial edhe në kushtëzimin që i ka bërë Serbisë, në raportin e fundit lidhur me statusin e saj të kandidatit.

Momenti i dytë politik, është se mendoj që ky proces i kësaj rezolute dëshiron të orientojë procesin e dialogut dhe normalizimit në çështjet vitale në çështjet kyçe, sepse procesi i mëparshëm ka qenë i orientuar kryesisht në procese teknike. Ne e dimë se parësore, në raport me Serbinë, i kemi problemet politike, gjendjen që e kemi në komunat veriore të Kosovës, është një gjendje e papranueshme për Republikën e Kosovës. Kosova nuk duhet të pajtohet me status quo-n që e kemi në tri komunat në veri të Kosovës dhe dialogu është një proces me të cilin duhet t'i arrijmë interesa nacionale, sepse alternativa e dialogut është lufta dhe lufta është e papranueshme dhe dialogu është një vlerë civilizuese, raportet e normalizimit dhe të fqinjësisë së mirë janë vlerat evropiane, janë praktikatat evropiane që ne duhet t'i praktikojmë.

Unë uroj për këtë qasje institucionale edhe për faktin se rezoluta parasheh një veprim institucional të Qeverisë dhe të Parlamentit dhe kërkon një proces plotësisht institucional, sepse ka pasur hezitime që Kosova nuk guxon të kthehet në formë para institucionale çfarë i kemi pasur në kohën e funksionimit të Grupit të Unitetit dhe grupeve tjera.

Tani procesi tani po institucionalizohet, po duke e përfshirë Qeverinë që ka mandat kushtetues, por duke e përfshirë edhe Parlamentin që në frymën e kësaj rezolute ka rolin

kyç dhe vendimtar, sepse po e shihni që çfarëdo rezultati final apo marrëveshje do të ratifikohet në Parlament dhe Parlamenti do ta thotë fjalën e vet dhe ushtroi autoritetin kushtetues.

Tani, më lejoni t'i bëj disa propozime, po besoj se po flas edhe në emër të grupit parlamentar, sepse shefi i Grupit Parlamentar e prezantoi rezolutën. Unë i kam disa propozime që mendoj se e forcojnë rezolutën dhe propozoj që shefat e grupeve parlamentare t'i pranojnë dhe t'i harmonizojnë, sepse mendoj që do ta forcojnë rezolutën, pa e dëmtuar substancën e saj.

Mendoj se patjetër, qoftë në preambulën e rezolutës, apo edhe në ndonjërin prej pikave, duhet të hyjë kërkesa e Parlamentit të Kosovës për implementimin e marrëveshjeve të deritanishme, jo në formë të kushtëzimit apo parakushtit, por si një kërkesë legjitime për Bashkimin Evropian, për ata ndërmjetësues që të bëjnë përpjekje që të realizohen plotësisht marrëveshjet e arritura.

Propozimi im i dytë ka të bëjë me nenin 3. Neni 3 është një nen i fuqishëm dhe kryesor, zemra e kësaj rezolute dhe të nderuar kolegë, neni 3 përcakton të ashtuquajturat parime që asnjëherë nuk do të jenë pjesë e dialogut, apo çështje të panegocueshme dhe për mua janë të sistemuara mirë, sepse parimi i parë që e ka propozuar rezoluta është sovraniteti i Kosovës. Pra, është një çështje që asnjëherë nuk do të diskutohet.

Parimi i dytë, është subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës, që është subjektiviteti i një shteti sovran dhe të pavarur, që gjithnjë e më shumë po afirmohet në pikëpamje ndërkombëtare.

Parimi i tretë, është integriteti territorial që është shumë me rëndësi dhe është në pajtim edhe me frymën evropiane, edhe pse pesë shtetet e Bashkimit Evropian nuk e kanë njohur Kosovën, ato janë pajtuar ky t'i vendoset një kusht themelor Serbisë në proceset e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Parimi i katërt, që ka vendosur pika 3, është rregullimi i brendshëm kushtetues. Unë do të propozoja që këtij parimi të katërt, apo pika 3 të plotësohet edhe me një kërkesë apo edhe me një çështje tjetër që është rendi unik kushtetues, i cili është përcaktuar si vlerë fundamentale e shtetit, në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pse po e propozoj rendin unik kushtetues, sepse rendi unik kushtetues mënjanon çfarëdo asimetrie në jetën kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe siguron shtrirjen e legjislacionit dhe të Kushtetutës në tërë territorin e Kosovës dhe ndalon çfarëdo organizimi apo çfarëdo zgjidhje tjetër që nuk është në pajtim me Kushtetutën aktuale dhe me ligjet aktuale, dhe mendoj se kjo nuk e prishë balancën e kësaj rezolute, por përkundrazi mendoj se e forcon.

Momenti i tretë, të cilin unë do ta diskutoj, është përfshirja e komisioneve parlamentare, që është jashtëzakonisht me rëndësi, por është me rëndësi edhe të përdoret një fjali më

fleksibile dhe të thuhet se do të përfshihen komisionet përkatëse, varësisht nga nevoja, varësisht nga tema që do të diskutohet.

Në pikën 6, thuhet rezultati final. Mendoj se kjo shprehje nuk është tipike as për ligje as për rezoluta, por duhet të zëvendësohet me fjalën “marrëveshja ose marrëveshjet”. Tash nuk jemi të sigurt si do të konkludohet procesi, a do të konkludohet me një marrëveshje gjenerale për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, apo do të kemi marrëveshje sektoriale dhe mendoj që në vend të fjalës “rezultati final” duhet të jetë fjala “marrëveshjet” apo “marrëveshja finale do të ratifikohet në Kuvend” që Kuvendin e vendosë në kapacitetin e plotë vendimmarrës kushtetues, sepse siç e dini, cilado marrëveshje që vjen në Kuvend do të kërkojë 2/3-at dhe kjo siguron gjithëpërfshirjen apo trajtimin e saj si çështje shtetërore.

Dëshiroj t’i theksoj dy çështje, që janë jashtë shkronjave të kësaj rezolute dhe që rezoluta në një mënyrë i përcakton.

E tha edhe zoti Blerim Shala, mendoj jashtëzakonisht mirë që rezoluta është një dokument politik, pragmatik, dy faqe që është tipike, por pas rezolutës ne duhet të kemi strategji dhe platformë konkrete.

Është ky një proces tani vendor, tani jemi shtet sovran dhe i pavarur dhe ne kemi rastin të demonstrojmë një qasje pro aktive, një proces vendor që do të mbështetet nga ndërkombëtarët, por ne duhet t’i dimë qëllimet tona, cilat janë qëllimet tona në këtë proces, cilat janë synimet tona legjitime? Ne kemi nevojë të hyjmë në këtë proces, sepse ne nuk mund të pajtohemi me gjendjen, nuk mundemi t’i ikim procesit, nuk mund të themi nuk domi dhe edhe një vjet a dy, le të bëhet kjo. OK! Por atëherë po pajtohemi që edhe një vjet, a dy, do të kemi status quo, në veri. Dhe, në qoftë se themi duhet të kryhet një herë ky proces, ne sot do të ishim të kënaqur që një vit a dy të presim në proces.

Pra, kërkohet që rezoluta të shoqërohet me platformë të azhurnuar politike, me platformë të qartë, me strategji eventuale për fusha të caktuara dhe kërkohet që qasja të jetë jashtëzakonisht serioze, qasja të jetë shtetërore, e përgatitur dhe ashtu siç është premtuar me rezolutë, të ketë jo vetëm informim për rezultatin final, por informim edhe periodik pas cikleve të rezultateve në mënyrë që procesi të jetë plotësisht transparent dhe opinioni të njoftohet për çfarëdo përparimi në procesin e bisedimeve dhe që ne të jemi plotësisht të sinqertë me opinionin dhe këtë proces ta shpjegojmë se është proces në të mirën e Kosovës dhe ky proces duhet të konkludohet apo finalizohet me njohjen e Republikës së Kosovës nga Republika e Serbisë, me njohje reciproke, dhe ky proces duhet të mundësojë që Kosova t’i zgjidhë problemet që i ka në veri dhe të përparojë në agjendën evropiane.

Unë uroj që të sigurojmë një diskutim jashtëzakonisht konsensual, uroj që kjo temë mos të jetë temë e përplasjeve politike, që janë tipike për pluralizëm, për demokraci parlamentare dhe uroj t’i qasemi shumë më racionalë, të dalim unikë dhe të sigurojmë favore politike të momentumit politik që mund t’i sigurojë Kosovës faktin se Kosova po tregohet pro aktive duke e miratuar një rezolutë me të cilën presionin e procesit të normalizimit dhe të dialogut do ta vendosë tek Serbia, e cila duhet të reflektojë dhe

kthjellet politikisht dhe duhet të kuptojë se gjendja e status quo-s apo gjendja e agresionit kushtetues në veri nuk mund të mbahet dhe duhet të fillojë një proces substancial i dialogut dhe të mundësojë shtrirje të plotë të sovranitetit dhe Kushtetutës së Kosovës, shpërbërjen e të gjitha strukturave jokushtetuese dhe jo ligjore dhe vendosjen e parimit të sundimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hamiti, nënkryetar i Kuvendit.

SABRI HAMITI: Faleminderit zoti kryesues i seancës, Haliti!

Kolegë deputetë dhe Kabinet qeverisës i Kosovës,

E thashë pak më herët, po e them edhe tash, nuk ka kurrfarë urgjence në Kosovë, në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës, që të krijohet sot a nesër një dokument për normalizim, ose ta përkthejmë më qartë - për bisedime me Serbinë.

Pra, po insisto, nuk ka urgjencë. Kjo i bie, meqë s'ka urgjencë, nëse është e nevojshme të mendohet shtruar në të gjitha nivelet e institucioneve të Republikës së Kosovës, të bisedohet, të shohitet dhe, në fund, nëse ka nevojë edhe të bëhet rezoluta dhe diçka përtej saj. Po, meqë tash është në rend dite, duhet ta themi fjalën tonë.

E dyta, LDK-ja nuk ka njoftim direkt nga lideri i saj, që e ka emrin Isa Mustafa, që ka dhënë pajtim, se u tha këtu, për një tekst të tillë, se LDK-ja këtë tekst e ka marrë në dorë para 2-3 ditësh, kur zoti Mustafa ka qenë në Kongresin e Partive Popullore Evropiane, që është duke u mbajtur në Bukuresht, atje është edhe tash dhe e kemi një lajm shumë të mirë se LDK-ja është pranuar si anëtare e partive popullore, ose të djathta evropiane.

Pra, nuk është mirë të shpallim gjëra që s'ekzistojnë në Grupin Parlamentar të LDK-së dhe nuk ma merr mendja që do të marrim ne porosi të liderit tonë nëpërmjet grupeve tjera parlamentare, se do të ishte non sens.

Tash unë dua të flas si deputet, përfaqësues i atyre 30 e sa mijë njerëzve që më kanë votuar, për interesin e tyre, dhe natyrisht edhe emrin tim personal, që është edhe përtej një mandati deputeti.

Mendoj që në situatën, në të cilën jemi ne, nuk është dashur ta propozojnë në Kuvendin e Kosovës një projektrezolutë partitë. As partia. Pse? Sepse, ne e kemi një zhvillim politik, edhe deklarativ, edhe jodeklarativ, që këto bisedime, ose ky dialog me Serbinë, zonja e zotërinj, në një formë po ndodh.

Takimet Thaçi - Eshton, ose ministrat e tij, nuk besoj se bëhen për sport, por bëhen agjenda politike. Sigurisht, takime të tilla ka edhe ana tjetër, për të cilën po flasim.

Më në fund, ne kemi dëgjuar disa herë të përsëritura nga Qeveria, nga kryeministri, ministri i Jashtëm dhe zonja Tahiri, që ka biseduar më herët, formulime të këtilla. Tahiri thotë: "Nuk duhet të bisedohet tutje pa u realizuar marrëveshjet që janë arritur më herët". Ministri i Jashtëm thotë, dje së fundi: "Qeveria e Kosovës është e gatshme të hyjë në dialog politik me Serbinë, dhe pikë". Pra, meqë ne e kemi këtë prononcim publik politik

të Qeverisë rreth kësaj çështjeje dhe kemi edhe indice që ndodhin bisedime që nuk janë krejt publike, atëherë unë kam pritur që Qeveria, si institucion që e drejton vendin, t'i drejtohet Parlamentit me kërkesat e veta shumë të qarta: "Zotërinj parlamentarë, Kuvend i nderuar, ne e kemi dhënë këtë premtim, kemi bërë këtë marrëveshje, ne duhet kjo leje, ose ky miratim", dhe të vijë në Parlament.

Atëherë, do të ishte shumë më lehtë, për çdo parti, pozitë dhe opozitë, që në Parlament të bisedohet dhe të krijohet konsensusi më i madh i mundshëm për problemet, të cilat e presin Parlamentin, e presin Qeverinë dhe institucionet tjera të Kosovës.

Pra, mungesa për mua e parë është - pse të sponsorohet nga partitë? Nëse janë partitë qeveritare, pse t'i marrin ata, le t'i marrë Qeveria, i zbret në Parlament?

Tutje, unë e lexova këtë tekst dhe në kuptimin elementar duket një variant i një rezolute që e kemi bërë në vitin e kaluar, mirëpo sherri, a dreqi a rri në detaje.

Tash këtu e kemi një formulim të ri që thotë: "Normalizimi i marrëdhënieve", edhe flitet për njëfarë procesi. Ne i kemi dy terme, valixhe, strajcë, ku mund të hyjë çka të doni dhe mund të mos hyjë bash kurrëgjë. Pse? Procesi është fillim, mes, pafund, s'ka kohë. Normalizimi ka kuptim tjetër. Nëse keni normalizim të marrëdhënieve që pësojnë një defekt rrugës me një shtet që njiheni, keni pasur marrëdhënie, janë prishur në një moment. Ne kemi të bëjmë punë me një shtet, i cili e ka provuar gjenocidin në Kosovë, nuk e ka realizuar, por e ka provuar, i cili e ka një qeveri që është ricikluar sot me atë që e ka provuar gjenocidin dhe e cila s'e thotë asnjë fjalë njohje, të njohuri në ambientin e vet, që ky vend ka provuar gjenocid në Kosovë; bërë ployë, ka rrënuar, ka mbytur njerëz, ka vjedhur më në fund dokumente, të mira materiale dhe ka rrënuar shtëpi. Unë nuk po jap shifra, se ato dihen.

Pra, nëse duhet të hartohet një rezolute e Kuvendit të Kosovës, e kërkuar qoftë nga Qeveria, për normalizimin e marrëdhënieve, duhet ta dimë me kë.

Pra, kjo i bie një vullnet i mirë, njëfarë lutje, ne u themi atyre "po i ndreqim marrëdhëniet". Nuk ndreqen ashtu, edhe për arsyen tjetër, sepse ata po thonë për çdo ditë: "S'e japim Kosovën për BE", kështu po thotë kryetari i Serbisë.

Ju mund të thoni, "hajt se janë këto deklarata populliste, qysh e kemi zanat". jo, jo, nuk janë krejt populliste, sepse ato janë programe të radikalëve, kanë qenë përherë.

Unë nuk po i numëroj, por po dua të them që problemi është se kemi të bëjmë me një pozicionim politik, normalizim marrëdhëniesh me atë, i cili thotë: "Unë ty nuk të njoh, ty s'të kam bërë asgjë, dhe hajde pajtohem".

E tash vjen puna, instrumenti për t'i përmirësuar marrëdhëniet qenka dialogu. Në rregull, e thamë edhe ne, është universale, dhe thuhet ashtu. Veç mua s'më pëlqen as sot që po thuhet këtu, mos harroni shpejt, kolegë të nderuar, se thuhet - i vetmi instrument qenka dialogu. Atëherë, kjo UÇK-ja dhe lufta jonë e famshme paska qenë gabim, pra, se ajo

dialog s'ka qenë, po ka qenë qëndresë për ta shpëtuar një popullsi të rrezikuar me gjenocid. Të kemi kujdes në formulime, sepse kalkulimet politike nganjëherë na bëjnë të paarsyeshëm. E ne s'kemi arsye të bëhemi të paarsyeshëm, në asnjë moment. Hiç, tash bile hiç se hiç.

Dhe, po kaloj tash te këto formulime. Unë mendoj që ky tekst si është nuk duhet të votohet, si është i formuluar.

Provën e parë e tha në një mënyrë zoti Bajrami dhe i ka dy-tri reflektime që janë shumë të sakta, shumë të mira. Nuk mund kështu si është.

E dyta, kjo rezolutë është veç sa për t'ia dhënë një dritë jeshile Qeverisë së Kosovës, e t'i thuash merre ti barrën e bën çfarë të duash se ne i lamë duart, e shko ti hyr në betejë, nuk është korrekte as ndaj Kuvendit, as ndaj Qeverisë.

Duhet të sanksionohet saktë. Nëse Kuvendi i thotë Qeverisë, merre këtë punë se je ekzekutiv, atëherë Kuvendi duhet t'i thotë Qeverisë, po, po vetëm se ne paraprakisht e duam në Kuvend strategjinë, mënyrat e dialogut, qëllimin ku mbërrihet, ose ku nuk mbërrihet kurrë. Përndryshe, nuk ka komunikim ndërmjet dy institucioneve, që e kushtëzojnë ose i japin leje njëri-tjetrit.

Kështu që, po e zëmë, nëse atje thuhet: Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon parimin që ky proces ndërmjet Republikës së Kosovës e të Serbisë të lehtësohet nga BE-ja dhe në mbështetje të fuqishme në SHBA, duhet ndryshe të thuhet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Atëherë, ia mundësoni edhe dy minuta.

SABRI HAMITI: E pra, e dyta, nëse u tha ajo që e plotësoi Bajrami: “duhet të jenë në pajtim” - s'ka duhet të jenë në pajtim. Thuhet: nuk do të bisedohet për sovranitetin, e këtë, e këtë. Nuk do të bisedohet, pasi ne po themi që ato s'i pranojmë.

Tutje, nëse Qeveria e Kosovës e merr këtë detyrë, hiqen këto farë komisionesh që janë, duke e sjellë paraprakisht në Parlament strategjinë dhe qëllimin.

Dhe, në fund, s'ka “rezultati i procesit”, por marrëveshjet ndërmjet dy shteteve duhet të ratifikohen me 2/3 në Kuvendin e Kosovës.

Përndryshe, unë nuk kam qejf të përsëritet ajo që na është përsëritur dhe unë po jua tregoj një situatë të vitit të largët, 1700 e sa, kur priftërinjtë e Pultit, pasi u kishte bërë pasha plojë, i luten që t'ua lëshojë një fëmijë nëntëvjeçar rob, i cili nuk konvertohet, sepse fëmija nuk di. I kanë thënë dhe është bindur, por s'konvertohet. Po problemi i tekstit, është i dyfishëm. Fillon si ankesë, e mbaron si lutje. Dhe, u thotë: Na bëfshi mirë, i lutem Zotit t'ju bëjë mirë; na bëfshi keq do t'i lutemi Zotit t'ju bëjë keq”. Por, përfundimi është i çuditshëm, se thotë : “Mbetemi shërbëtorët tuaj”.

Nuk ka shans në një komunikim dhe nevojë të këtyllë të interesit qytetar të ketë, të shtihet në gjynah dikush, i cili e ka provuar gjenocidin me forma të tilla.

Kosova, Qeveria, Kuvendi duhet të bashkëpunojnë totalisht, nëse duan ta mbërrijnë një sukses në këto biseda, nëse jo - ne do të bëhemi si priftërinjtë e Pultit të vitit 1700 e sa. Unë uroj që të mos ndodhë ajo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama, e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në lidhje me këtë rezolutë, mua më bëri përshtypje fjala “normalizim”. Normalizimi mes dy shteteve mund të ndodhë kur ato janë normale, dhe sillen në mënyrë normale me njëri-tjetrit, ose ndaj njëri-tjetrit. Pra nuk janë agresive, nuk pushtojnë territorin e njëri-tjetrit, ky është minimumi.

Ajo që duhet të shtyhet përpara nga Bashkimi Evropian, është normalizimi i Serbisë. Ky është procesi i nevojshëm sot e normalizim i saj do të thotë që ky shtet të kalojë nëpër procese që kanë kaluar dy vende pas Luftës së Dytë Botërore.

Për shkak të luftërave dhe krimeve të kryera, Gjermania kaloi nëpër procesin e denacifikimit, ndërsa Japonia nëpër procesin e demilitarizimit. Por, e kemi edhe rastin e Irakut të sotëm i cili po kalon nëpër procesin e debastifikimit.

Nëpër cilin proces ka kaluar Serbia, që të shikëputet nga e kaluara? Që ky shtet të bëhet normal, duhet të kalojë nëpërmjet defashistizimit. Duhet të krijojë komisione të së vërtetës dhe populli serb të bëjë katarsisin. Serbia ende nuk ka kërkuar falje për krimet e luftës, gjë që do të thotë se politika dhe populli atje mendon se kanë bërë mirë që kanë vrarë njerëz, ndërsa kërkim -falja do të ishte minimumi, pasi ajo nuk i kthen në jetë ata që ua mori jetën, mirëpo vetëm një hap moral.

E pra, Qeveria e Kosovës që na e ka sjellë rezolutën, e ka kuptuar gabim këtë proces. Në vend që të kërkojë nga Bashkimi Evropian normalizim të Serbisë, e fut vetën në një thes me atë që ka kryer krime dhe gjenocid, që kanë abuzuar në të shkuarën.

Kjo rezolutë e tredhur është shumë jodinjitoze, dhe mbi të gjitha, nuk paraqet vullnetin e popullit të Kosovës, është një rezolutë servile, që në të vërtetë qëllim përfundimtar ka qëndrimin në pushtet të atyre që e propozojmë.

Është interesant se siç do proces pozitiv që ndodh me Kosovën, kjo Qeveri e paaftë e neutralizon apo e kthen kundër vetes.

Të njëjtën gjë e bën kur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë legjitimoi shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Çfarë bëri Qeveria? Menjëherë, pas saj, hyri në bisedime. Edhe tani që Bashkimi Evropian ia çoi mesazhin e qartë Serbisë, se duhet të njohë integritetin territorial të Kosovës, Qeveria propozon të hyjë në bisedime pa asnjë kusht.

Të mos harrojmë gjithashtu se marrëveshjet e arritura ne Bruksel, që kjo Qeveri i paraqiti si pozitive, nuk po respektohen. Pra Qeveria hyn në bisedime për të arritur marrëveshje që Serbia nuk i respekton .

Është tepër e çuditshme se si qeveria kërkon ta bëjë Kosovën servis të një shteti tjetër, e jo i çfarëdo shteti, por Serbisë që vrau e masakroi për një shekull.

Në fakt për normalizim, dhe Qeveria ka nevojë t'i normalizojë raportet me opozitën, të zhvillojë dialog të brendshëm dhe të sillet si qeveri demokratike dhe jo autokratike siç po bën aktualisht.

Dhe në fund, kam një pyetje për kryeministrin, se si u bë që Qeveria e tij ka dhënë leje që materialet e filmuara të bisedimeve që janë zhvilluar në Bruksel, të shfaqen në publik, në formën e një dokumentari, ndërkohë që Parlamentin nuk kanë pranuar ta njoftojnë me as me përmbajtjen e shkruar të tyre?

Është një material prej 80 orësh filmime nga bisedimet në Bruksel që tashmë gjendet në duart e një produksioni privat, për të cilin kam informacion se kur të shfaqet do të bën një shou shumë të madh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajraktari!

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përmbajtja e rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë, konsideroj që është e mirë dhe është në të mirën e vendit. Por, çështja e personave të pagjetur, si çështje e dhembshme e Kosovës, duhet të jetë prioritet në platformën e bisedimeve, aepse pavarësisht situatave politike nëpër të cilat kalon Kosova, dhimbja e familjarëve është shumë e madhe.

Unë qëndroj edhe më fuqishëm në kërkesën time, të bëhet zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe të respektohen vendimet e Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë e kam marrë këtë rezolutë dhe e kam lexuar disa herë, dhe ta them të vërtetën asnjëherë nuk kam arritur ta kuptoj në esencë se për çfarë bëhet fjala.

Është fjala për një lutje që i bëhet dikujt, është fjala për një kërkesë, apo është fjala për një dëshirë të madhe për t'i ndihmuar dikujt që të integrohet në Bashkimin Evropian duke sakrifikuar interesat e tij.

Megjithatë, unë po i shpreh mendimet e mia. E para, rezoluta kur hartohet dhe dërgohet në Parlament do të duhej të kihej parasysh, sepse ne më 10 maj, mesa më kujtohet data, e kemi votuar një rezolutë në këtë Parlament, që kushtëzoheshin bisedimet me Serbinë, me zbardhjen e fatit të pagjeturve. Dhe, normalisht nëse Parlamentit do t'i parashtrohej përsëri një rezolutë, së pari do të duhej të shfuqizohej ajo, sepse kjo rezolutë, mesa unë po e kuptoj pjesërisht, është një kërkesë që t'i lejohet Qeverisë t'i fillojë bisedimet me Serbinë.

Por, megjithatë, do të ishte mirë që para se të bëhet kjo, ose të paktën edhe në këtë rezolutë, do të vihej disa parakushte përpara se të fillonte normalizimi i marrëdhënie me Serbinë ose të fillonin bisedat me Serbinë, dhe ato kushte bile të paktën do të duhej të ishin minimale, së pari që të hiqet barrikada mbi lumin Ibër dhe të shfuqizohen ose të shpërbëhen ato struktura paralele në pjesën veriore të Kosovës.

Edhe kjo në rezolutë nuk është paraparë, por çfarë është edhe një çështje tjetër, Qeveria këtë rezolutë e dërgon në Parlament, pa hartimin e një strategjie rreth bisedave që do të bënte me Serbinë. Edhe kjo është një e metë shumë e madhe, dhe tash është e kotë që mundohemi ta plotësojmë, sepse de fakto ka qenë dashur me kohë të plotësohet, me kohë të paraqiten edhe kushtet dhe me kohë të bisedohet më gjerë e të shtrohen problemet që na lidhin karshi Serbisë.

Ne po e hartojmë një rezolutë dhe në raport me kë po e hartojmë, në raport me Serbinë, me një shtet i cili nuk na njeh dhe që në kushtetutën e vet e sheh Kosovën si pjesë integrale të saj, me një shtet i cili ka bërë gjenocid në Kosovë, që ka vrarë e masakruar mijëra njerëz, që në fund të fundit ka dhunuar mijëra motra e nëna tona dhe asnjëherë nuk e ka parë të arsyeshme të kërkojë falje për krejt atë që e ka bërë.

Dëshiroj ta them edhe këtë, se ky veprim i tillë, në këto momente kur Bashkimi Evropian dhe faktori ndërkombëtar gjithnjë e më tepër po kërkon nga Serbia që të njohë pavarësinë e Kosovës, është edhe më i panatyrshëm dhe më i paarsyeshëm, sepse Qeveria e Kosovës dhe Parlamenti i Kosovës do të duhej në mënyrë të qartë t'i bëjnë Serbisë se s'ka normalizim të marrëdhënieve me Kosovën, të paktën pa e njohur pavarësinë e Kosovës, pa i shpërbërë ato struktura paralele në pjesën veriore, pa zbardhjen e të gjithë atyre të pagjeturve dhe në fund të fundit pa kërkuar falje për atë gjenocid që e ka bërë, jo vetëm gjatë luftës, por edhe para luftës.

Unë në asnjë mënyrë nuk mund të shkel mbi votën time që e kam dhënë në Rezolutën e kaluar, që të kushtëzohen bisedimet e Serbisë me fatin e të pagjeturve dhe qëndroj fuqimisht në atë deklaram timin dhe në atë votë timen.

Por, sot po kërkoj, edhe nga deputetët tjerë që të mos votojnë për bisedime me Serbinë, sepse votojnë kot, votojnë shumë kot, për arsye se Serbia nuk na njeh, nuk na njeh si shtet, s'na njeh si faktor në fund të fundit dhe tash, përpjekjet tona për të normalizuar marrëdhëniet me dikë që s'na njeh, janë përpjekje të kota.

Unë, në fund të fundit, një rezolutë të tillë do ta quaja rezolutë me një term që ndoshta dikujt nuk do t'i pëlqente, po do ta quaja rezolutë e turpit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Trajković e ka fjalën.

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani predsjedavajući,

Poštovane kolege poslanici,

Ja želim, zaista vrlo kratko da govorim. Pripadam ljudima, koja u kontinuitetu je podržavala razgovore između Srbije i Prištine kao rezultat i kao želju za normalizaciju odnosa koja će doneti mir pre svega običnim ljudima a ekonomski prosperitet koji će omogućiti da bezbednost na ovom prostoru privuče investitore kao jedno normalno područje.

Ja sam ušla u ovom Parlamentu da budem partner većinskim predstavnicima, mislim na moje kolege pre svega Albance, i mnogi ponosni Albanci će me razumeti. Ja sam Srpkinja i ja potpuno negiram i odbijam kao ne većinsko srpsko opredeljenje ono što je izgovorio gospodin Petar Miletić.

Mi ne možemo podržati rezoluciju koja definiše prostor Kosova i Metohije kao teritorijalni integritet i suverenitet. Sve ostalo, nije sporno. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Është mendim i juaj! Zoti Skender Hyseni e ka fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra, sa qenkeni këtu,

Normalizimi i marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, është çështje tejet e rëndësishme për të dyja vendet, dhe ai normalizim duhet të ndodhë, guxon të ndodhë dhe do të ndodhë vetëm si normalizim midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Dhe në këtë pikë kujtoj unë, konsiston defekti kryesor në të gjitha përpjekjet e deritashme për të bërë dialog midis dy vendeve, i cili prorrë është definuar si dialog Prishtinë - Beograd, madje edhe këtu sot dëgjua që duhet të ketë dialog midis Republikës së Serbisë dhe Prishtinës.

Mos strukturimi i nevojshëm, mungesa e kornizimit të saktë të dialogut, vetëm sa do të prodhojë konsekuenca dhe pasoja të mëtejme në marrëdhëniet midis dy vendeve të pavarura dhe sovraane.

Pa u vonuar, më lejoni të them që dialogu me Republikën e Serbisë, për normalizim marrëdhëniesh, për ndërtim fqinjësie të qëndrueshme, s'po them as të mirë as të keqe, është i domosdoshëm dhe Republika e Kosovës nuk duhet të ketë frikë nga ky lloj dialogu. Përkundrazi, Republika e Kosovës duhet të insistojë në dialog, po Republika e Kosovës duhet të insistojë në dialog midis dy shtetesh të pavarura dhe sovraane.

Ndonëse ky insistim mund të jetë pak i vonuar, pas konsensioneve qesharake që Republika e Kosovës ka bërë në dialogun e deritashëm të ashtuquajtur teknik dhe nga ato

konsensione më i dhimbshmi është pranimi, pëlqimi që Republika e Kosovës ka dhënë që fusnota t'i referohet Rezolutës 1244.

Shumë kush nga ju kolegë të nderuar dhe të tjerë, mund të thonë po ajo rezolutë është ende në fuqi ashtu-kështu. Kjo është e saktë formalisht është në fuqi, po jo me pëlqimin e Kosovës. Ajo rezolutë nuk ka qenë në fuqi me pëlqimin e Kosovës deri në pajtimin që Kosova ka dhënë pa nevojë krejt në mënyrë shumë të ngutshme, kujtoj unë krejtësisht padobishme dhe siç po e shohim ato marrëveshjet qesharake që nuk janë marrëveshje, sepse nuk kanë instrument arbitrimi ndërkombëtar për zbatim, janë të pazbatueshme dhe kot thërrasim ne për zbatimin e atyre marrëveshjeve, sepse janë të pazbatueshme.

Ne duhet të nxjerrim mësim nga përvoja e deritashme dhe të bëjmë përpjekje maksimale që t'i korrigjojmë gabimet strategjike që janë bërë në procesin e deritashëm në mënyrë që të evitohen gabime edhe më të rënda strategjike. Domethënë, pyetja nuk duhet shtruar a duhet bërë dialog me Serbinë, a nuk duhet, po pyetja duhet shtruar çfarë dialogu po bëjmë me Serbinë, a është dialog midis dy shtetesh, apo jo?

Kosova në këtë proces do të hyjë ndjeshëm e hendikepuar sërish po them për shkak të fusnotës. Mirëpo, ky hendikep mund të riparohet nëse Kosova përfundimisht fillon të sillet si shtet i pavarur dhe sovran.

Nëse Kosova përfundimisht, në ndërtimin e marrëdhënieve të tashme me Republikën e Serbisë, absolutisht sillet në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe assesi ndryshe.

Dhe të nderuar kolegë,

E ardhmja e mirë fqinjësore midis dy vendeve të pavarura dhe sovrane ka perspektivë dhe është e sigurt vetëm në rast se Kosova sillet si shtet në këto raporte dhe në këtë dialog.

Kjo kërkon konsistencë, kërkon qëndrueshmëri, kërkon bindje, kërkon këmbëngulje dhe vizion, nuk janë të lehta këto, mirëpo janë të mundshme. Me qenë se janë të mundshme, atëherë Kosova përfundimisht duhet ta marrë një qëndrim të fortë dhe qëndrim i fortë do të thotë të sillet si shtet, të hyjë në dialog me Republikën e Serbisë, por në atë dialog ekskluzivisht të sillet dhe të pajtohet me zgjidhje midis dy shtetesh të cilat synojnë normalizimin e plotë të marrëdhënieve deri në njohjen e plotë reciproke si dy shtete të pavarura dhe sovrane. Nëse ky është objektivi i bisedimeve me Serbinë, Kosova nuk ka nevojë të ketë frikë. Kosova duhet të ketë frikë shumë nga gatishmëria e ndonjë bartësi të dialogut me Serbinë për të bërë koncesione të papranueshme dhe kjo duhet të thuhet qartë. Kjo duhet thuhet qartë edhe në atë që është kërkim dhe insistim në një partneritet të pazëvendësueshëm strategjik me BE-në dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet ta përkrahin Kosovën në arritjen e zgjidhjeve shumë të vështira me Republikën e Serbisë, që do të thotë njohje reciproke në kufijtë ekzistues duke e ruajtur me çdo kusht unitaritetin e Republikës së Kosovës, ose atë që është karakter unitar, rregullimin e brendshëm të Republikës së Kosovës. Nuk guxon Kosova të shkojë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk guxon të

bisedojë me askënd për rregullimin e brendshëm të vendit. Kosova duhet dhe do të bisedojë me Republikën e Serbisë, pashmangshëm për vendosjen e marrëdhënieve afatgjata midis dy vendesh. Edhe këtu i kam dy fjalë.

Raportet Kosovë - Serbi nuk durojnë importim të modeleve që janë aplikuar në vendet tjera dhe në situata tjera, sepse është një situatë krejt e veçantë. Ky normalizim marrëdhëniesh mund të tolerojë, mund të durojë aplikim të ndonjë elementi që është aplikuar midis vendesh të ndryshme gjetiu, po assesi nuk guxon dhe nuk duron importim komplet të modeleve siç po përfliten këto ditë në media modele të ndryshme që janë aplikuar gjetiu në botë.

Është një situatë shumë e veçantë dhe kërkon një aranzhman krejtësisht të veçantë dhe ai aranzhman, të nderuar deputetë, të nderuar pjesëtarë të Qeverisë, nuk guxon të shkojë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sot jemi më 2012, nuk jemi në 2005, as 2006, as 2007, Kosova ka institucione, është shtet i pavarur dhe sovran dhe nuk duron po ashtu kurrfarë strukturash parashtetërore, kurrfarë strukturash parapolitike, ka institucione dhe janë ato institucione që e kanë përgjegjësinë e mbrojtjes të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja e zotërinj,

Ju përshëndes të gjithëve dhe e përshëndes e mirëpres ta them më mirë edhe këtë nismë, dhe dua t'i falënderoj ata që kanë ndihmuar në këtë proces, sado që nganjëherë është vështirë ta ndihmosh dike që nuk e ndihmon sa duhet vetveten.

S'mund të mos e mirëpres çfarëdo nisme që është në favor të normalizimit, që është në favor të fqinjësisë së mirë, por s'mund mos e them edhe faktin se kësaj i thonë edhe ta bësh të bërën.

Kosova dhe ky Kuvend ka dëshmuar sa e sa herë përkushtimin për paqe, për fqinjësi, për normalizim, bile edhe përtej kësaj.

Edhe një proverb shqiptar është- thotë: "Fqinji i mirë është dera e parajsës", po fqinji i mirë, fqinji jo i mirë i bie që të jetë e kundërta e kësaj. Po thonë që të bëhesh fqinj i mirë që donë fqinj të mirë, bëhu fqinj i mirë, po për të pasur fqinjësi të mirë duhen dy palë dhe duhet një vullnet për të trajtuar tjetrin si të barabartë.

Shumë vite më parë tash, po bëhen gati 20 vjet, në Uashington që bërë një tryezë, e para ka qenë shqiptaro – serbe dhe në atë tryezë zoti Vuk Drashković, fliste si burrështetasi i ardhshëm dhe pas i bëri disa komplimente Adem Demaçit e tha që e ka për nderë që bisedon me një njeri të martirizuar si Mandela e tjera dhe do të ishte gati që të bëjë çdo ndryshim edhe për shkak të respektit të tij, por duke insistuar në atë që pavarësia nuk bën

të përmendet, pavarësi nuk ka, pavarësia është luftë. Dhe përgjigja e Adem Demaçit ishte reciproke, respekt për aq sa meritohet, po kjo që dëgjohej është e ngjashme me mënyrën se si bisedonin autoritetet e burgut. Ne mund të kemi respekt për ty, po t'i duhesh të jesh brenda burgut, të respektosh rendin shtëpiak të burgut dhe përgjigja e tij ishte: ka mbaruar zoti Drashkoviq koha kur mund të bisedohet në raporte të tilla, ka dalë zogu prej vezës.

Prandaj, edhe diskursi që e dëgjojmë nga fqinji ynë verior me të cilin natyrshëm do të dëshironim të ishim në raporte normale, vazhdon të jetë i tillë. Mund të bisedoj me Prishtinë - thonë, por ama sipas asaj zgjidh si të duash ti, ndash ti qiraxhi e unë i zoti i shtëpisë, në dash unë zoti i shtëpisë e ti qiraxhi, nuk ka bisedime me këtë logjikë, nuk ka as normalizim. Madje, as me tonin që po dëgjohej ndonjëherë edhe këtu brenda në këtë Kuvend.

Ka edhe çështje të pazgjidhura dhe Kosova nuk ka asnjë arsye që t'i ikë dialogut edhe politik edhe për zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura, por vetëm si të barabartë, vetëm duke i trajtuar si probleme ekuivalente dhe duke kërkuar zgjidhje ekuivalente për çështjet që janë ekuivalente. Është problem ende i pazgjidhur me gjithë përpjekjet tona, vërtet të jashtëzakonshme, çështja e pozitës, trajtimit, të drejtave të komunitetit serb në Kosovë sidomos në disa komuna.

Por, s'mund të harrohet se ka problem po aq të madh, bile edhe më të madh edhe më të ndjeshëm në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe të Medvegjës. Ka ndodhur një spastrim etnikë në Medvegjë, janë dëbuar njerëzit, askush nuk e përmend këtë. Pse nuk duhet të trajtohen në mënyrë reciproke, me standardet evropiane, me standarde ndërkombëtare s'po kërkojmë kurrëgjë më shumë. Dhe në atë rast do të hynim në garë që të japim shembullin se ne jemi në gjendje të avancojmë në trajtimin e të drejtave të minoriteve edhe me integrimin edhe në favorizimin aty ku është e mundshme.

Në funksion të një qasje të tillë s'do mend që e mbështesim edhe një rezolutë të përsëritur. Por mendoj duke e trajtuar atë drejt, nëse është kjo rezolutë për marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë, quaje qysh të duash, nëse është e politikës së jashtme, do të duhej trajtuar edhe si e tillë, prandaj, do të duhej të kalonte edhe nëpër Komisionin e Jashtëm.

Mendoj, po ashtu që rezolutës i duhen bërë ndryshime dhe me lejen tuaj unë do të sugjeroja disa prej tyre.

Së pari, në preambulë duhet të theksohet referenca edhe te rezolutat e mëparshme, ajo e 10 marsit 2011, e 10 majit 2012 e të tjera. Është një praktikë parlamentare, për një çështje një rezolutë i referohet edhe rezolutave tjera.

Dy, mendoj se ka një diskrepancë, një kolizion midis titullit dhe përmbajtjes së rezolutës. Do të ishte mirë të saktësohet përndryshe bie pak si diçka që mbështillet në gazetë.

E treta, ajo që u theksua edhe nga kolegu Bajrami, te pika 3, do të duhej plotësuar insistimin në integritetin territorial, për mendimin tim do të ishte mirë të formulohet në vazhdim si dhe integritetin institucional e kushtetues për të hequr çdo keqkuptim.

Te pika 4, më del problematike mënyra si është kërkuar që Qeveria të jetë bartëse e procesit që natyrshëm është edhe s'ka nevojë të theksohet, por kjo pjesa tjetër me pjesëmarrje të komisioneve të nevojshme, jo vetëm që nuk shkon, por edhe s'mund të përzihet legjislativi me ekzekutivin duhet të qëndroj megjithatë secili në funksionet që ka, duke ruajtur pastaj instrumentin e mbikëqyrjes parlamentare, të kontrollit dhe në fund të ratifikimit siç është thënë të asaj që është e ratifikueshme në Kuvend, jo gjithçka është e tillë.

Prandaj, unë propozoj që të thuhet në vend të “pjesëmarrjes e tutje” të thuhet “në koordinim me institucionet tjera të Republikës së Kosovës” se s'janë vetëm Kuvendi, mund të ketë nevojë edhe për angazhim të segmenteve tjera.

Dhe pika pesë, po ashtu edhe unë mendoj se rezultati final s' ka asnjë kuptim, Kuvendi nuk miraton rezultate finale, aq më tepër pa e ditur çka është ai rezultat final, rezultati final mund të jetë hiq gjë edhe Kuvendi s'ratifikon hiq gjë, ose së paku s'do të duhej të ratifikon. Prandaj duhet të thuhet “marrëveshjet e dala nga ky proces” jo “do të ratifikon” sepse përsëri s'mund të prejudikohet a do të ratifikohet ose jo, po i nënshtrohen procesit e ratifikimit në Kuvendin e Kosovës, ratifikohen ato që janë të ratifikueshme ato që janë në përputhje me Kushtetutën dhe me vullnetin e atyre të cilët i përfaqësojnë.

Po ashtu mendoj se vërejtja që u tha këtu për procedurën duhet të merret parasysht. Për të mos improvizuar, ne jemi të obliguar që ose të votojmë për shmangien e procedurës dhe ajo duhet të ketë një bazë dhe nuk e ka sot, nuk besoj që janë as votat, ose duhet të respektohet procedura. Edhe mendoj që nuk ka gjë të keqe sot të prezantohet, siç u prezantua, të shqyrtohet siç u shqyrtua dhe të krijohet hapësira për harmonizim të qëndrimeve, gjë të cilën më së miri do të duhej ta bënte një komision. Për shembull, Komisioni për Legjislacion në legjislaturën e mëparshme, ka qenë edhe një autorizim që çështjet e rezolutave e të tjera, ky komision t'i harmonizojë. Në këtë mënyrë mund të plotësohen, të inkorporohen vërejtjet e duhura dhe të ndërtojmë një qëndrim që një tekst të konsoliduar, të korrigjuar, të plotësuar ta votojmë me konsensus, me shpresë se kjo vërtetë do t'i kontribuojë ati procesi të cilën gjithë e dëshirojmë dhe e dëshirojmë sinqerisht që të ketë marrëdhënie normale ndërmjet të gjitha vendeve në fqinjësi dhe që ai normalizim të jetë i drejtë e i qëndrueshëm. Uroj që edhe të ndodhë kështu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në fakt kjo rezolutë e propozuar po tentojnë ta bëjë diçka që realisht është e pamundshme. Pra, kërkon të bëjë normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë që e përsërisë realisht është shumë e pamundshme.

Kurrë shqiptarët dhe Serbia nuk kanë pasur raporte normale dhe as që kanë raporte normale mbi të cilën ne mund të kërkonim marrëdhënie normale.

Serbia me të vërtetë nuk është shtet normal dhe po ashtu nuk është sjellë kur normalisht ndaj nesh. Ne mund të sillemi normalisht me Serbinë dhe të kërkojmë raporte normale, marrëdhënie normale vetëm nëse i konsiderojmë normale të gjitha ato çfarë na ka bërë neve Serbia. Pra, s'mund të sillemi normalisht me një shtet që vërtet nuk është normal së paku karshi nesh.

Nëse i konsiderojmë këto normale, këto masakra që i ka bërë Serbia ndaj nesh, nëse këto janë normale, nëse i konsiderojmë të gjithë këtë fotografi normale, shiheni, është fotografi i familjes Jashari, shumë e freskët, akoma kjo shtëpi është kështu dhe me këtë shtëpi kështu kërkohet nga Serbia marrëdhënie normale apo normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, them prapë është e pamundshme.

150 vjet terror të Serbisë si pushtuese mbi shqiptarët, manifeston ky libër tjetër dhe sikur këto libra dhe botime tjera janë dhjetëra të mos them edhe qindra tjera, të cilat e manifestojnë se sa normale është Serbia ndaj shqiptarëve , në këtë rast ndaj Kosovës.

Në anën tjetër ne do të kërkonim këtu nëse kërkonim një rezolutë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, ne duhet ta dimë se po bëjmë një anshëm për shkak se Serbia nuk na do si miq. Serbia nuk sillet normalisht ndaj nesh, Serbia ka shpallur veten armike ndaj shqiptarëve dhe Kosovës dhe këta të fundit sikur të kërkojnë raporte normale ndaj një shteti që është armik, ne kërkojmë raporte normale, pra me armikun tonë.

Tek e fundit nuk jemi ne deputetët të cilët edhe nëse e votojmë këtë rezolutë mund të vendosim raporte normale me Serbinë. Tjetërkush vendos për këto raporte, tjetërkush do ta diktojë se çfarë raporte do të kenë shqiptarët me Serbinë e në radhë të parë këtë raport do ta krijojë vetëm shpirti i shqiptarëve të vuajtur nga Serbia.

Ne kemi thënë një herë, kemi thanë disa herë, madje edhe kemi pasur moton në vitet, sidomos në vitet '90-ta, se Kosova është gjak që nuk falet. Ata që mendojnë të kenë marrëdhënie normale me Serbinë, vërtet nuk janë normal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsedavajući,

Predstavni Vlade,

Uvaženi poslanici,

Poštovani građani,

Bošnjačka zajednica podržava predlog Vlade da se ubrza proces dijaloga između Prištine i Beograda, jer samo putem pregovora i usemnog uvažavanja sa obe strane može doći do stabilnosti, mira, slobodnog kretanja, slobode trgovanja, priznavanja dokumenata, dobro susednih odnosa u regionu i otvaranje puta prema Evropskoj Uniji.

Kao predstavnici naroda u obavezi smo da kao mlada država poštujemo demokratske principe utemeljena na zaštiti ljudskih i manjinskih prava da pratimo implementaciju Ustava Republike Kosovo, ali i da pokažemo svetu članicama Evropske Unije i našim prijateljima Amerikancima, da smo razumu društvo koje prihvata evropske standarde, da smo sposobni da gradimo mir, slobodu, ekonomski razvitak i progres svih nacionalnih zajednica koje zajedno vekovima žive na ovim prostorima.

I ne smemo da dozvolimo da dođemo u situaciji i u kojoj se trenutno nalazi Bosna i Hercegovina, nego da kod nas svih narodnih poslanika, koji se nalaze u ovoj Skupštinskoj Sali, nadvlada ljudski razum koji ide u korist svih građana naše države. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Besoj që shumë nga parafolësit jo vetëm sot, po vazhdimisht e kam thënë, si këtu në Parlament, si kudo që iu ka dhënë rasti edhe besoj që këtu s'ka asnjë dilemë që Kosova si shtet i pavarur, si subjekt juridik e politik në arenën ndërkombëtare, do të vazhdojë dhe do të sillet dhe do të jetë e përkushtuar të sillet e përgjegjshme për t'i realizuar objektivat, për të marrë përgjegjësi dhe për t'i ofruar kapacitete dhe mundësitë e saj për të ndihmuar në aspektin regjional dhe ndërkombëtar me mundësitë e kapacitetet që i ka.

Normalisht, Kosova si shtet duhet të vazhdojë e të komunikojë e të ketë marrëdhënie e t'i avancojë ato marrëdhënie në mënyrë të përhershme me të gjitha shtetet që e njohin Kosovën si shtet, me gjithë fqinjët e posaçërisht me fqinjët për shkak se kemi shumë gjëra që duhet të e do të kemi gjatë gjithë kohës në mënyrë të përhershme të bashkëbisedojmë me fqinjët tanë. Jo vetëm për temat dhe problemet e hapura të ndjeshme, por edhe për çështjet të cilat ndihmojnë në zhvillimin, forcimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe paqes në regjion për interesat normalisht të dy palëve.

Dhe në këtë kontekst, Kosova më shumë se me këndo tjetër ka nevojë për interesa të veta dhe në shërbim të paqes në regjion, të bisedojë edhe me Serbinë, për temat e hapura të cilat janë si trashëgimi e konfliktit dhe luftës mbrapa nesh, tema të dhimbshme të cilat duhet një ditë që të zgjidhen dhe të marrin përgjigjen e merituar. Dhimbje të madhe e dëm të madh, rrënim të madh, Serbia i ka bërë Kosovës, borxhe të mëdha ka të cilat duhet të zgjidhen dhe përfundimisht të mbyllet kapitulli i një konflikti historik që ka qenë mes serbëve dhe shqiptarëve.

Prandaj, në këtë çështje besoj që s'kemi folur vazhdimisht në këtë Parlament, ndoshta do të flasim deri sa ta përmbyllim këtë kapitull, që do të shkonte në shërbim edhe të qytetarëve të Kosovës edhe të qytetarëve të Serbisë edhe të vetë regjionit dhe përfundimisht edhe ky rajon të futet në procese të integritimit.

Ajo që besoj ne duhet të flasim ne këtu sot është për një temë kaq të rëndësishme të interesit shtetëror, përpjekja jonë nuk duhet të ndalet me kaq këtu ku jem sot. Përpjekja duhet të vazhdojë në ndërtimin e konsensusit të plotë, mundësisht të plotë ideale do të

ishte, të gjitha forcave politike për të ndërtuar një platformë, rezolutë, strategji e të gjitha këto me qëllim që të jemi të përgatitur për t'i ngritur krejt këto tema, çështje të cilat deputetët vazhdimisht, kush më shumë e kush më pak po i thekson.

U prezantua një rezolutë e përpiluar nga shumica e grupeve, një herë u tha që janë marrë vesh liderët politikë, përfaqësuesi i LDK-së unë s'e mora vesh a ka qenë a s'ka qenë, derisa foli zoti Hamiti, më duket u pa që nuk kanë qenë pjesëmarrës në këtë rezolutë dhe në qoftë se është kjo që tha zoti Hamiti, atëherë unë kërkoj që të vazhdohet, të mos lodhemi t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë që të gjithë jemi në diçka që ta miratojmë së bashku në interes të vendit. Të merren vërejtjet, sugjerimet e të gjitha grupeve politike, të tentohet sa më shumë, në pafundësi për ta ndërtuar një konsensus, siç thash sepse kemi të bëjmë me interesa nacionale.

Nuk mendoj që këtu kemi të bëjmë me një rezolutë e cila do 60 vota, po diçka që është më tepër se kaq është në interes të vendit që grupet politike të jenë në bord edhe të jenë pjesëmarrës aktiv në hartimin e kësaj rezolute. Unë mendoj që kemi kohë të mjaftueshme t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë dhe gatishmërinë e vullnetin që po shprehet këtu për të ndërtuar një dokument, rezolutë pastaj çka do që ta quajmë dhe të jetë sa më gjithëpërfshirëse votimi i saj.

Prandaj, i ftoj grupet parlamentar që t'i shfrytëzojnë këtë mundësi dhe këtë vullnet për ta ndërtuar një dokument me konsensus, është pyetje po them përsëri interesi nacional, nuk është çështje e politikave ditore që duhet një shumicë e thjeshtë.

Unë mund t'ju them që edhe ne, në Kryesinë e Partisë Demokratike të Kosovës, kemi pasur diskutime rreth kësaj çështje edhe kemi amendamente, po për shkak se jemi grupe këtu, shumë grupe kemi kërkuar që sot këtu edhe ato amendamente që ne planifikojmë dhe besojmë që duhet të shtohen, duhet të harmonizohen me grupe tjera, jo vetëm nga vullneti jonë, jo vetëm të dëgjohet vullneti i grupit politik, kështu ka qenë në bisedimet që i kemi pasur dhe besoj që një pjesë e asaj tha zoti Bajrami, e tha zoti Bajrami e prandaj e paraqiti si amendamente të cilat i mbështes dhe po besoj me një konsultim me grupet parlamentare do të gjejnë vend.

Të nderuar kolegë,

Unë i ftoj që t'i kthej Rezolutës të vitit 2011 të 10 marsit, asnjë dallim nuk ka, asnjë dallim nuk ka kjo rezolutë nga 2011, bile ajo e vitit 2011 është goxha më e fuqishme. Po e marrë vetëm shembull, po e lexoj nenin 1 të rezolutës që është paraqit sot dhe nenin 1 të rezolutës që është paraqitur në vitin 2011. Po nisem me atë 2011-ës: "Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovraane të Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për dy shtete dhe për rajonin". Kjo është e 2011-ës.

Rezoluta e sotit, përsëri neni 1, bile edhe me nen është njëjtë: "Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet procesin për normalizimin me marrëdhënie mes dy shteteve të pavarura dhe sovraane të Kosovës dhe Serbisë, në interes të zgjidhjes së problemit në mes

të dy shteteve, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për dy shtetet dhe për rajonin” asnjë dallim.

Neni 2: “Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon, po flas për rezolutën 2011, parimi që dialogu ndërmjet dy palëve duhet të lehtësohet nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.

Neni 2 i rezolutës së sotme thotë: “Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon parimin që ky proces ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të lehtësohet nga BE-ja dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.

Neni 3, neni 4 i Rezolutës 2011, thotë: “Agjenda e dialogut duhet të përfshijë vetëm çështje teknike në interes të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm të Republikës së Kosovës”, kjo e thotë më 2011.

Ndërsa, kjo e sotmja, neni 3, thotë kështu: “Dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues”. Cila është urgjenca? Nëse na duhet një rezolutë, atëherë thirrëmi, Qeveria e ka rezolutën e vitit 2011, le të veprojë sipas rezolutës së kaluar, bile ka hala më shumë hapësirë aty, veç atje janë 9 nene, këtu janë 6 nene, domethënë ka më shumë mundësi për të filluar këtë proces.

Kjo tregon që nuk kemi urgjencë, urgjenca jonë në këtë vend të nderuar kolegë është të dakordohemi për çështjet nacionale në këtë vend, urgjenca jonë është të kemi strategji dhe platformë të qartë. Urgjenca jonë është të dalim atje dhe të sillemi serioz dhe të pjekur dhe të arrijmë objektivat të cilat i kemi. E unë besoj që këtu ka mundësi.

Po në qoftë se duam ta bëjmë një rezolutë të re, atëherë të ulemi e të bëjmë amendamente të reja. Dhe një nga ato që i thashë, siç tha edhe profesor Bajrami, të kërkohej implementimi i plotë i atyre marrëveshjeve, konkluzioneve, dikush i thotë marrëveshje, dikush konkluzione, merrni si doni si do që ta quani ashtu siç ka thënë Qeveria. Qeveria ka thënë - nuk ka dialog pa implementimin e marrëveshjeve të arritura, dhe e dyta, normalizim të marrëdhënieve.

Normalizimi, këtu ka profesorë të gjuhës, e dinë më mirë, normalizimi vjen përmes një procesit të dialogimit, marrëveshjeve që qojnë drejtë normalizimit. Dhe a mund të flasim për normalizim në qoftë se ne vazhdojmë që institucionet shtetërore serbe, të qëndrojnë në një pjesë të territorit të Kosovës, shtetërore dhe në tërë Kosovën, institucionet paralele. Ne duhet të kërkojmë që për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë duhet të fillohet të kërkohej nga Bashkimi Evropian, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga miqtë tanë që të ndihmojnë dhe t'i kërkojnë qartë Serbisë, largimin e institucioneve shtetërore paralele nga Kosova si fillim i procesit të normalizimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Prandaj, mendoj që kemi shumë çka të bisedojmë dhe unë kërkoj nga grupet parlamentare që të bëhemi bashkë edhe të sjellim një konsensus.

Po e mbylli fjalimit tim kështu, nganjëherë më mirë është të humbësh duke bërë punë të mira se sa të fitosh duke bërë punë të këqija. Këtë e ka thënë Toni Bleri, besoj që ne duhet të punojmë bashkë për të bërë punë të mira, edhe jo të këqyrim kush po fiton dhe kush po humb. Duhet të fitojë Kosovë, kjo është më e rëndësishme.

KRYESUESI: Faleminderit, janë edhe 5 diskutues, mendoj që grupet parlamentare, përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe ekspertë relevantë që u përmend dhe që kanë marrë pjesë në diskutim, do të ishte mirë që të takohen dhe të shohin a ka mundësi harmonizimi për ta votuar, nëse bën, nëse s'bën në rregull është, ne diskutojmë.

Vazhdojmë me diskutimet. Unë po i lus që të merren vesh nëse mund, nëse nuk mund ne e hedhim në votim, tjetër rrugë s' ka. Fjalën e ka zoti Ferati.

SADRI FERATI: I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Normalizimi i marrëdhënieve me Republikën e Serbisë, është plotësisht në pajtim me parimet e institucioneve të Republikës së Kosovës, që nga deklarimi i pavarësisë dhe tani.

Vërtet nuk do të jetë proces i lehtë dhe ne këtu po shprehim edhe dilemat tona dhe kemi plotësisht arsye. Mu nuk më bëhet të besoj se politikë bërja sot, pra liderët në Serbi do të mund të shkëputen plotësisht nga mentorët e tyre dhe nga mënyra e funksionimit deri më tani.

Por është e mundshme që të ketë reformime, të ketë ndryshime dhe kësaj duhet t'ia dhënë rastin dhe normalizimi i fqinjësisë dhe fqinjësia e mirë në raport me Serbinë, do të mund të kishte dobi edhe në aspektin e avancimit të raporteve ndërkombëtare të Kosovës, por edhe sepse ajo do të mund ta lehtësojë dialogun mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, në komunat, pra në pjesën veriore të Mitrovicës dhe në komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok. Dhe pra, shpresat për një progres që mund të arrihet në këtë drejtim dhe unë do të konsideroja se progres do të ishte, zëvendësimi i strukturave ilegale me struktura legale, pastaj hedhjen pra zëvendësimin e kësaj anarkie dhe hiperkrimi me rendin dhe sundimin e ligjit atje, që të zëvendësohen barrikadat me vazhdimin e autostradës Prishtinë - Mitrovicë - Leposaviq, pse jo dhe këto gjithçka do të kishte mund në këtë drejtim të konsiderohet një progres. Dhe kjo zaten edhe është qëllimi pse jemi kaq të përkushtuar dhe pse ne angazhohemi që të ketë normalizim të marrëdhënieve.

Por, duke marrë parasysh se do të angazhohemi të gjithë për këtë, unë po besoj që ose është gabim pra një lëshim në shkrim tek pika 3, kur flet për dialogun dhe rezultatet që duhen të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial, pra nuk ka dilema dhe rregullimin e brendshëm, cilin rregull të brendshëm? Pse na ka ikur fjalia deri tash që e kemi përdorur - rregullimin unik, sepse ky është rregullimi kushtetues i Kosovës, pra rregullimi unik. Dhe këtë e them jo rastësisht, sepse përnjohësit e situatës në veri, po të pyes se cili është defekti më i madh që ndodhë atje, gjithë ato që ne i shohim ajo dhunë, ai krim atje, ato janë pasoja, por shkaktari

kryesor i gjithë asaj situate në ato komuna atje është pikërisht ambicia që ata e kanë, sepse janë udhëhequr deri tash nga një ambicie se Kosova është e mundur që të kthehet në kuadër të Serbisë, pastaj se atje është e mundur që të ndodhë ndarja dhe së fundi ka ambicie se atje mund - tentohet një sistem shumë specifik i veçantë e tjera e tjera që do të thotë komplet do ta rrezikonte funksionalizimin e Kosovës si institucione dhe si shoqëri.

Po këto në rend të parë duhet të eliminohen për hir të atyre qytetarëve atje, sepse përveç një pjese që qëndrojnë pra në pozitat profitabile të përfitimit nga krimi, pjesa tjetër që frikëson qytetarët, por është edhe një pjesë atje që funksionon mbi një patriotizëm, sepse nëse qëndrojmë kështu tensionojmë situatën, nuk integrohem, neve do të jepet një zgjidhje që ata e mendojnë se është më e mira, por që unë mendoj se do të kemi të bëjmë prapë me një situatë, as në qiell as në tokë, dhe qytetarët do të jenë peng të atyre ambicieve. Prandaj, unë propozoj që të kthehet formulimi, sistemi unik i funksionimit.

Ne dëgjojmë tani së fundi edhe se ndoshta edhe ky mund të jetë pra muajt që na presin, mund të jenë muajt më të rëndësishëm dhe tejet të rëndësishëm dhe të volitshëm që të fillohet edhe komunikimi, dialogu edhe relaksimi i raporteve me Serbinë, por edhe dialogu i brendshëm me qytetarët në pjesën veriore.

Por, unë mendoj se edhe thënia në Serbi se nëse na kushtëzohet në kuptimin që Bashkimi Evropian apo Kosova, ne do ta zgjedhim pra Kosovës, unë mendoj se edhe aty Serbia ka obligime dhe unë mendoj se ka mundësi të formimit të urave të komunikimit. Deri tash kemi pasur njëkahëshe, pra ka komunikuar vetëm Serbia me qytetarët e komunitetit serb, në rend të parë, por edhe me të tjerët. Por, unë mendoj që një formulim që mirëqenia, pozita dhe të drejtat e komunitetit serbë në Kosovë dhe komuniteti shqiptar në Serbi mund të jenë ura të vazhdueshme të bashkëpunimit dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm. Do të kisha pasur dëshirë që ky formulim të futet edhe këtu.

Ndërsa, plotësisht pajtona që Qeveria është institucion kompetent që të vazhdojë pra, me gjithë angazhimet e saja dhe ne këtu nuk krijuam sot limite, ngase nuk patëm rastin që të dëgjojmë për një strategji apo platformë, por që u nënkuptua se gjatë hartimit të kësaj platforme të veprimit, mund të futen të gjitha çështjet që janë diskutuar këtu në Parlament, edhe çështja e të pagjeturve, por edhe aspektet tjera të cilat mund të shtrohen. Ajo çka unë nuk e pëlqej është dialogu hap pas hapë deri në njohje të Kosovës dhe eventualisht thirrjet në kompromise të vazhdueshme. Unë prapë e kam thënë dhe po them i përngjan asaj të shkurtojme diçka që veç e kemi prerë shkurt.

Prandaj, jemi për dialog, jemi për fqinjësi të mirë, jemi për dialog të brendshëm dhe krijimin e institucioneve legale, për sundim të ligji, jemi për vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe angazhimet që qytetarët e komunitetit serbë këtu të jetojnë po aq mirë, sikurse edhe shqiptarët e komunitetit shqiptar në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe jemi që të avancohet pozita ndërkombëtare e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Zoti kryesues i Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Fillimisht desha të shpreh një pakënaqësi lidhur me procedurën, isha ndër të parët që kërkoja fjalën dhe jam ndër të fundit që mu dha fjala dhe përveç kësaj u ftuan shefat e grupeve parlamentare, që të harmonizohen qëndrimet ende pa përfunduar fjalën gjithë deputetë, që do të thotë është mundësia potenciale që ndonjë propozim të mbetet jashtë këtij procesi.

Duke pasur parasysh peshën e madhe të këtij problemi, siç e dini ne si Lëvizje për Bashkim, kemi insistuar vazhdimisht që për këtë çështje të organizohet një tryezë pune midis të gjitha subjekteve politike.

Gjithmonë kemi konsideruar që një dokument i një peshe të tillë çfarë është ky do të duhej të dilte si rezultat i një debati të gjatë dhe përmbajtjesor për një kohë bukur më të gjatë para se të vijë në seancën e Kuvendit të Kosovës.

Është një dokument që jep kahe një procesi shumë të rëndësishëm, madje do ta vlerësoja ndër proceset më të rëndësishme prej shpalljes së pavarësisë.

Megjithatë kjo nuk ndodh, edhe sot e kemi para vetes këtë dokument që kemi.

Në përgjithësi konsideroj se teksti i kësaj rezolute është i mangët, është abstrakt dhe mjaftë implicit. Për më tepër e ngatërron në masë të madhe shkakun me pasojën.

Duke qenë se misioni i tij është shumë i rëndësishëm, përmbajtja e tij konsideroj që nuk arrin ta përmbushë këtë mision. Është thjeshtë sikur një çek bllanko që kërkohet të nënshkruhet nga Kuvendi e pastaj Qeveria të vendosë shumën e vetë aty. Ky do të ishte një luks i madh konsideroj për Kuvendin të cilin nuk mund t'ia lejojmë vetes.

Prandaj, për ta bërë këtë rezolutë më të pranueshme, është i domosdoshëm ndryshimi dhe plotësimi së paku në dy momente.

Në qendër të kësaj rezolute është vendosur qëllimi për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve, në vend se qëllimi të ishte zgjidhja e problemeve ndërmjet tyre. Ky është ai çeku blanko për të cilin po flas, sepse normalizimi i marrëdhënieve nuk nënkupton domosdo zgjidhjen e drejtë të problemeve që është edhe interesi ynë kryesor.

Ndërsa, në anën tjetër zgjidhja e problemeve domosdo vetvetiu prodhon normalitetin midis dy vendeve.

Sipas kësaj rezolute ky normalizim mund të vijë si rezultat i zgjidhjeve me të cilat eventualisht do të pajtohej delegacioni i Kosovës e që mund të jenë të dëmshme për vendin, kur normalizim është në fakt qëllim e jo pasojë, atëherë pasojat e tij janë shumë të rënda.

Në bazë të kësaj që thashë është e domosdoshëm ndryshimi i formulimit të pjesës së parë të rezolutës sipas formulimit aktual procesi fillohet së prapthi pra, synohet normalizimi i marrëdhënieve në interes të zgjidhjes së problemeve, ndërkohë që pikërisht moszgjidhja e problemeve i mban këto marrëdhëniet e tilla çfarë janë, pra jo normale dhe të tensionuara.

Prandaj, propozimi është për këtë pikë kësajsoj. Rezolutë - titulli të hiqet menjëherë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës. Dhe, pika e parë në vend se të thuhet se mbështetë procesin për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane dhe më tutje të zëvendësohet me: “Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet procesin e zgjidhjes së problemeve midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, në interes të normalizimit të marrëdhënieve në mes tyre, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin”.

Gjithashtu, për të mos mbetur një çek blanko, kësaj rezolute duhet t’i shtohet edhe një pikë tjetër, e cila veç u tha këtu nga shumë kolegë se Qeveria e Republikës së Kosovës obligohet që në konsultim me partitë politike të hartojë një platformë për bisedime, e cila pastaj do të miratohej nga Kuvendi i Kosovës.

Ne mendojmë se kjo platformë do të duhej të mbështetej në katër shtylla.

Shtylla e parë, bisedimet duhet të jenë politike dhe ato duhet të zhvillohen në mes të dy shteteve.

Dy, pavarësia e Kosovës është e panegociueshme.

Tre, bisedimet duhet të zhvillohen për çështje të pazgjidhura në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe zgjidhjet duhet të bëhen mbi bazën e reciprocitetit. Të gjitha të drejtat që do të mund të përfitonin tri komunat veriore të Kosovës: Leposaviq, Zveçan e Zubin-Potok, duhet t’i gëzojnë edhe tri komunat e Kosovës Lindore: Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.

Dhe pika e katërt, pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës dhe fshatrat shqiptare përreth, nuk mund të jenë temë e bisedimeve, aty është kryer spastrimi etnik i shqiptarëve dhe ata duhet të kthehen në pronat e veta.

Krejt çka dua të nxjerr pas gjithë kësaj që thashë është: rreziku Kosovës sot nuk i vjen nga bisedimet, i vjen nga mungesa e një platforme, nga mungesa e përgatitjes së palës sonë me këto bisedime. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht dua vetëm ta bëj të qartë atë që deri tash u përmend disa herë në disa instanca, për atë se nëse po e shkelim apo jo Rregulloren e Kuvendit dhe rregullat e Kuvendit në trajtimin e kësaj rezolute.

Ne e kemi thënë edhe në mbledhjen e Kryesisë të së hënës që kjo rezolutë ose mënyra se si është proceduar ajo dhe ngutja e asaj e pa arsyetueshme është shkelje e procedurave dhe e Rregullores.

E përmendi edhe kryetari i Kuvendit, pak a shumë debatin që u zhvillua në Kryesi, atë ditë, ku është e vërtetë që kryetari i Kuvendit ua ka tërhequr vërejtjen shëfave të grupeve po edhe nënkryetarëve të Kuvendit, që ishin të pranishëm se miratimi i një rendit të ditës me këtë rezolutë për kaq shpejtë pra për të enjten, është shkelje e procedurave. Pra, këtu i kemi pasur dy momente të Rregullores së Kuvendit, të cilat asnjëra prej tyre nuk u shfrytëzuan, as nuk u paraqit rezoluta si çështje urgjente dhe në këtë kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, pra sponsoruesi i kësaj rezolute, dështoi ta trajtojë këtë si çështje urgjente në dy momente edhe në Kryesi kur tha se është disi urgjente, po edhe këtu kur prapë e përdori të njëjtën fjalë “është disi urgjente”, çka është kjo disi urgjencë, si është ajo disi urgjencë, si mund të jetë një çështje edhe urgjente po edhe jo urgjente?

Dhe çështja tjetër është që as Qeveria, për të cilën po bëhet kjo rezolutë, deri tash të paktën, nuk e morri fjalën për ta treguar se pse është kjo rezolutë urgjente, pse duhet domosdoshmërisht të miratohet sot pse nuk ka mund ta pres javën e ardhshme? Pra, nuk kemi urgjencë dhe nuk e kemi kërkuar, pra sponsoruesi nuk e kërkoi, madje as votimin për t’u shmangur nga Rregullorja siç është praktikë në raste konkrete ose në raste të veçanta të bëjë.

Pra, ne e konsiderojmë si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” vendosjen e kësaj rezolute edhe votimin e saj sot në Kuvend, si shkelje të procedurës dhe shkelje të Rregullores së Kuvendit.

Tash do ta vazhdoj me një çështje e cila u përmend këtu nga disa deputetë dhe e cila mendoj se duhet të trajtohet edhe kronologjikisht, jo pse nuk dihen ato që do t’i them unë, po pse po mendoj që nganjëherë po harrohen qëllimisht ato që do t’i them unë.

Pra, do ta bëjë një kronologji të krimeve të strukturave paralele ilegale të Serbisë, që i kanë krye në Kosovë prej vitit 1999 e tutje. Natyrisht, që kaq shumë ka krime të tyre, sa nuk do të mund t’i përmbledh të gjitha në fjalimin tim dhe natyrisht që ka kaq shumë ka krime Serbia ndaj Kosovës sa asnjëherë në këtë Kuvend nuk po mund t’i përmbledhim të gjitha. Pra sa herë po diskutojmë për këtë çështje, po duhet t’i përmendim edhe disa të reja dhe kjo nënkupton që Serbia dhe strukturat e saj pas luftës, kanë bërë shumë krime ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Më 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, 11 shqiptarë janë vrarë, me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar ose lënduar, ndërsa 1 564 familje me gjithsej 11 mijë e 364 anëtarë janë dëbuar nga pjesa veriore e Mitrovicës.

Sipas Halit Baranit, i cili ka qenë dhe mbase ende është udhëheqës i Zyrës së Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Mitrovicë, bandave kriminale të 4 shkurtit të vitit 2000, të cilët i kanë vrarë këta shqiptarë, sipas dëshmitarëve edhe viktimave të dhunuara në atë rast, i kanë prirë Oliver Ivanoviqi dhe Dragan Delibashiqi,

pra dihen me emra e mbiemra, dihen edhe kush janë ata, dihen edhe ku janë ata. Mirëpo, prej vitit 2000 asnjëherë sistemi gjyqësor i Kosovës nuk ka ndërmarrë as hapin më të vogël për ta trajtuar këtë dyshim të bazuar të ngritur për vrasjen e shqiptarëve në pjesën veriore. Madje-madje, Oliver Ivanoviqi ka shërbyer edhe në këtë Kuvend si nënkryetar Kuvendi dhe pastaj ka shërbyer në Qeverinë e Serbisë si sekretar i shtetit për Kosovë.

Po ashtu, në vitin 2004, strukturat paralele të Serbisë i patën vrarë tre fëmijë të fshati Çabër, të cilët të ndjekur nga strukturat paralele, patën përfunduar në lum, ku patën humbur jetë.

Kjo pastaj u pasua me ngjarjet e marsit, në të cilat dua ta them 19 shqiptarë e kanë humbur jetën drejtpërsëdrejti nga strukturat paralele të Serbisë, qoftë në pjesën veriore të Kosovës, qoftë edhe nëpër komuna tjera apo vende tjera me shumicë serbe në Kosovë.

Që prej shpalljes së pavarësisë, strukturat paralele të Serbisë i kanë kryer disa krime tjera ndaj shtetit të Kosovës dhe ndaj qytetarëve, por edhe zyrtarëve të Kosovës, ku unë do t'i përmend vetëm disa.

Më 24 korrik të vitit 2011, është vrarë polici Enver Zymberi, me snajper, në një betejë për të cilën çuditërisht Qeveria e Kosovës s'parapëlqen të flet shumë dhe kjo vrasje edhe sot e asaj dite nuk është zbardhur, as dorasi, por as mënyra se si është vrarë ky polic i Kosovës, i cili ishte në detyrë i dërguar nga kjo Qeveri në pjesën veriore për ta ushtruar sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës.

Më 8 prill të vitit 2012, pas mesnatës është vrarë Selver Haradinaj, të cilit i është montuar në banesën e tij, në pjesën veriore të Mitrovicës, një bombë- eksploziv me çrrastë ky ka humbur jetën dhe familjarët e tij janë lënduar dhe prej atëherë janë zhvendosur në pjesën tjetër të Kosovës.

KRYESUESI: Visar, t'u kisha lutur të flisni për rendin e ditës.

VISAR YMERI: Më 19 shkurt të vitit 2008, pra dy ditë pas shpalljes së pavarësisë, strukturat ilegale të Serbisë i kanë djegur pikat doganore 1 dhe 31, në pjesën veriore.

Më 14 mars po ashtu të vitit 2008, pra diku më pak se një muaj pas, këto struktura kanë hyrë me dhunë dhe kanë uzurpuar ndërtesën e Gjykatës në veri të Mitrovicës.

Më 17 mars të vitit 2008, këto struktura e kanë vrarë një polic ukrainas, i cili shërbente nën uniformën e Policisë së UNMIK-ut, atje.

Më 11 maj të vitit 2008, këto struktura i kanë organizuar në mënyrë të kundërligjshme zgjedhjet e Serbisë brenda territorit të Kosovës.

Më 14 dhjetor të vitit 2008, këto struktura e kanë uzurpuar tërësisht linjën hekurudhore në Zveçan, të cilën e përdorin edhe sot e asaj dite për të hyrë trenat nga Serbia.

Më 22 dhjetor të vitit 2008, këto struktura kanë inauguruar dhe e kanë vu në funksion zyrën edhe shërbimet e Postës dhe Telekomit të Serbisë në Graçanicë, pra shumë afër kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës.

Në vitin 2008, në korrik më saktësisht, këto struktura ishin angazhuar për ta penguar ndërtimin e ujësjellësit për fshatin Suhodoll, i cili ishte i domosdoshëm për ta garantuar një jetë të mirëqenies për qytetarët shqiptarë të këtij fshati.

Pastaj në vitin 2008, po ashtu disa herë nuk lejuan fillimin e renovimit dhe rindërtimit të shtëpisë së Ali Kadriut, madje-madje me këtë rast duke u angazhuar edhe me armë zjarri dhe duke shtënë në drejtim të personave që merreshin me këtë renovim.

Ka edhe shumë data dhe krime tjera që janë kryer nga këto struktura paralele dhe tash jemi duke jetuar një situatë në pjesën veriore të Kosovës, ku prej korrikut dhe gushtit të vitit 2011 e tutje, këto struktura vazhdojnë të mbajnë barrikada dhe vazhdojnë ta mbajnë të okupuar dhunshëm atë pjesë të territorit të Kosovës, ku nuk lejohet të hyjë asnjë këmbë, madje asnjë simbol çfarëdo qoftë ai i shtetit të Kosovës, duke vepruar kështu në kundërshtim të drejtpërdrejtë me secilin ligj dhe Kushtetutën e Kosovës.

Në mars të vitin 2009, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka paraqitur publikisht një tekst -padije me të cilën kemi kërkuar që të gjithë qytetarët që janë të interesuar, përfshirë këtu edhe politikanët, pra edhe deputetët, edhe zyrtarët qeveritarë, por edhe zyrtarët e institucione tjera publike, që ta paraqesin nëpër prokuroritë e Kosovës, ku kërkohet që të merren hetime dhe të ndërmerren masa ligjore ndaj atyre që publikisht ishin paraqitur si struktura paralele të Serbisë, që vepronin në Kosovë, kryesisht politike, të cilët ishin ose kryetarë, ose nënkryetarë të komunave të zgjedhur nga zgjedhjet e Serbisë, apo kryetarë ose nënkryetarë të kuvendeve komunale të gjitha komunave në Kosovë.

Pra, e përmenda këtë padi për ta treguar një çështje, e cila është shumë e rëndësishme. Deri sot dhe sot në këtë Kuvend u dëgjua se si normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, për të cilin po e diskutojmë sot dhe një rezolutë për të cilin na është paraqitur sot në Kuvend për ta votuar, do të nënkuptonte edhe zhbërje të strukturave ilegale të Serbisë. Po kështu u tha nga disa deputetë edhe pse zyrtarisht në tekstin e rezolutës nuk përmendet fare.

Kjo i sjell në pah dy çështje që janë shumë të rëndësishme, e para se ky normalizim, pra ky proces negociator paska të bëjë edhe me veriun e Kosovës, përkundër asaj që po na thua që s’ka të bëjë fare me të, që nuk do të diskutohet fare për të, mirëpo këtu u pranua nga sponzorizuesit e kësaj rezolute, në fakt ka të bëjë edhe me të, dhe natyrisht po dëgjoj për çdo ditë nga zyrtarët, të cilët thirren këtu të jenë lehtësues të këtij dialogu.

Dhe, çështja tjetër që e vë në pah kjo është se me normalizim të marrëdhënieve disi Qeveria e Kosovës po kërkon t’i jepet mundësi t’i normalizojë marrëdhëniet edhe me strukturat paralele, për shkak se për to dhe me to do të flitet. Pra, a do të nënkuptojë ky normalizim i marrëdhënieve me Serbinë normalizim të pozicionit të strukturave ilegale në Serbi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë.

VISAR YMERI: Çka nënkupton ky normalizim në rastin konkret, pra a do të nënkuptojë që këto krime do t'u falen, a do të nënkuptojë që ata do të legalizohen dhe kështu do të legalizohen edhe krimet e tyre të kryera në të kaluarën, apo çka do të nënkuptojë ky normalizim?

Dhe, një çështje për fund që dua ta ngre është që ka të bëjë me rezolutën. Pra, i përmendi deputeti Fatmir Limaj, ngjashmëritë ndërmjet rezolutës së vitit 2011 dhe vitit 2012. Dhe, tash po na thua që kjo rezolutë garanton që Qeveria e Kosovës të mos dalë nga vijat e kuqe, ndërkohë që me rezolutën e vitit 2011, që e ka të njëjtin tekst me këtë që po kërkohet ta votojmë sot, e kemi parë se çfarë devijimesh marramendëse ka bërë Qeveria e Kosovës. Aty thuhet që secila marrëveshje duhet ta respektojë Kushtetutën dhe sovranitetin e Kosovës, ndërkohë që asnjë marrëveshje nuk e respekton atë. Asnjë që është arritur në atë proces negociator të quajtur teknik, nuk është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Pra, paramendojeni që në një dialog teknik këta kanë ikur aq shumë nga Kushtetuta. Çfarë do të bëjnë me një dialog politik që po kërkohet sot këtu? Do ta djegin fare këtë kushtetutë...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Është e qartë se rrethanat që janë krijuar në përgjithësi në proceset që zhvillohen në Kosovë e Serbi dhe insistimi i faktorëve ndërkombëtarë po shpie në vazhdimin e dialogut apo bisedimeve midis Kosovës dhe Serbisë në një nivel më të lartë ku tash do të kemi çështje të ashtuquajtura politike, ndonëse edhe ato teknike u pa se kanë pasur, siç e kemi theksuar gjithmonë kanë pasur edhe karakterin e thellë politik.

Unë mendoj se dobia nga debati i sotëm do të nxirrej vetëm nëse këtë e marrim si hyrje në përgatitjen e Kosovës për këto bisedime të cilat na presin më tutje.

Mendoj se sot jemi krejtësisht të papërgatitur që të aprovojmë çfarëdo rezolute.

Së pari, po shihet që nuk po zbatohet procedura, nuk zbatohet Rregullorja, e kjo duhet të qartësohet. Si mund ta aprovojmë në një dokument me rëndësi aq vitale, pa e respektuar procedurën elementare të diskutimit dhe të Rregullores së Kuvendit? Prandaj, këtë unë do të doja që këtë debat vetëm ta kuptojmë si një hyrje, nga i cili do t'i nxirnim përfundimet për ta krijuar një platformë dhe një kornizë.

Ne duhet ta kemi të qartë: unë kam dëgjuar se Qeveria e ka një platformë, apo një program për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Besoj që dikush do ta marrë në

fund fjalën nga Qeveria dhe është mirë të na sqarohet se a ekziston ai program, a ekziston ajo platformë? Unë e kam parë këtë, e kam lexuar në media. Nëse ekziston ai program apo platformë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, është mirë që ai program apo platformë të prezantohet në Kuvend, e Kuvendi t'ia japë dritën e jeshiltë dhe me një rezolutë që i cakton ato shtylla kryesore ta kornizojë sjelljen e Qeverisë, ta marrë Qeveria pra lejen nëse aprovohet ai program apo ajo platformë. Përndryshe, kjo rezolutë është krejtësisht gjenerale, e paqartë dhe mendoj se nuk do t'i kontribuojë planifikimit dhe menaxhimit të mirë të këtyre rezolutave dhe çdo udhëheqje e improvizuar e këtyre bisedimeve nuk mund të jetë e dobishme, as për procesin në Kosovë, as për rregullimin e marrëdhënieve me Serbinë, as për stabilitetin në rajon.

Në këtë drejtim, mendoj se çështja e normalizimit të marrëdhënieve është diçka që ne duhet ta synojmë, por nuk është reale. Po shohim çfarë ngarkesash kemi. Çka është reale? Reale është që ne të fillojmë me Serbinë si dy shtete t'i diskutojmë çështjet që e pengojnë jetën, t'i zgjidhim dhe eventualisht e gjithë kjo të na shpijë te normalizimi, i cili, mendoj, pra gjithçka mund të ndodhë, por është një perspektivë jo aq e afërt, do të thosha jo edhe afatmesme.

Në këtë drejtim, pra unë propozoj që sot Qeveria, nëse ka platformë apo program, ta sjellë në Kuvend. Dy, që rezoluta e Kuvendit lidhur me atë platformë të nxirret nga diskutimi i sotëm. Në këtë drejtim, unë mendoj se mund të krijohet komision i posaçëm, por mund të udhëhiqet edhe nga komisionet përkatëse të Kuvendit.

Më lejoni tash t'i cek edhe disa çështje, që duhet të jenë ose në platformë, ose në Rezolutën e Kuvendit. Pas pikës 3, konsideroj se në platformën e Qeverisë duhet të theksohet se dialogu për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve duhet t'i adresojë çështjet kyçe, që i pengojnë këto marrëdhënie ndërmjet tyre dhe të rezultojë me zgjidhje, që promovojnë bashkëpunim dhe marrëdhënie fqinjësore dhe të paqes në rajon, e veçanërisht:

- a) hulumtimin, ndriçimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe kthimin e të pagjeturve;
- b) mospërzierjen në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe evitimin e strukturave paralele, sigurimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe evitimin e gjithë asaj që e pengon tregtinë e lirë, lëvizjen e lirë e tjera.
- c) shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave që janë pezull, që kanë të bëjnë me dëmet e luftës në pasurinë private dhe publike, zgjidhjen e problemeve me kursimet devizore, pensionet e papaguara dhe dëmet në sistemin e pensioneve, dëmet në sistemin buxhetor, kompensimin e pagave për punëtorët e përjashtuar nga puna me masat dhe ligjet diskriminuese, kthimin e artefakteve dhe muzeve, kthimin e dokumenteve të marra nga Banka Qendrore e Kosovës, apo Popullore e Kosovës.

Në dialog duhet të sigurohet respektimi i të drejtave të minoriteteve, pra dialogu duhet të rezultojë me respektimin e të drejtave të minoriteteve në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Serbisë, sipas standardeve mbi pakicat kombëtare ndërkombëtare, mbi parimet e reciprocitetit.

Pra, këto janë çështje të cilat janë shumë të rëndësishme. Unë kisha kërkuar që sot mos të vihet në votim asnjë rezolutë, që ky debat të merret për bazë që të ndërtohet një platformë, një program dhe një rezolutë, e cila do të siguronte konsensusin. Po i tërheq vërejtjen Qeverisë edhe atyre që e kanë propozuar këtë rezolutë, se çdo kalim i kësaj rezolute me 50 vota, me 45 vota, me 46 vota, do të jetë i dëmshëm për proceset në Kosovë dhe ne duhet të veprojmë në drejtim të stabilizimit, jo të destabilizimit të situatës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Në mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme të datës 27 prill të këtij viti, në pyetjen time drejtuar ministrit Hoxhaj, se a e njeh Republika e Kosovës, Republikën e Serbisë, ai u përgjigj drejt dhe ashtu siç duhet, tha: Jo, nuk e njeh.

Mirëpo, kjo rezolutë po e njeh Republikën e Serbisë, sepse ashtu i referohet në tekstin e saj. Ju e dini shumë mirë, që edhe kur kemi qenë nën okupim e kemi pasur referendumin për pavarësi dhe e kemi pasur Republikën e shpallur, kemi thënë e ashtuquajtura Jugosllavi dhe e ashtuquajtura Republika e Serbisë. Ndërkaq, tash këtu pranohet Republika e Serbisë, gjë që nuk është njësoj sikur të thuhet Serbi, sepse Serbia është vend e kur thuhet Republika e Serbisë, kjo i bie që po flet për një shtet, që po e pranon si Republikë me kushtetutën e saj, me ligjet e saj, me udhëheqjen e saj e kështu me radhë.

Pra, mendoj që në vendimet, në qëndrimet e institucioneve të Republikës së Kosovës, nuk do të duhej që kështu të përdoret shprehja Republika e Serbisë, sepse ashtu qysh ka thënë edhe Ministria e Punëve të Jashtme, përkatësisht ministri i saj, ne nuk e njohim Republikën e Serbisë.

Në këtë tekst të kësaj rezolute, qysh në fillim thuhet: “Duke respektuar dhe kujtuar gjithmonë të kaluarën e hidhur dhe luftën e përgjakshme të popullit tonë për liri e pavarësi”. Ky respekt mungon në dokumentin më të lartë juridik të Kosovës dhe shprehet këtu para dialogut me Serbinë e për këtë dialog.

Askund në preambulën e Kushtetutës së Kosovës nuk përmendet lufta çlirimtare dhe humbjet e vuajtjet nga e kaluara. Nga propozuesi i kësaj rezolute dëgjuam se nuk i frikësohet dialogut me Serbinë. Dhe, unë i besoj për këtë gjë. Pra, nuk i frikësohet dialogut me Serbinë, sepse nuk po e çan kokën për shtetin e Kosovës. Ky dialog është rrezik për shtetin e Kosovës, këta s’bregosen për shtetin e Kosovës, andaj edhe nuk i frikësohen dialogut.

Por, këta i frikësohen vetëm humbjes së pushtetit të tyre, prandaj po e lusin Serbinë për dialog. Kjo Qeveri pa dialogun me Serbinë, është si peshku pa ujë në arenën ndërkombëtare.

Dialogu politik me Serbinë për veriun e Kosovës, po quhet “normalizim i marrëdhënieve me Serbinë”. Kaq! Procesi i dialogut është zëvendësuar me një fjalë tjetër “procesin e

normalizimit”. Dialogu politik Kosovë-Serbi shërben si trampolinë për negociatat Serbi-Bashkim Evropian. Nga dialogu teknik me Kosovën, Serbia e Tadiqit e fitoi statusin e vendit kandidat për BE. Nëpërmjet dialogut politik me Kosovën, Serbia e Nikoliqit tash do të mund t’i fillojë negociatat me BE-në për t’u bërë anëtare e saj.

Përfundimisht, normalizimi i marrëdhënieve Kosovë-Serbi, do të përkthehet në normalizim të marrëdhënieve Serbi-Bashkim Evropian, me Kosovën gjithnjë e më anormale. Nga normalizimi i marrëdhënieve me një shtet anormal si puna e Serbisë mundesh veçse të abnormalizohesh edhe më tej. Nga dialogu me Serbinë për veriun do të abnormalizohemi në drejtim të Bosnjës e nuk do të normalizohemi në drejtim të Sllovenisë a Kroacisë.

Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë nënkupton që Serbia është normale dhe se vetëm marrëdhëniet e saj me Kosovën nuk janë normale, prandaj na nevojitet një normalizim i këtyre marrëdhënieve. Për çfarë dialogu po flasim me Serbinë, kur të gjithë e dimë se ne me Serbinë nuk pajtohemi as për faktet e lëre më për opinionet. Në çfarëdo procesi dialogues duhet të ballafaqohen opinionet, ndërkohë që me Serbinë ne nuk pajtohemi as për faktet. Dhe, kjo nuk ka të bëjë veç me këtë Qeveri, me secilën Qeveri që e kemi përjetuar në jetën tonë dhe në jetën e paraardhësve tanë.

Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është normalizim i marrëdhënieve me kriminelët, përderisa ata mbeten kriminelë, në kuptimin që as nuk po pendohen për krimin dhe as nuk po e ndalin krimin sot e kësaj dite.

Me këtë rezolutë kërkesat e xhelatit po i bën viktima. Këso rezolute do të duhej të miratonte Kuvendi i Serbisë, jo Kosova. Të gjithë e dimë se xhelati ka interes dhe kërkesë që të pajtohet me viktimën, jo anasjelltas. Asnjëherë viktima nuk bën kërkesë për tu pajtuar me xhelatin. Por, në Kosovë po ndodh e kundërta, flitet për marrëveshje e pajtim historik, tash edhe për dialog e për normalizim të marrëdhënieve, ku kjo Qeveri në emër të viktimës bën kërkesa të llojit të xhelatit.

E gjithë kjo është brenda një kuadri, brenda një mendësie le të them, të fetishizimit të dialogut, ku kjo nënkupton se ose nuk kemi dialoguar mjaft me Milosheviqin, ose këta në pushtet në Beograd janë të ndryshëm prej tij. Vështirë të përcaktohesh se cila është më e gabueshme, se sa tjetra. Dialogu me Milosheviqin ishte më pak se i kotë, meqë ishte kundër produktiv, kurse këta pushtetarët e sotëm në Serbi janë pasardhës të linjës nazifashiste në Serbi.

E dini që Gjermania i ka vënë kushte Serbisë. Kjo Qeveri asnjë kusht nuk ia vë Serbisë, madje deputeti Bajrami tha se as zbatimin e marrëveshjeve të deritanishme nuk po e vëmë si kushtëzim, por veçse e përmendi.

Tri nga shtatë kushtet e Bundestagut Gjerman për Serbinë janë posaçërisht të rëndësishme. Kushti i dytë, ndriçimi i sulmit kundër Ambasadës Gjermane në Beograd në shkurt të vitit 2008, atëherë kur Gjermania e njohu pavarësinë e Kosovës, priten hapa

konkretë në sqarimin dhe ndjekjet penale. Pra, Gjermania as nuk i harron, as nuk ia fal, për dallim prej Qeverisë sonë.

Kushti i tretë, edhe pse Serbia vitet e fundit ka ndërmarrë hapa konkretë për tejkalimin e së kaluarës, është e nevojshme ende përparim. Një kthim prapa është deklarata, se në Srebrenicë nuk ka pasur gjenocid. Bundestagu pret sinjale të qarta për vazhdimin e pajtimit në rajon. Kemi pa fund deklarata të Daçiqit e të Nikoliqit, po ata tregojnë që janë veçse më zinj se Milosheviqi, ato, tërheqja e atyre deklaratave duhet të jetë parakusht.

Edhe kushti i pestë, si pritje e rëndësishme ka të bëjë me institucionet paralele serbe në veri të Kosovës, para nisjes së bisedimeve, pra para nisjes së bisedimeve, Bundestagu pret nisjen e shpërbërjes kontinuele të strukturave paralele në aparatit e sigurisë dhe të administratës si dhe financimin e tyre.

Pra, Bundestagu pret që të nisë shpërbërja e strukturave që të mund të nisin bisedimet, këtë gjë s'po e bën Qeveria jonë. Prandaj, a po kuptoni, këta po e mbajnë Kosovën në pazar, ku pazarin e kanë në nivel më të ulët se sa Bundestagu Gjerman.

Në vend të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, duhet të kemi kushtëzim të Serbisë. Madje, pikërisht ky kushtëzim do ta sjellë normalizimin e vërtetë. Duke e bërë Serbinë normale, pra duke e ndryshuar Serbinë, i hapim rrugë normalizimit të marrëdhënieve me të. Njëkohësisht, vetëm duke e kushtëzuar Serbinë, bëhemi sovranë karshi saj. Kushtëzimi është procesi i sovranizimit. Nëse kushtet ndaj Serbisë, kjo është më e rëndësishmja, nëse kushtet ndaj Serbisë shndërrohen në tema me Serbinë, kjo është mënyra më e sigurt qysh problemet jo vetëm që s'do të zgjidhen, por do të rriten e do të shtohen.

Kushtet ndaj Serbisë për çfarëdo komunikimi a bisedimesh me të, do të mund t'i grupojmë në pesë lloje.

Së pari, kushtet juridike. Serbia duhet ta ndryshojë kushtetutën e saj, ku thuhet që Kosova është pjesë e Serbisë dhe duhet ta pranojë Pavarësinë e Kosovës.

Së dyti, kushtet morale dhe humanitare. Serbia duhet t'i kërkojë falje Kosovës për krimet ndaja shqiptarëve përgjatë gjithë shekullit XX dhe të na i kthejë trupat e rreth 1 750 të pagjeturve, për të cilët nuk jep as informacione.

Së treti, kushtet politike, Serbia duhet ta pushojë shtypjen dhe shkeljen e të drejtave të shqiptarëve autoktonë në Luginë të Preshevës, përkatësisht në Kosovë Lindore dhe ta ndërpresë financimin e strukturave të saj ilegale në Kosovë.

Së katërti, kushtet e drejtësisë, Serbia duhet të na i dorëzojë kriminelët serbë të luftës dhe të mos lejojë që të shëtiten të lirë edhe më tej ata dhjetëra mijëra kriminelë serbë të luftërave të viteve të '90-ta, dhe së fundi,

Së pesti, kushtet e zhdëmtimit. Serbia duhet të na i paguajë dëmet e luftës dhe të okupimit, të na e kthejë fondin e plaçkitur pensional, depozitat bankare të qytetarëve të Kosovës, regjistrat civilë, librat kadastralë dhe artefaktet kulturore.

Le ta shohim se cilin prej këtyre kushteve Serbia është e gatshme ta plotësojë. Le ta provojmë! Qeveria e Kosovës le t'i shkruajë këto kushte, le t'i dërgojë në Bruksel, në Nju-Jork, në Uashington, le t'ia bëjë publike Serbisë, le ta shohim çka po thotë Serbia. Pse të mos e provojmë këtë gjë?

Faktorët ndërkombëtarë nuk ia vënë këto kushte Serbisë, nëse këtë gjë nuk e bën së pari vetë Kosova. E këtë gjë kurrë nuk do ta bëjë kjo Qeveri, për bindjen time edhe ky kryeministër, sepse mu këta i ndërsyen deputetët e PDK-së për ta votuar kundërmocionin kundër reciprocitetit me Serbinë, më 20 janar të këtij viti. Normalizimi i vërtetë është pikërisht ai nëpërmjet reciprocitetit.

Pa e kushtëzuar Serbinë dhe pa reciprocitet ndaj saj, normalizimi i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, do të jetë marrje e territorit të Kosovës dhe dhënie e kontrollit Serbisë, marrje e funksionimit të shtetit të Kosovës dhe dhënie e integritetit të përsheptuar të Serbisë në Bashkimin Evropian. Dhe, merreni me mend, e gjithë kjo po ndodh kur Serbia po udhëhiqet nga koalicioni i ish zëvendësit të Sheshelit dhe ish-zëdhënësit të Milosheviqit.

Prandaj, ju ftoj që të mos e votoni këtë rezolutë, e cila paraqet tradhti ndaj Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur zoti Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Do doja edhe një herë të përkujtoj se në diskutimin tim unë insistova që rezoluta të amendamentohet mes tjerash edhe me kërkesën për implementimin e marrëveshjeve të deritanishme.

Ne mund të vëmë me dhjetëra kushte në rezolutë, mund të vëmë me dhjetëra kushte, mirëpo interes yni, interes i Kosovës është që të ndërrojë gjendja në pjesën ku nuk shtrihet sovraniteti dhe fuqia e Kushtetutës së Kosovës. Ne nuk duhet ta pranojmë pozitën që Serbia të luajë me procesin, sepse në qoftë se presim derisa Serbia t'i plotësojë kushtet, se duhet t' i vendosë në strategji dhe në platformën politike, atëherë Serbia do ta mbajë pezull gjendjen në veri edhe për vite të tëra.

Kosova nuk duhet të pajtohet me atë gjendje jo kushtetuese dhe joligjore, gjendje e agresionit kushtetues dhe ne nuk duhet të shantazhohemi nga Serbia me faktin që Serbia nuk do t'i plotësojë kushtet që kërkohen dhe janë legjitime, por ne duhet të bëjmë më tepër, të hyjmë në proces dhe të vendosim agjendën nacionale të përparësive të dialogut, sepse vazhdimi i status quo-s dhe lojës me Serbinë, ne e dimë lojën e Serbisë me të pagjeturit. Çështja e të pagjeturve nga Serbia nuk trajtohet më si çështje humanitare, por si çështje politike dhe ne nëse vazhdojmë t'i pranojmë këto lojëra të Serbisë, atëherë ne

do të pajtohemi me status quo-n në veri dhe çdo ditë apo çdo javë e humbur e status quo-s në veri, nuk është në interes nacional të Kosovës.

Është mirë që procesi po evoluon nga procesi teknik në proces politik dhe është mirë që përmes kësaj rezolute ne do të kemi një afat të caktuar deri kur veriu dhe problemet tjera, që janë pjesë e destruksionit serb, do të vendosen në suaza kushtetuese dhe në suaza të interesave shtetërore dhe nacionale të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë, zoti Kurti.

ALBIN KURTI: I nderuar i zoti Bajrami, bisedimet i provuam prej 8 marsit të vitit të kaluar. Ajo, çka s'kemi provuar janë kushtet, pra, bisedimet i provuam dhe ja e ke rezultatin. Serbia e ka marrë statusin e vendit kandidat, ndërkaq ne pas katër vjetëve e gjysmë që e kemi shpallur Pavarësinë edhe më tutje zvarritemi pa sovranitet dhe pa zhvillim ekonomik.

Natyrisht, që duhet të veprojmë, jo vetëm në veri po në çdo pëllëmbë të territorit të Kosovës, për ta shtrirë sovranitetin dhe për ta garantuar integritetin territorial. Për këtë gjë, Lëvizja "Vetëvendosje" e ka një program me 13 pika, por Qeveria nuk ka vullnet, përveçse nuk ka program sepse ka interes për këtë gjendje.

Dhe, së fundi, kushtet në politikë nuk bën të shndërrohen në tema. Kjo është mënyrë se si vulolet josovraniteti. Procesi i sovranizimit është nëpërmjet kushtëzimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsjedavajući!

Poštovani gospodo poslanici,

Meni je stvarno žao što danas, kada govorimo o dijalogu, pomirenju i pronalaženju načina kako bi smo mogli da idemo kao zemlja napred, da se ne bavimo predrasudama. Sada čujem od nekih poslanika da su protiv pregovora i mira, i govore o srpskim zločinima posle 1999. godine.

Molim vas, toliki cinizam i insinucija je teško podneti, a ne reči da takva retorika i govori nemaju nikakvu zaleđinu i nikakvu težinu, jer istina je sasvim drugačija. To je da se posle 1999. godine dogodilo upravo zločin prema srpskom narodu. Neću da govorim o datumima kada se šta dogodilo loše za srpski narod, jer za to bi bilo potrebno mnogo više vremena. Zato molim poslanike da se ne bave izmišljotinama, nego da se više govori o dijalogu i pomirenju, i budu toliko iskreni i kažu istinu o svim zločinima koji su se dogodili, ma ko da ih je počinio.

Moram da vas podsetim da su i ostale zajednice, koje danas žive na Kosovu, deo kosovkog društva, one moraju da budu tretirane isto. Samo normalizacijom odnosa sa

Srbijom možemo ići napred, i tako slediti evropski put, koji je jedini cilj i Kosova, i Srbije.

Moram još naglasiti da nismo dobili ispravljen tekst Rezolucije na srpskom, te zato vas molim da se to ispravi. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, për replikë.

VISAR YMERI: Faleminderit kryesues!

Sapo e dëgjova deputetin, i cili iu referua fjalës sime, pa ma përmendur emrin dhe tha ndër të tjera, që atë që i thashë unë, pra për krimet e pas '99-ës, të kryera drejtpërsëdrejti nga strukturat ilegale kriminale, na qenkan, sipas tij, cinizëm dhe insinuata.

Prapë po ia përsëris unë deputetit, edhe të tjerëve...

(Ndërhyn kryesuesi për çështjen e përkthimit në gjuhën serbe.)

Pra, edhe një herë, po i përmend me emra. Më 4 shkurt të vitit 2000, Nderim Ajeti, 13-vjeçar, Nerimane Xhaka 42-vjeçare, Remzije Canhasi 56-vjeçare, Selime Berisha 60-vjeçare, Nezir Voca 61-vjeçar, Shqipe Voca 54-vjeçare, Bashkim Rukeci 38-vjeçar, Nimon Sejdiu 52-vjeçar, Sebiha Abrashi 50-vjeçare dhe Muharrem Sokoli, 51-vjeçar. Këta janë vrarë nga struktura ilegale të Serbisë, të udhëhequra nga Oliver Ivanoviqi dhe Dragan Delibashiqi. Kjo nuk është as cinizëm as insinuatë, është fakt për të cilin sistemi i gjyqësisë kurrë nuk është marrë.

Prapë po e përsëris Enver Zymberi, të gjithë e dimë që është vrarë në korrik të vitit 2011 nga këto struktura me snajper, në një betejë ku policia e Kosovës i luftonte këto struktura kriminale, të vendosura aty nga Serbia.

Prapë më 8 prill, në vitin 2012 sulmi terrorist ndaj Selver Haradinajt nuk është cinizëm, as nuk është insinuatë, por është sulm terrorist me qëllime politike. Çfarë kemi parë të ndodhë në pjesën veriore të Kosovës prej vitit 1999 e tutje, është spastrim etnik, i cili është realizuar atje nga strukturat e Serbisë dhe i cili fatkeqësisht po ka vullnet të pranohet edhe nga institucionet e Kosovës.

Dhe, po ua them prapë, të gjithë deputetëve këtu, pavarësisht se prej cilës përkatësi kombëtare vijnë, mos e barazoni veten me strukturat ilegale të Serbisë. Unë nuk po them që këto krime janë kryer nga serbët, por po them nga Serbia si shtet me strukturat e veta të organizuara dhe financuara në Kosovë, të cilat janë si të policisë, si të gjyqësisë, si politike po ashtu, edhe të shërbimeve tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryetar!

Nuk desha ta marr fjalën, por sikur disa diskutime më shtyn ta marr fjalën dhe të jap kontribut në këtë diskutim.

Unë mendoj që kjo rezolutë, absolutisht nuk është tradhti ndaj vendit dhe kisha dashur që zotin Kurti ta këshilloja, që të mos i diskualifikojë njerëzit që votojnë këtë rezolutë se janë tradhtarë, sepse kjo lojë e tillë është vërtetë e nivelit tepër të ultë.

Unë i garantoj zotit Kurti se do ta votoj këtë rezolutë dhe nuk jam hiç tradhtar. Në këtë aspekt unë mendoj që është një shenjë e vullnetit të mirë për normalizim të marrëdhënieve. Unë e di që ka pika ngarkese mes të Kosovës dhe Serbisë, e di që çështja e të pagjeturve, për të cilën kemi nxjerrë një rezolutë, të cilën e kam votuar unë. E di që e kemi çështjen e veriut, është një çështje shumë e ndjeshme, por dialogu është mënyrë e civilizuar dhe mënyrë evropiane e zgjidhjes së problemeve.

Në këtë aspekt unë mendoj që kjo qasje e tillë që kemi sot në Kosovë, do të mbretërojë një qasje e tillë edhe në Serbi, sepse ka tone të themi optimiste, pa marrë parasysh deklarimeve publike se nuk do ta njohim kurrë Kosovën, do të vijmë në gjendje që do ta njohin dhe atë shumë mirë.

Ju kisha lutur të gjithëve, që të mos përdorin fjalor diskualifikues, por të punojmë të gjithë në atë aspekt që objektivisht është në interes të Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Replikë, zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Mendoj që nuk duhet të jetojmë me këtë ndjenjë e inferioritetit, se jemi të pacivilizuar dhe duke dialoguar do ta dëshmojmë që jemi të civilizuar. Është krejtësisht gabim.

Nuk kanë bërë popujt e civilizuar më pak luftëra se sa popujt e pacivilizuar dhe as nuk kanë dialoguar më shumë se sa ata të pacivilizuarit. Dialogu nuk është kurrfarë garancie e të qenit i civilizuar. Pse nuk negociojnë, pse nuk dialogojnë vendet e Bashkimit Evropian me Iranin? A nuk do të duhej të ishin të civilizuar që të dialogojnë me Iranin? Pra, ky argument nuk qëndron.

E dyta, po e përsëris edhe një herë, për shkak se njihet Republika e Serbisë, për shkak se Serbisë nuk i vihen kushte, për shkak se bëjmë kërkesa të llojit të xhelatit, kjo lloj rezolute kështu e shkruar, paraqet tradhti ndaj Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Zoti Asllanaj, kundër-replikë.

SALI ASLLANAJ: Unë prapë qëndroj prapa atyre fjalëve, që liria e mendimit politik dhe platforma politike e secilit subjekt politik, është e tillë dhe në bazë, në themel të gjitha dokumenteve të partisë së cilës unë i takoj, është pikërisht dialogu si zgjidhje e problemeve.

Në këtë aspekt unë mendoj, që nuk ka të drejtë zoti Kurti të ma diktojë mënyrën e votimit tim. Tjetër gjë është, nëse nuk kemi besim në njerëzit që e udhëheqin dialogun. Unë mendoj që dialogu mund të udhëhiqet edhe me pesë mijë vjet, por një presje të mos

ndryshohet. Unë kisha dashur të krijojmë një ekip negociues të tillë, i cili do të negocionte sa të ketë nevojë, por kurrë çka është në dëm të Kosovës, të mos lëshojë pe, në asnjë çështje. Kjo është qasja, të cilën e mendoj unë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Se rezoluta e PDK-së është e paligjshme e dëshmon fakti se në maj të këtij viti, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi rezolutën e mbështetur nga të gjitha grupet parlamentare, ku kushtëzohet çfarëdo dialogu me Serbinë, pa u zbardhur fati i 1800 personave të rrëmbyer e ende të pagjetur.

Pra, një herë të vetme Kuvendi u doli përkrah familjarëve të pagjeturve, ndërsa tani po del me një rezolutë e cila po shkelë mbi të pagjeturit. Kjo rezolutë është tradhti për familjarët e të pagjeturve, si dhe shkelje e interesave të qytetarëve të Kosovës.

Qeveria jo legjitime, me vota të vjedhura, vendos të falë krimet e Serbisë. Në emër të kujt po flet kjo Qeveri? Nëse disa individë të shantazhuar vendosin të falin gjakun e të vrarëve, populli nuk mendon në këtë mënyrë. A janë pyetur për këtë gjë familjarët e atyre 2 mijë dëshmorëve ndonjëherë? A janë pyetur ndonjëherë familjarët e 1 800 personave ende të pagjetur? A janë pyetur familjarët e 12 000 të vrarëve? A janë pyetur ndonjëherë më se 20 mijë persona, të cilët i kanë mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit, se çfarë mendojnë ata për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, pa u dënuar ajo për krimet e bëra ndaj tyre?

Këto statistika janë vetëm të periudhës së luftës në vitet '98-'99, duke mos i përfshirë edhe krimet e bëra para kësaj periudhe, siç janë: vrasjet maltretimet, persekutimet, helmimet e nxënësve nëpër shkolla e kthimi në arkivol i shumë të rinjve shqiptarë, të cilët ishin të detyruar të kryenin shërbimin ushtarak. Këto, pra statistika të cekura vetëm gjatë periudhës '98-'99, duke mos i përmendur edhe ato të pasluftës. Dhe, prapë ju doni normalizim!

Sipas rezolutës suaj i bie që ne jemi ata të cilët kemi qenë agresori dhe Serbia viktimë, që ne i paskemi rrëmbyer dhe zhdukur rreth 5000 persona, tashmë edhe 1800 të pagjetur. I bie që ne i paskemi vrarë 12 000 njerëz, që ne i dogjëm rreth 140 mijë shtëpi e dëbuam rreth 1 milion shqiptarë nga trojet e tyre dhe tani duhet të kujdesemi për të ndërtuar një të ardhme në paqe e harmoni me fqinjët tanë.

Me këto lojëra politike ju jo vetëm që po e degradoni Kuvendin e Republikës së Kosovës, por ju po e injoroni dhe po e fyei popullin e Kosovës, familjarët e të pagjeturve, familjet e dëshmorëve duke kërkuar normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, pa kërkuar ajo falje për viktimat e luftës, pa i paguar dëmet e luftës, pa e zbuluar fatin e të pagjeturve, pa e ndalur dhunën dhe burgosjen e qytetarëve shqiptarë edhe sot, madje pa e ndërruar edhe Kushtetutën, ku Kosova konsiderohet pjesë e Serbisë dhe pa e njohur Pavarësinë e Kosovës.

Dhe, pasi t'i ketë bërë të gjitha këto, Serbia do duhej të ishte ajo që do ta bënte këtë rezolutë dhe jo ta luste Kosova për një gjë të tillë. Mirëpo, edhe kjo ndodh kur vendi drejtohet nga njerëz të papërgjegjshëm e pa dinjitet njerëzor.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu e keni fjalën.

LIBURN ALIU: Sot këtu po flasim për një rezolutë, që shpie në negociata për të ashtuquajturin normalizim të marrëdhënieve me Serbinë.

Vetë fjala normalizim nënkupton përafrim, duke ndodhur ndryshimet nga të dyja anët, pra nënkupton lëvizjen nga të dyja anët. Dhe, para se të hyjmë në këtë çështje do të doja ta trajtoj çështjen e fytyrës së shtetit serb karshi Kosovës, karshi shqiptarëve para këtij normalizimi të marrëdhënieve, pra njëloj historiku të marrëdhënieve në përgjithësi.

Do të duhej të trajtohet se si erdhi dhe prej nga erdhi prishja e marrëdhënieve. Të bëhet e qartë, se dikur këtu jetuan këtu normalisht bashkë dhe madje luftuan edhe bashkë kundër pushtuesit edhe të dy popujt. Dhe madje, në bazën e vet themelimit të shtetit serb, në kryengritjen në Serbi ishin luftëtarët shqiptarë. Kur filloi prishja të themi e këtij normaliteti, që ishte atëherë, ishte pikërisht themelimi i këtij shteti serb dhe momenti ishte i kthesës, kur që nga ai moment marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe serbëve, respektivisht marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe shtetit serb filluan të degradojnë.

Që prej themelimit të këtij shteti, ajo që nuk ka pushuar asnjëherë janë programet shtetërore kombëtare serbe në raport me shqiptarët. Dhe, kjo është ajo e cila ia krijon fytyrën këtij shteti edhe sot.

Të gjitha këto programe kanë pasur dhe kanë të bëjnë me shfarosjen e shqiptarëve dhe të gjitha ishin programe gjenocidale. Të gjitha e shohin zgjerimin territorial, e shihnin edhe atëherë, në territoret, ndër të tjera, të banuara me shumicë shqiptare. Fillojnë natyrisht, me programin e Naçertanies, të Ilija Garashaninit në gjysmën e shekullit XIX dhe pastaj vazhdojnë me projektin e parë të Vasa Çubriloviqit në lidhje me dëbimin e shqiptarëve. Është Konventa jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve, është projekti i Ivo Andriqit për ndarjen e Shqipërisë dhe në këtë kohë, pra në periudhën në mes dy luftërave ushtria dhe xhandarmëria serbe në territoret e banuara me shqiptarë kishte program të veçantë.

Projekti i Ivan Vukotiqit për aneksimin e Shqipërisë, pastaj projekti i Stefan Moleviqit, i quajtur Serbia homogjene. Dhe, në kohën e Luftës së Dytë Botërore, pra kur Serbia ishte e pushtuar nga Gjermania naziste, lëvizja çetnike e asaj kohe kishte hartuar prapë një projekt të ngjashëm nga Drazho Mihajloviqi. Pas Luftës së Dytë Botërore në të ashtuquajturën Jugosllavi Socialiste, vazhdoi projekti i dytë i Vasa Çubriloviqit, i quajtur problemi i pakicave në Jugosllavinë e re, pastaj projekti i Dobrica Qosiqit i quajtur "Kritika e konceptit sundues në politikën nacionale", të vitit 1968 dhe në fund dhe pastaj erdhi edhe memorandum i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, i vitit 1986. Dhe, tash së fundi e patëm edhe konceptin e ri, apo propozimin e Dobrica Qosiqit, për ndarjen e Kosovës, në vitin 2004.

Pra, në një analizë të thjeshtë, Serbia në cilëndo kohë dhe në cilindo pushtet pati qëndrim krejtësisht të njëjtë në raport me shqiptarët, si në kohën e mbretërve, si në kohën e pushtimit nazist, si në socializëm, si në kohën e Millosheviqit, si të Koshtunicës, si të Tadiqit, edhe sot.

Ma gjeni, ju lutem, një ndryshim.

Pra, kjo politikë vazhdon edhe sot. Edhe sot kemi po të njëjtën Serbi me politikë shtetërore antishqiptare. Serbia është sjell dhe sillet si shtet armik ndaj shqiptarëve, ndaj lirisë së tyre. Atë që bënte e që nuk arrin ta bëjë sot në Kosovë ndaj shqiptarëve, sepse nuk e ka ushtrinë dhe policinë këtu, e bën ndaj shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

E unë do të doja të pyesja, se a nuk do të duhej së pari ca ndryshime në Serbi para se të normalizoheshin marrëdhëniet, a nuk do të duhej të ndodhte kjo lëvizje drejt normalizimit nga ana e Serbisë? A keni parë deri më tani një lëvizje në drejtim të përmirësimit të ashtuquajtur të marrëdhënieve, përpos ashpërsimit? Duhet ta kemi të qartë se me Serbinë e njëjtë të atyre projekteve të sipërpërmendura e të sapopërmendura nuk mund në fakt, të ketë normalizim. Mund të ketë vetëm koncesione ndaj saj, sepse ne kemi zgjedhur që ne të ndryshojmë për hir të normalizimit me Serbinë e njëjtë. Në vend se të flasim tani për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, në njëqindvjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe në njëqindvjetorin e ndarjes në mes shqiptarëve, ne flasim për të ashtuquajturin normalizim, duke iu afruar ne Serbisë.

Normalizimi nuk ndodh duke iu afruar Serbisë dhe ky normalizim nuk është asgjë tjetër, përpos koncesione të reja për Serbinë, sepse nuk ka si të ndodhë ndryshe. Unë do të doja ta dija qartë atë insistimin ndërkombëtar, se mbi çka bazohet? Në çka bazohet insistimi ndërkombëtar në të ashtuquajturat normalizim të marrëdhënieve, ku kërkohet vetëm nga ne t'i afrohem dhe t'i përafrohemi Serbisë? Normalizimi në fakt nuk mund të ndodhë, pa denacifikimin e Serbisë, sepse ato programe që u përmendën do të përsëriten prapë.

KRYESUESI: Faleminderit! Por, para se ta marrë fjalën, kryeministri Hashim Thaçi, i kisha lutur kryetarët e grupeve parlamentare që ta harmonizojnë tekstin, nëse kanë mundësi.

E ka fjalën kryeministri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryesues, zoti Haliti!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar shefa të grupeve parlamentare,

Deputetë, përfaqësues të gjithë spektrit politik kosovar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Fillimisht, më lejoni t'ju falënderoj të gjithëve për debatet që u zhvilluan sot në Parlamentin e Kosovës, për mesazhet që u dërguan, për qëndrimet e prezantuara, për diskutimet e hapura, por dhe më lejoni që në fillim të jem shumë i qartë, duke respektuar të gjithë zërat që u dëgjuan, se personalisht e besoj sikur ju të gjithë, nuk kam ndonjë etje apo që jam i entuziazmuar të ulem në tavolinë me Serbinë.

E kaluara shekullore, plagët e freskëta, gjaku i derdhur, lufta që kemi bërë pashmangshëm, nxit edhe emocione, jam shumë i vetëdijshëm, nxit edhe tek unë edhe tek familja ime, sikur te të gjithë ju dhe të gjitha familjet shqiptare, të gjitha familjet kosovare.

Unë vetë kam parë me sytë e mi dhe i kam përjetuar plagët e qytetarëve të mi. Shumë shokë më kanë vdekur në duart e mia në beteja, në istikame, në ballafaqime, në luftë për çlirim. Por, sot këtu, trembëdhjetë vjet pas luftës, nuk jemi këtu për të evokuar të kaluarën, po për të marrë zotime për të ardhmen. Nuk jemi këtu për të luajtur me emocionet njerëzve, të qytetarëve, por për t'u sjellë në mënyrë burrshtetase, për t'u sjellë në mënyrë racionale dhe për të punuar me përgjegjësi për të ardhmen.

U dëgjua këtu, Serbia duhet të kërkojë falje. Unë them, edhe nëse kërkon Serbia falje për vrasjet në Kosovë, ai kërkim-falje mua nuk m'i shëron plagët dhe as qytetarëve të Kosovës. Ajo është e paharrueshme, është e pashlyeshme, ajo do të përjetohet, ajo do të ketë reflektime, do të kujtohet njëherë e përgjithmonë dhe s'ka kërkimfalje që e shlyen gjenocidin e Serbisë në Kosovë.

Prandaj, të nderuar deputetë, unë ju ftoj që të punojmë bashkërisht, siç kemi punuar deri tani, siç kemi punuar në të kaluarën. Unë kam qenë në opozitë kur ka filluar procesi i presidentit Ahtisari, kam pasur vështirësi, por edhe dilema shumë të mëdha për t'u kyçur në proces. Pas kyçjes, jemi sjellë në mënyrë shumë të përgjegjshme, madje edhe pse kam qenë i dyti i votuar në vend, kam pas vendin diku i treti a i katërti a i pesti nganjëherë, por interesat e shtetit kanë qenë parësore, se sa kush ku ulet.

Në të njëjtën kohë kam luajtur rolin tim aktiv opozitar, por ndaj vendit ndaj statusit politik, ndaj atij procesi dhe së ardhmes jemi sjellë përgjegjshëm. Këtu i kemi shumë njerëz që kanë qenë në grupet punuese nga Partia Demokratike e Kosovës, në komisione të përbashkëta me qeverinë aktuale. Janë edhe të tjerët sot, dihet, disa janë në opozitë, disa janë në pushtet.

Dhe, të jeni të sigurt, se pikërisht fitorja qëndron në atë unitet që kemi treguar në atë kohë. Ka pasur natyrisht edhe kundërshtarë edhe atëherë, të atij procesi që thoshin se Kosova kurrë s'ka për t'u bërë e pavarur, po që ja është e pavarur dhe e njohur ndërkombëtarisht.

Të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës, sot Kosova është e lirë, e pavarur dhe sovranë. Por, pavarësia nuk është e vetëmjaftueshme, ne duhet të integrohemi në NATO dhe Bashkim Evropian e normalizimi dhe fqinjësia e mirë është kusht për integrim në NATO dhe Bashkim Evropian, për secilin shtet, jo vetëm për shtetin e Kosovës. Partnerët tanë, që na ndihmuan për liri, pavarësi, tash në konsolidim dhe fuqizim të shtetit dhe në përmbyllje të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, e mbështesin fuqishëm këtë proces të normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Të nderuar deputetë, askush nga ne nuk ka të drejtë të krijojë apo pretendojë të krijojë amulli apo mjegull. Nuk rrezikohet Kosova dhe e ardhmja jonë në këtë proces. Ora e historisë nuk kthehet kurrë mbrapa. Kosova është e pavarur sovranë dhe pikë, njëherë e përgjithmonë. Çdokush që hap dilema, i ka të pajustificueshme, të paqëndrueshme. Dhe, Kosova sovranë nuk është dilemë, është realitet, është subjektivitet ndërkombëtar, është vullneti i qytetarëve të Kosovës, është edhe vullneti dhe mbështetja e botës demokratike.

Prandaj, ju ftoj të gjithëve që të ecim me hapin tjetër bashkërisht, atë integruar. Dhe, Kosova, të nderuar deputetë, me respektin më të lartë, ju them, është shembull i bashkëpunimit për integrim mes spektrit politik dhe etnik në rajon. Dhe, i falënderoj të gjitha grupet politike, pozitive dhe opozitive për këtë bashkëpunim, që është shembulli më i mirë edhe për Brukselin dhe kemi marrë notë dhe vlerësim të lartë nga Brukseli. Dhe, jo rastësisht, të nderuar deputetë, menjëherë pas përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë dhe atij vlerësimit të lartë ndërkombëtar, doli edhe raporti i Progresit, që për herë të parë Komisioni Evropian e përmend integritetin territorial të Kosovës.

Dhe, keni parë reagimin e Beogradit. E përmende Nikoliqin këtu edhe Daçiqin. Tash emrat e lidershit në Serbi nuk i përcaktoj as unë as qytetarët e Kosovës, po vullneti i qytetarëve të Serbisë. As s'e kemi zgjedhur ne Milosheviqin, as Tadiqin, as Nikoliqin, as Daçiqin, sikur që nuk i kanë zgjedhur as ata liderët tanë. Nuk besoj, që as atyre u pëlqejnë fort liderët tanë.

Prandaj, ju ftoj që të punojmë bashkërisht në këto përkushtime tona kushtetuese dhe ligjore. U përmend këtu dhe nuk dëshiroj të përmend emra, por të sqaroj, duke mos polemizuar me askënd, ne të gjithë që jemi këtu kemi dhënë nga një kontribut të vogël, dikush më herët dikush më vonë, për liri dhe pavarësi. Shoh njerëz këtu, të viteve menjëherë të pasluftës, e kanë filluar rezistencën me format e veta, deri te ne, gjenerata tjetër, që kemi ardhur, kemi kulmuar bashkërisht me rezistencën qytetare dhe politike e të armatosur për largimin e Serbisë nga Kosova.

U përmend këtu se kryeministri është takuar me baroneshën Eshton, gjithashtu edhe me sekretaren e shtetit Klinton. Po, është e vërtetë dhe kjo është diçka e njohur botërisht edhe në javët e fundit. Unë respektoj Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, respektoj përfaqësimin e Qeverisë së Kosovës. Jam takuar në shtator me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së zotin Ban Ki Mun, me sekretaren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonjën Klinton edhe më herët, baroneshën Eshton, me presidentët Baroso dhe Ron Poj, me ministrin e jashtëm apo sekretarin William Heigh të Britanisë së Madhe, me ministrin e jashtëm Wester Welle në Nju-Jork, me kryeministrin italian Monti, me një mbështetje të fuqishme të presidentit francez Holand, në vizitë në Suedi me pritje nga kryeministri i Suedisë dhe ministri Eshton Bill. Dhe, pas këtyre vizitave e keni parë edhe ndryshimin në qëndrim të këtij dhe disa gjëra tjera. Gjithashtu edhe me ministrin e jashtëm çek Schvarcenberg, kryeministrin Jansha të Sllovenisë, u përmend këtu, kryeministrin kroat Millanović, gjithashtu takime të rregullta edhe me kryeministrin Berisha. Jam takuar me përfaqësues të rreth 60 vendeve në Nju-Jork, gjatë punimeve të asamblesë së përgjithshme.

Por, në të njëjtën kohë jemi takuar edhe me mbretin e Spanjës, Huan Karlos, ministrin e jashtëm të Sllovakisë, gjithashtu për herë të parë edhe me ministrin e jashtëm të Qipros. Të gjithë këta që i përmenda që janë miq dhe mbështetës të Kosovës, e mbështetin dhe e kërkojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Dhe, nëse unë apo dikush tjetër mendon se ne vendosim në këtë rrjedhë globale për Kosovën dhe rajonin, në selitë e partive tona, mendoj se nuk është qasje e drejtë.

Çështja e integritetit të Kosovës në NATO dhe Bashkim Evropian, është një angazhim gjithë ndërkombëtar. Normalizimi i marrëdhënieve mes shtetit të Kosovës dhe Serbisë e ndihmon edhe njohjen nga këto pesë vende të Bashkimit Evropian, që ende nuk e kanë njohur Pavarësinë e Kosovës. Po ritheksoj edhe njëherë, se kurrë në asnjë rrethanë, askush dhe nuk do të ndodhë, që të ngre çështjen e statusit special apo autonomisë për dikë në Kosovë. Kosova është një, unike e pandarë me integritet territorial të njohur dhe të pranuar ndërkombëtarisht. Prandaj, unë ju ftoj, të nderuar deputetë që të sillemi ashtu siç e kërkon përgjegjësia shtetërore, ndërsa unë dua të sqaroj edhe diçka, pa përmendur gjithashtu emra, po, është e vërtetë se konsulta për këtë rezolutë, tash edhe me plotësimin që ndodhi, që e mirëpresim, ka ndodhur mes spektrit politik të gjerë në Kosovë, prandaj ajo konsultë dhe ato ide të përbashkëta të prezantuara në draftin e parë të Rezolutës, mendoj se janë mesazhi më i mirë për gjithë spektrin politik kosovar, jo vetëm shqiptar, por edhe më gjerë, kështu që është e vërtetë “Vetëvendosja” s’ka qenë, prandaj mendoj që gjithçka ka qenë në mënyrë shumë të përgjegjshme, gjithçka ka qenë në mënyrë të respektuarit e Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, por në të njëjtën kohë edhe të krijimit të atmosferës dhe klimës së unitetit politik dhe qytetar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën për replikë.

SABRI HAMITI: Unë jo për formë, po për substancë, ndiej nevojë t’i sqaroj me kryeministrin dy çështje, që i shtroi, se kishin të bënin me ato që i thashë unë. Kjo është e qartë.

Po pra, zoti kryeministër, si njeri përfaqësues që jam këtu, përpiqem t’i përcjell të gjitha takimet tuaja dhe unë të përgëzoj dhe kam qejf që të kesh edhe më shumë takime.

Mirëpo, të kthehemi te substanca. Zonja Eshton, të kthehemi te problemi ne, ajo është një përfaqësuese e lartë politike për Politikë të Jashtme e Bashkimit Evropian dhe për Siguri, e cila flitet se do ta marrë kryesimin e këtyre bisedave. Pra, është ekstra kjo. Nuk është puna tash për të takohesh me Eshtonin sikur të takohesh me Sali Berishën, që thatë, se e sheh kur të duash. Në fund, qëllimi i bisedimit tim është substanca.

E dyta, prandaj e thashë dhe normalisht e thashë, po e përsëris, me një figurë të tillë politike dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, kur të takoheni ju, zoti Kryeministër i Kosovës, unë e thashë, tash s’po e përsëris figurën e parë, normalisht që do të bisedoni për problemet e Kosovës, por edhe për këto me Serbinë, që po vijnë. Kaq. Dhe, është mirë, thashë, që këto çështje të shtrohen në Kuvend, kur bisedojmë.

E dyta, unë me ty zoti Kryeministër, dhe po të mbaj për fjale, pajtohem plotësisht, zemra më bëhet mal, kur thua ti Kosova është e pavarur, sovranë dhe pikë. Kjo më rritë. Veçse, nëse është, duhet ta luajë këtë sovranitet. Unë këtë po kërkoj. Dhe, sot u përpoqa ta kërkoj në bankat e Kuvendit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: U krye replikë. Jo, jo, nuk të takon.

(Ndërhyrje)

Hajde vazhdo, vazhdo, po nuk është... Mirë de, ti e ke pasur fjalën më herët.

SABRI HAMITI: Pra, në këtë rast do të bëhemi, domethënë, seriozë, do të bëhemi sovranë, nëse vendosim për këto që i kemi në tavolinë në mënyrë sovranë, që i bie këto dokumente, zoti Kryeministër, dhe deputetë të nderuar, të provojmë t'i shkruajmë vetë për interesat tona. Le t'i shkruajë Qeveria, le t'i shkruajë në këtë rast Parlamenti, po mbushamendjet e tipit: "Na kanë thënë ndërkombëtarët", krejt në rregull është, po sovraniteti, sepse dinë këtu njerëzit të shkruajnë bukur politikisht shqip dhe në gjuhët tjera, edhe në atë anglishten, që u bë si dikur latinishtja - universale, kështu që po them, nuk është puna, ju liderët ndoshta e keni parë, ndoshta jeni pajtuar, veçse më lejo, zoti Kryeministër, dhe po e mbaroj. Ju liderëve fort s'jam duke ju besuar, se ju na keni sjellë një marrëveshje, treshi juaj, ju, Behgjet Pacolli dhe Isa Mustafa, një marrëveshje të rëndë politike për interes të Kosovës, që ka hyrë në Parlament dhe ju tash s'po pajtoheni për çka jeni marrë vesh. Pse unë tash të pajtohem apriori, 'bianko', për diçka që nuk e di. Ndoshta edhe ju rrini shpesh, është punë e juaj, por në këtë rast duhet të jemi konkretë. Prandaj, po them, unë edhe një herë ofrova, për gjëra të tilla kërkoj që Qeveria, kërkoj që Parlamenti të diskutojë ngadalë, të merret vesh. Mos i jepni zjarr, se nuk ka nevojë. Çdo gjë që mendohet më thellë është më e dobishme, prandaj ka mundësi, ka hapësirë që të bisedohet, të mos ngutemi dhe të bëjmë dokument Qeverie dhe dokument Parlamenti, që plotësohen dhe shihemi përgjegjës me njëri-tjetrin dhe e kryejmë me përgjegjësinë dhe fuqinë, që e kemi. Pajtohem me ju që s'jemi ekspertë të dynjasë, veçse nëse jemi sovranë, në pikat ku mund ta ushtrojmë - ta ushtrojmë sovranitetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën për replikë.

ALBIN KURTI: Ne thamë që Serbia të na kërkojë falje, jo ne t'ia falim Serbisë. Fakti që Serbia do të kërkonte falje, do të ishte një dëshmi se ajo ka ndryshuar ca, por nuk na përket neve që t'ia falim. Dhe, kur Serbia do të kërkonte falje, kjo do të thoshte që ajo e pranon fajin dhe i hapet rruga dëmshtëpërblimeve dhe zhdëmtimit. Kur Serbia kërkon falje dhe e pranon fajin, atëherë ajo tashmë është në gjyq dhe kjo është një gjë shumë e mirë, e jo sikurse tash ku ajo neve na hedh në gjyq në GJND, e ne gëzohemi se shpëtuan prej gjyqit të Serbisë.

Prandaj, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, pa kushte për Serbinë, ia falë Serbisë krimet, pa na kërkuar falje ajo. Ne jemi për të kundërtën, që Serbia të na kërkojë falje, por pa thënë se do t'ia falim asaj, ndërkohë që ju po ia falni, pa na kërkuar falje.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjalën e ka propozuesi i rezolutës, zoti Grabovci, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeverisës,

Kolegë të nderuar,

Pas konsultave të nevojshme dhe pas debatit shumë konstruktiv, unë fillimisht dua t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare për bashkëpunim të sinqertë, korrekt. Kemi bërë ndërhyrje të vogla në preambulë. E kemi përpara dokumentin në preambulë, me propozim të grupeve parlamentare dhe nga debati është shtuar, duke insistuar në implementimin e marrëveshjeve të arritura.

Në pikën një, kemi një ndryshim të fjalëve, me kërkesën e LB-së, të aprovuar nga gjithë shefat e grupeve parlamentare tjera, Kuvendi i Republikës së Kosovës, mbështet procesin e zgjidhjes së problemeve midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, pjesa tjetër është e pandryshueshme.

Dhe, në pikën tre, është shtuar, rregullimin e brendshëm dhe rendin unik kushtetues të Kosovës.

Dhe, në pikën gjashtë, ku ka qenë, rezultati final, është shtuar, marrëveshjet e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet shteteve do të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Këto ishin ndryshimet, që kanë dalë nga debati. Unë i falënderoj të gjithë deputetët dhe shefat e grupeve parlamentare, për bashkëpunim të korrekt, të sinqertë, përveç Grupit Parlamentar të "Vetëvendosjes". Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Grabovci! Të nderuar deputetë, konstatoj që janë shteruar të gjitha diskutimet lidhur me këtë. Tani në vazhdim kërkoj deklarinimin me votim për miratimin e Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Në mbledhje janë të pranishëm 106 deputetë, ndërkaq duke i llogaritur ata që dolën, kanë mbetur 95 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj që me 68 vota për, 4 abstenime, 3 kundër, Kuvendi e miratoi Rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Kemi... urdhëro!

(Debaton dikush në sallë, por nuk dëgjohet për transkriptim.)

Problemi është se janë ngrehur të gjithë në këmbë për pauzë. A e lëmë pas pauze? Po mirë, dy minuta unë... po, po janë në këmbë të gjithë.

Në qoftë se keni mirëkuptim...

Atëherë shkojmë në pauzë deri në orën 16:30.

(Vazhdimi i seancës pasdite, në orën 17:10.)

KRYETARI: Po presim edhe pak. Regjia, i bini ziles, që të vijnë deputetët.

Atëherë, nëse jeni dakord, do të fillojmë punën me pikat sipas rendit të ditës. Nuk votojmë, sepse votimin do ta bëjmë atëherë kur të kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve.

(Ndërhyrje)

Urdhëro!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: *(Flet nga ulësja, pa kyçje të mikrofonit)* Unë e kam kërkuar fjalën menjëherë, dhe kam pritur. Kryesuesi më ka premtuar që do të ma japë fjalën....

KRYETARI: Jo, akuza s'kanë qenë. Merre fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Sot, kryetari i Parlamentit, zoti Jakup Krasniqi, duke e keqpërdorur në mënyrë flagrante pozicionin e tij, me shpifje...

KRYETARI: Regjia, ia ndal fjalën!

Regjia vepron sipas kërkesës së Kryetarit.

(Reagim i ministrit Bajram Rexhepi - nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: E jep urdhra tani!

Unë jam shef i Kuvendit, e nëse ti do të bëhesh shef dhe mbret i Kosovës, unë jam shef i Kuvendit.

Po vazhdojmë me pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e amendamenteve të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, si propozues i çështjes që ta marrë fjalën. E ke fjalën, ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Deputetë të nderuar,
Republika e Kosovës është anëtarësuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar në vitin 2009 dhe e ka si orientim strategjik zhvillimor avancimin e bashkëpunimit me FMN-në dhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare.

Republika e Kosovës, si anëtare me të drejta të plota të FMN-së i ka edhe obligimet e saj, të marrë pjesë aktive në veprimtarinë e FMN-së.

Bordi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, si organi më i lartë vendimmarrës i FMN-së, ka vendosur për amendamentimin e neneve të Marrëveshjes së FMN-së lidhur me zgjedhjen e drejtorëve ekzekutivë. Ky ndryshim është diktuar nga zhvillimet e kohëve të fundit në planin ekonomik dhe financiar në botë dhe synon avancimin e rolit të përgjithshëm të FMN-së.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, me Rezolutën numër 66-2 mbi rishikimin e 14-të të përgjithshëm të kuotave dhe reformën e Bordit Ekzekutiv, ka paraparë amendamentimin e neneve të Marrëveshjes së FMN-së lidhur me Bordin Ekzekutiv.

Këto ndryshime kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtorëve ekzekutivë si anëtarë të Bordit Ekzekutiv.

Sipas ndryshimeve të propozuara, të gjithë ata duhet të jenë të zgjedhur, për dallim nga periudha e mëhershme kur drejtorët ekzekutivë janë caktuar nga 5 vendet më të mëdha, në këtë rast: SHBA, Japonia, Gjermania, Britania e Madhe dhe Franca.

Përfundimisht, duke marrë parasysh rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të Republikës së Kosovës në FMN, në mbështetje të nenit 18 dhe 65, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ministria e Financave, në bashkëpunim dhe koordinim me BQK-në, e ka hartuar këtë projektligj për ratifikimin e amendamentimit të neneve të Marrëveshjeve së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv, për të cilin rekomandojmë të miratohet nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2012 e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e amendamentimit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv, i cili ka për qëllim mbështetjen e ndryshimeve të bëra nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, përkatësisht amendamentimin e neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me zgjedhjen e drejtorëve ekzekutivë si anëtarë të Bordit Ekzekutiv.

Pasi Republika e Kosovës është anëtare e barabartë e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Komisioni vlerësoi se është e domosdoshme që Republika e Kosovës të jetë pjesë aktive në aktivitetet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, si një institucion financiar ndërkombëtar që ka për qëllim ruajtjen e stabilitetit të rrjedhave financiare ndërkombëtare.

Meqë nuk përmban implikime buxhetore shtesë dhe miratimi i tij është në funksion të fuqizimit të pozicionit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Komisioni i rekomandon Kuvendit ta ratifikojë Projektligjin me të cilin i jepet mbështetje amendamentimit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

(Ndërhyrje)

Nga shefi i Grupit, unë e kam emrin e deputetes që e ka kërkuar fjalën. E ti, urdhëro pra! Fjalën e ka Adem Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Unë, në emër të grupit të falënderoj për sjelljet dhe qëndrimet korrekte që i ke ndaj Grupit Parlamentar të PDK-së.

Ne si Grup Parlamentar vlerësojmë se, pas situatës së krijuar, nuk shohim se janë kushtet për të vazhduar më tutje kjo seancë. Përderisa merr guximin që edhe ministrat, edhe shefin e Grupit Parlamentar t'i largosh prej sallës, ne të dëshirojmë punë të mbarë. Faleminderit shumë, edhe një herë!

KRYETARI: Udhë mbarë ju qoftë! Përndryshe, ministri është dashur të kërkojë dorëheqje sot, ta japë dorëheqjen pa i thënë ne.

(Ndërhyrje, në të dalë nga salla.)

... Me kaq po e mbylлим seancën. Mirupafshim në vazhdimin e seancës!

(Vazhdimi i seancës më 19.10.2012)

(Mbledhjen e kryeson nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete,
Zotërinj deputetë,
Zotërinj ministra,
Mirë mëngjesi!

Po vazhdojmë me seancën e djeshme. Vazhdojmë me seancën e djeshme, përkatësisht me pikën e pestë të rendit të ditës: *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamenteve të neneve të Marrëveshjes të Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.*

Ministri Hamza e ka dhënë sqarimin e tij dje. Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, është paraqitur zonja Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Projektligji për ratifikimin e amendamenteve të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv synon krijimin e bazës ligjore për dhënie të pëlqimit për këtë amendament nga Republika e Kosovës si anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili mundëson ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv, në pajtim me procedurat përkatëse të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Amendamenti në fjalë nuk ka ndryshim domethënës të të drejtave të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ndryshimet nuk kanë ndikim në Buxhetin e Republikës së Kosovës, mirëpo ky amendament është në funksion të avancimit të rolit të përgjithshëm të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në pajtim me zhvillimet bashkëkohore, ekonomike dhe financiare në botë.

Projektligji është në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta mbështesë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, me kartelën e zotit Asllanaj.

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit, kryesues!

Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah fuqishëm anëtarësimin dhe është gjithmonë që institucionet dhe Qeveria e Kosovës të mos rrezikojë asnjëherë anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, rrjedhimisht e përkrah dhe Projektligjin për

ratifikimin e amendamenteve të neneve të Marrëveshjes të Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nga “Vetëvendosje”, zonja Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah projektligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nga AAK-ja, zoti Neziraj, me kartelën e zonjës Kadrijaj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit!

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë marrëveshje dhe do ta votojë atë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zotëri nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë rëndësinë e Projektligjit për ratifikimin e amendamenteve të neneve të Marrëveshjes së Fondit Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv, Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re i jep përkrahje projektligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! SLS-ja nuk është paraqitur. Nga Grupi “6+”, Enis Krvan!

ENIS KERVAN: Ju faleminderit nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetë tjerë të paraqitur për diskutim nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se e dëshiron fjalën? Jo.

Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, por nuk mund ta hedhim në votim, do ta lëmë kur të jenë 2/3 e deputetëve në Kuvend, për faktin se për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje kërkohen së paku 80 vota. Prandaj, meqenëse nuk ka deputetë në numër të duhur në sallë, nuk e hedhim në votim. E lëmë kur të ketë kuorum të mjaftueshëm për të votuar. Ju faleminderit!

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Hamza si propozues i çështjes që ta arsyetojë projektligjin. Ju faleminderit!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti nënkryetar!

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Fondi Monetar Ndërkombëtar, anëtar i të cilit me të drejtat të plota është edhe Republika e Kosovës, me Rezolutën numër 66-2, mbi rishikimin e paraparë - rritjen e përgjithshme të kuotave të vendeve anëtare nga rreth 237,6 miliardë të drejta speciale të tërheqjes, në rreth 476,8 miliardë të drejta speciale të tërheqjes. Si pjesë e kësaj rritjeje parashihet edhe rritja e kuotës së Republikës së Kosovës, nga 59 milionë të drejta speciale të tërheqjes, e cila është aktualisht, në 82,6 milionë të drejta speciale të tërheqjes.

Kjo ngritje e nivelit të kuotës mundëson edhe rritjen e mundësisë së qasjes në kredi dhe mbajtjen e nivelit të të drejtave të votimit. Kjo rritje duhet të aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nëpërmjet ligjit, ashtu siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare.

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në përputhje me Ligjin për marrëveshje ndërkombëtare, deputetë të nderuar, ju lus për aprovimin e projektligjit në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, zonja Hadërgjonaj, e ka fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Ju faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar më 26 shtator 2012, kur ka qenë i pranishëm edhe ministri, që e ka dhënë çdo kërkesë, të cilën e ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa, domethënë i ka dhënë arsyetimet e nevojshme në lidhje me këtë projektligj, i cili ka për qëllim mbështetjen e ndryshimeve të bëra në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ku parashihet edhe rritja e kuotës së Kosovës me të drejta speciale të tërheqjes dhe ka vlerësuar se është e domosdoshme për Republikën e Kosovës që të jetë pjesë aktive e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ta fuqizojë pozicionin e vet në këtë institucion ndërkombëtar të rëndësishëm financiar.

Meqë ndryshimet e bëra në Fondin Monetar Ndërkombëtar për rritjen e kuotës së vendeve anëtare kanë për qëllim rritjen e mundësisë së qasjes në kredi dhe mbrojtjen e nivelit të të drejtave të votimit dhe duke pasur parasysh faktin se rritja e kuotës është e përbalueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë ratifikimin e Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Projektligji për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar është bazë ligjore e posaçme për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në këtë fond, që do të realizohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kjo mundëson rritjen e nivelit absolut të mundësisë së qasjes në kredi. Për Republikën e Kosovës, esenciale është pjesëmarrja në një organizatë ndërkombëtare, që ka për qëllim parësor stabilitetin e rrjedhave financiare ndërkombëtare. Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështesë këtë projektligj.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zonja Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, me kartelën e zotit Asllanaj.

HYKMETE BAJRAMI: Ju faleminderit, kryesues!

LDK-ja e përkrah edhe këtë projektligj për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ne emër të “Vetëvendosjes”, zonja Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i jep përkrahje këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: AAK-ja, zoti Neziraj, me kartelën e zonjës Kadrijaj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah këtë projektligj për arsye se është mjaft me rëndësi bashkëpunimi i ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me një institucion mjaft të rëndësishëm financiar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, kryetarja zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrahë Projektligjin për ratifikim, për rritjen e kuotës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+”, zoti Kervan.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah projektligjin.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të grupeve parlamentare u dha mendimi. Fjalën e ka zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Ju faleminderit, kryesues!

Desha ta shfrytëzoj rastin, meqenëse po flasim për rritjen e kuotës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ta inicioj të paktën nëse është e mundshme një lloj diskutimi për këtë çështje dhe, në përgjithësi, për marrëdhëniet që i ka Kosova me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke u bazuar pak edhe në synimet që i ka Qeveria e Kosovës në programin e vet për këto marrëdhënie. Pra, çfarë mendon të bëjë Qeveria e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar për shkak se u përmend disa herë dhe është bërë si një lloj vjershe që e kemi mësuar, se marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar janë esenciale, por vërtet unë mendoj që duhet ta dekonstruktojmë për çka janë esenciale. Pra, presim ndihmë nga FMN-ja? Çfarë ndihme presim nga FMN-ja? A kemi plan të hyjmë në kredi në FMN? Çfarë kredie do të marrim nga FMN-ja? Për çka? Për shkak se e dimë, me gjithë tentimin e vazhdueshëm që të mitizohet kjo organizatë ndërkombëtare dhe përkundër, të them ashtu ‘montros’ së politikës, jo vetëm në Kosovë, por në përgjithësi në botë për ta lavdëruar këtë organizatë, së bashku me Bankën Botërore e tjera, ka edhe shumë probleme që kanë rrjedhë nga këto organizata dhe ka edhe shumë kokëçarje ekonomike që u kanë shkaktuar këto organizata veçanërisht vendeve të vogla dhe veçanërisht vendeve të pazhvilluara dhe rrjedhimisht marrëdhënia e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar duhet të jetë shumë e kujdesshme, në mënyrë që të mos i përsëritim gabimet që i kanë bërë të tjerët në këtë marrëdhënie. Pra, duhet ta dimë të gjithë që kreditimi nga FMN-ja nuk vjen pa kushte. FMN-ja kurrë nuk jep kredi pa kushte dhe rrjedhimisht këto kushte nganjëherë i kanë shkatërruar ekonomitë nëpër shumë vende të Afrikës, madje edhe të Azisë dhe të Amerikës Latine. Për këtë ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Pra, Kosova duhet të synojë që në asnjë moment të marrë kredi nga FMN-ja, përveç në rast se kur është jashtëzakonisht e domosdoshme, mirëpo edhe në ato raste duhet të mendohet mirë se a po merret kredia nga FMN-ja për shkak të këtyre kushtëzimeve.

Çështja e dytë që unë kisha dashur, e prita një shpjegim pak më të zgjeruar të ministrit për këtë çështje, për shkak se po flasim megjithatë për paratë e Buxhetit të Kosovës që do të shkojnë të deponohen në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Mund të thuhet që ndoshta nuk janë shumë para, por megjithatë janë disa miliona dhe ato ne duhet ta kuptojmë se çfarë marrim si kthim. Pra, pse po investojmë, ose pse po i deponojmë këto para në Fondin Monetar Ndërkombëtar? Në ligj thuhet se kjo do t’ia rrisë mundësinë ose qasjen Kosovës në kreditë e FMN-së. Pra, kjo rritje e kuotës. Mirë, por çfarë kredie dhe për çka?

Dhe e dyta është: A do të ndikojë kjo rritje e kuotës edhe në rritjen e votave që Kosova i ka në Fondin Monetar Ndërkombëtar, për shkak se e dimë që Fondi Monetar Ndërkombëtar funksion sipas parimit “një dollarë - një votë”. Pra, sa më shumë para të kemi, më shumë vota, pra rritet pak edhe mundësia e ndikimit të vendimmarrjes në FMN, edhe pse natyrisht edhe kjo rritje nuk e vendos Kosovën në kushedi çfarë pozicioni për shkak se e dimë se vendet e zhvilluara në fakt e kontrollojnë FMN-në, realisht. Mirëpo, duhet ta kemi parasysh se çfarë mënyre dhe si do të përkthehet kjo në rritje të votës nëse përkthehet në rritje të votës, e nuk jam i sigurt.

Dhe çështja e tretë është që të gjithë do të duhej ta dini, por nuk mendoj se të gjithë e dinë që këto të drejta speciale të tërheqjes nuk janë, domethënë një e drejtë nuk është e barabartë me një euro ose me një dollar. Pra, është një raport këmbimi dhe këtë raport këmbimi mendoj se është mirë, vetëm sa për informim ta kemi, që ta dimë se çka nënkupton 80-milionëshi i të drejtave të veçanta kur e përkthejmë në euro apo në dollarë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën!

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Para vetes e kemi projektligjin më të shkurtër që e kemi miratuar në këtë Parlament, vetëm me 4 nene. Ndoshta do të ishte mirë që edhe ligjet e tjera t'i kemi më të shkurtra, ashtu që të jenë më të lehta për t'u kuptuar, por kjo është një çështje tjetër. Vlerësoj se, pa marrë parasysh vëllimin e Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ai është i rëndësishë së veçantë, posaçërisht kur kemi parasysh se bëhet fjalë për pagesat nga buxheti, por edhe për të drejtën speciale të tërheqjeve që do të ketë Kosova në këtë institucion financiar ndërkombëtar.

Në parim, e mbështes këtë projektligj, nëse ai në esencë paraqet lehtësi për financimin e Buxhetit të Kosovës, nëse ai ka nevojë për ndërhyrje, e si janë duke rrjedhë shpenzimet, atëherë kjo do të jetë e domosdoshme. Mendoj se duhet të thuhet më qartë se rritja e kuotës bëhet për shkak të kërkesave që vijnë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, apo se Kosova ka nevojë për këtë. Nëse kjo është nevojë jona, atëherë si u paraqit kjo dhe cilat janë përfitimet, pastaj në opinionet që jep Departamenti i Buxhetit, si pjesë përcjellëse e këtij dokumenti, thuhet: "Nuk prodhon aktualisht kosto shtesë buxhetore". Ndërkaq, më tutje vazhdon: "Kuptohet se zotimet e Qeverisë për rritjen e kuotës në vete paraqesim një risk buxhetor". Pra, ku qëndron ky risk buxhetor dhe si mund të paraqitet ai? Po në këtë shkresë thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndajë për këtë qëllim 7,1 milionë euro, ndërkaq citoj: "Pjesa tjetër mbetet zotim i Qeverisë në raport me Fondin Monetar Ndërkombëtar". Ka mbetur e paqartë se çka nënkupton pjesa tjetër, bëhet fjalë për obligimin shtesë financiar, apo për një obligim jofinanciar që del nga marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, zoti ministër Hamza, e dëshironi fjalën? Zoti Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Fillimisht dëshiroj t'i falënderoj të gjitha grupet parlamentare për mbështetje. Dëshiroj t'i falënderoj deputetët për diskutimet e tyre dhe do të bëj përpjekje t'i japë disa sqarime. Anëtarësimi në këto dy institucione është një prej të arriturave më të mëdha të Republikës së Kosovës. Ka qenë një punë mjaft e vështirë edhe për shkak se e dimë pjesëmarrjen e vendeve që janë anëtare të këtyre dy institucioneve. Kosova është anëtare me të drejta të barabarta. Vendimet për rritjen e kuotës që janë marrë dhe, pavarësisht, Kosova nuk ka fuqi të ndikojë në këto vendime të FMN-së për shkak të fuqisë së saj të kufizuar, mirëpo

për ta ruajtur nivelin aktual të së drejtës së votës duhet të rritet edhe kuota e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sa i përket kostos buxhetore, aktualisht nuk ka kosto buxhetore, sepse Republika e Kosovës e jep një notë premtuese që në të ardhmen mund të ketë kuotë, ndërsa sa u përket relacioneve të Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne jemi në një marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që në fund të këtij viti, nëse të gjitha gjërat rrjedhin ashtu qysh janë të planifikuara dhe janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, kjo marrëveshje pritet që të ngrihet në nivel të një programi të kujdesit paraprak, ndërsa Fondi Monetar Ndërkombëtar, në bazë të nenit 4 të marrëveshjes së tij, e ka të drejtën e rishqyrtimit të situatës makro-fiskale dhe financiare në të gjitha vendet e botës, e këtë të drejtë e ka edhe në Kosovë.

Dhe, aktualisht, në Kosovë është duke qëndruar një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili është duke e kryer rishikimin e dytë të marrëveshjes që vendi ynë e ka me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Janë të gjitha gjasat që ky rishikim të jetë pozitiv dhe pritet dispursimi i fundit nga kjo marrëveshje që do të jetë për këtë vit. Kosova nuk planifikon që në të ardhmen të hyjë në kredi në këtë institucion dhe do të vazhdojë relacione me këtë institucion, sikur të gjitha vendet tjera. Mirëpo, rritja e kuotës e mundëson vetëm rruajtjen e nivelit aktual të fuqisë votuese të Kosovës në këtë institucion, që edhe ashtu është mjaft e vogël.

Ndërsa sa u përket relacioneve me valutat tjera, e drejta speciale e tërheqjes apo SDR është valutë me të cilën punon Fondi Monetar dhe Banka Botërore. Nuk është kurs fiktiv, është kurs fluktuiv dhe ndryshon varësisht prej rrethanave. Do të thotë mund sot ta ketë një fuqi euro në raport me SDR-in, po varësisht prej ndryshimeve të rrethanave kjo prapë ndryshon, domethënë është kusht fluktuiv nuk është kurs fiks.

Unë edhe një herë dua të ju falënderuar për mbështetjen, për përkrahjen dhe është mirë që Kosova të jetë në harmoni edhe me vendet tjera, të cilat veç e kanë aprovuar ndryshimin e kësaj kuote brenda Fondit Monetar Ndërkombëtar, që ka qenë nga 237 miliardë, e drejta speciale e tërheqjes, e cila është ngritur në 476,8 miliardë. Domethënë e kanë bërë ngritjen në vendet më të fuqishme, me ekonomi më të fuqishme, ndërsa pjesëmarrja e Kosovës është mjaft simbolike për shkak të fuqisë sonë të kufizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe për këtë projektligj në sallë janë 76 deputetë, nuk janë 2/3, prandaj nuk mund ta hedhim në votim. E lëmë kur të kemi kuorum të mjaftueshëm.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Kusari-Lila, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti legjislativ, shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara.

Arsyeshmëria për këtë projektligj është se ky ligj mundëson zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës laboratorike të nevojshme për kontrollin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara, implementimin e kërkesave për kontrollin e cilësisë së punimeve të metaleve të çmueshme, sigurinë e produkteve, mbrojtjen e konsumatorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë.

Bazuar në nevojën për ngritjen institucionale me qëllim të ngritjes së konkurrencës në tregun vendor dhe të jashtëm, eliminimin e barrierave të mundshme tregtare, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka hartuar Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara.

Me qëllim të sigurimit të kontrollit të cilësisë së punimeve, sigurimin e mbrojtjes së konsumatorit, të interesit publik, si dhe zhvillimin e një sistemi metrologjik të Kosovës, në përputhje me të gjitha kërkesat relevante ndërkombëtare.

Me Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara rregullohet përshtatja e prodhimit dhe e shitjes së punimeve nga metalet e çmuara me harmonizimin e kuadrit legjislativ të Kosovës dhe rregullave teknike sipas modelit të BE-së, i cili është kompatibil me praktikën e Organizatës Botërore të Tregtisë, me standardet ndërkombëtare ISO 9202, me të cilat përcaktohen kërkesat teknike për produktet sa i përket përbërjes dhe pastërtisë së punimeve, të drejtat dhe detyrat e prodhuesve dhe të importuesve të punimeve nga metalet e çmuara, si dhe rregullohet mënyra e kontrollimit dhe vulosjes së punimeve nga metalet e çmuara.

Ky ligj zbatohet në të mirë të respektimit të të drejtave të qytetarit, përmbushjes së nevojave të tij personale dhe familjare, si dhe në të mirë të realizimit të kërkesave dhe interesave në jetën dhe aktivitetet të përditshme shoqërore.

Qëllimi i këtij ligji është të mundësojë forcimin e kapaciteteve institucionale, forcimin e kapaciteteve administrative në kontekst të ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave të kontrollit të cilësisë së punimeve me metale të çmuara në qarkullimin publik, forcimin e partneritetit ndërmjet aktorëve kyç të implikuar në mbikëqyrjen e tregut dhe zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë, standardizimit, akreditimit dhe certifikimit, mbrojtjen e konsumatorit dhe të subjekteve afariste.

Ky projektligj është i hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës, është pranuar deklarata financiare dhe deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Projektligji ka 33 nene dhe e ka formën standarde që parashihet me aktet juridike në Republikën e Kosovës.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji dhe duke pasur parasysh nevojën e avancimit të kuadrit ligjor dhe zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara në qarkullim publik, mbrojtjen e konsumatorit dhe subjekteve afariste, ju rekomandoj që pas shqyrtimit ta miratoni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E nderuara ministre, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 25 shtator 2012 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara dhe ka vendosur t'ia përcjellë Kuvendit me rekomandimin që të miratohet në parim.

Komisioni po ashtu e ka themeluar edhe grupin punues, në ndërkohë ne kemi marrë edhe interesime të veçanta nga shoqata përfaqësuese zeytare, të cilat merren me përpunimin e metaleve. Dhe, dëshiroj që ta shfrytëzoj rastin në Kuvend t'i ftoj në fazën vijuese të gjithë ata që janë të interesuar, përveç deputetëve të Kuvendit, që të vijnë edhe në dëgjimet publike, edhe në aktivitetet e grupit punues dhe të Komisionit, në mënyrë që ky projektligj të jetë sa më i kompletuar.

I ftoj grupet parlamentare, përkatësisht deputetët që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përsëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar ligjin në fjalë dhe ka vendosur që ta mbështesë në parim.

Punimet nga metalet e çmuara në vendin tonë rregullohen me Ligjin numër 2004/28, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2004.

Me Ligjin për punimet nga metalet e çmuara rregullohet përshtatja e prodhimit dhe shitjes së punimeve nga metalet e çmuara me standarde ndërkombëtare ISO, përcaktohen kërkesat për produkte sa i përket përbërjes dhe pastërtisë së punimeve nga metalet e çmuara, të drejtat dhe detyrat e prodhuesve dhe të importuesve të punimeve nga metalet e çmuara, rregullohet mënyra e kontrollimit dhe e vulosjes së punimeve nga metalet e çmuara.

Ky ligj zbatohet në të mirë të përmbushjes së nevojave të qytetarit, nevojave personale dhe familjare.

Plotësim-ndryshimi i këtij ligji është paraparë dhe është bazuar kryesisht në nevojën për ngritjen institucionale, me qëllim të ngritjes së konkurrencës në tregun vendor dhe të jashtëm, eliminimin e barrierave të mundshme tregtare, sigurimin e kontrollit të cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara, sigurimin e mbrojtjes së konsumatorit, si dhe zhvillimin e një sistemi metrologjik të Kosovës, në përputhje me të gjitha kërkesat relevante ndërkombëtare.

Ajo që vlen të përmendet është se fusha e dispozitave të Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara nuk hyn në çështje të rregulluara me legjislacionin e BE-së, pasi legjislacioni evropian nuk përmban akte që e rregullojnë këtë fushë, duke e lënë atë në diskrecion të shteteve anëtare që ta rregullojnë në bazë të politikave të tyre të brendshme. Kjo na bën të nënkuptojmë që projektligji nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të BE-së.

Ne si Parti Demokratike e Kosovës, por edhe si grup parlamentar i kemi marrë edhe propozimet nga grupet e interesit në lidhje me këtë projektligj, edhe pse në materialin që na është ofruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shihet se gjatë draftimit, gjatë plotësim-ndryshimit të këtij ligji kjo ministri ka mbajtur kontakte dhe takime me grupet e interesit dhe i ka përfshirë të gjitha materialet, kontaktet dhe konkluzionet që kanë dalë nga ato grupe të interesit. Ne kem obligim që t'i ballafaqojmë kërkesat, të cilat kanë ardhur në Komision dhe ato kërkesa që i kanë parashtruar gjatë draftimit të këtij ligji. Krejt në fund, edhe një herë po përsëris, e mbështetim këtë ligj në parim si grup parlamentar, kurse kontributin tonë do ta japim në fazat e mëtejshme në Komision Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Me aprovimin e Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara do të zëvendësohet ligji paraprak 2004/28, gjë që është praktikë e mirë, pasi kohëve të fundit kemi raste të shumta të plotësimit të ligjeve, që u bashkëngjiten ligjit bazik, me ç'rast komplikohet përdorimi i tyre.

Siç thuhet në memorandumun shpjegues, ky ligj nuk ka implikime buxhetore. Ligji mëton të rregullojë prodhimin, shitjen, punimin nga metalet e çmuara, kërkesat teknike, pastërtinë sipas standardeve ndërkombëtare ISO 92/02, të drejtat dhe detyrat e

prodhuesve dhe importuesve të punimeve nga metalet e çmuara, mënyrën e kontrollit, të vulosjes së punimeve.

Gjithashtu, në projektligj definohej më saktë përgjegjësitë, kompetencat në sistemin e metrologjisë.

Dhe, ky ligj do të duhej të mundësojë fuqizimin e kapaciteteve profesionale administrative, si dhe cilësinë e sigurinë e produkteve dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

E rëndësishme është që ky ligj është i bazuar në ISO standardet ndërkombëtare për kontrollin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara.

Në punimin e këtij projektligji janë konsultuar shoqatat e artarëve dhe të argjendarëve të Kosovës, të cilët, ndonëse ishin ftuar në punimin e këtij projektligji, në fund nga ministria ka ardhur propozimi, i cili i kishte të hequra pjesët me të cilat janë pajtuar këto shoqata, gjë që konstatohet edhe në memorandumin e bashkangjitur nga ministria.

Ky projektligj i rregullon kushtet dhe mënyrën e shënimit dhe harmonizimin me shenja ndërkombëtarisht të pranuar, përcakton obligime mbi shpenzime për ekzaminim dhe shënim, rregullon realizimin e inspektimit dhe mbikëqyrjes metrologjike.

Në ligj duhet pasur parasysh terminologjinë, e cila në nenet e ndryshme ka përdorim të ndryshëm, siç janë termet “produkt”, në nenet tjera “punim”, ose diku përdoret “prishja e punimit”, diku “dëmtimi i punimit”, diku “vula shtetërore”, diku “shenja shtetërore”, si në nenet 8.6, nenet 22.1, neni 9 e të tjera. Ky term duhet të definohej në përkufizime, pasi mungon fare.

Agjencia e Metrologjisë, Drejtoria e Metrologjisë, që tashmë është rregulluar me Ligjin në metrologji, duhet të definohej më qartë në këtë ligj.

Në mjaft nene duhet të ketë riformulime, por edhe vendosje të titullit aty ku mungon, si për shembull në nenin numër 27.

Neni 3 flet për përjashtimin nga aplikimi i ligjit. Në paragrafin 1.6 të këtij neni flitet për punime me gurë e perla nën një gram. Ndërsa në propozim nga Shoqata e Artarëve është që në këtë rast kur punimi i tillë është nën një gram, pastërtia e punimit duhet të përcaktohet përsëri.

Në nenin 4 përcaktohet analiza kuantitative kimike në çdo 10 copë, ndërsa do të duhej që të zëvendësohet me mostra të rëndësishme, e jo në çdo 10 copë.

Në nenin 5 tregohet përgjegjësia e Agjencisë së Metrologjisë në fushën e punimeve nga metalet e çmuara.

Në nenin 5, 3.4 thuhet “te ekzaminimi”, e duhet të jetë “kryen ekzaminimin, kontrollin dhe verifikimin e cilësisë së punimeve”, do të thotë duhet të bëhet një zëvendësim në këtë paragraf të nenit.

Neni 6 flet për standardin ISO 99/02 dhe definon metale çfarë është argjendi, ari, platini dhe paladiumi si metale të çmuara, si dhe për kërkesa teknike duke paraqitur tabelën detale të pastërtisë së tyre në punime dhe në monedha.

Nenet 8 dhe 9 e definojnë pastërtinë e metaleve me shenja shtetërore, në disa nene përdoret fjala “vula”, e në tjera “shenja shtetërore”.

Nenet 8.4 dhe 8.5 lidhen me importin dhe janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, ashtu që duhet të riformulohen.

Në nenin 8.6 duhet riformulim për produktet e importuara, kontrollin dhe ekzaminimin lidhur me vendosjen e shenjës përpara se punimet në vendosen në treg.

Në nenin 8.7 gjithashtu kërkohet riformulim lidhur me shenjën e importuesit dhe letrën garantuese.

Neni 9 e definon raportimin e importuesit dhe duhet rishqyrtuar përsëri për një riformulim më të mirë.

Nenet 12, 13 dhe 16 duhen të rishqyrtohen.

Neni 23 flet për mbikëqyrjen metrologjike, kurse ai 24 për kompetencat e Inspektoratit të Metrologjisë, që duhet të analizohet me Ligjin e metrologjisë dhe kompatibilitetin e këtij ligji me atë.

Neni 28 i ka dispozitat ndëshkuese për subjektet afariste, si dhe për personat përgjegjës, të cilat, thënë drejt, duke mjaft të larta.

Neni 29 i mungon titulli, neni 30 parasheh cilat akte nënligjore mbeten në aplikim deri në ndryshimin e tyre, ndërsa nuk tregohet se cilat akte nënligjore duhet të jenë.

Duke pasur parasysh se ky ligj në fakt është ngushtë i lidhur me Ligjin për metrologji, anëtarët e Grupit Parlamentar të LDK-së në Komision, me amendamentim do të punojnë që ky ligj të jetë, jo vetëm kompatibil, por edhe ta paraqesë një tërësi me Ligjin për metrologji.

Dhe, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta votojë këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë këtë ligj dhe të gjitha vërejtjet teknike që mund t’i kemi do t’i paraqesim në Komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga AAK-ja, zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka analizuar dhe e ka shqyrtuar me shumë kujdes Projektligjin për metalet e çmuara dhe vërejtjet tona kanë të bëjnë me kapitujt, ku duhet të bëhet një harmonizim ndërmjet Ligjit për metrologjinë dhe mbrojtjen e konsumatorëve, sepse mund të ketë ndonjë konflikt dhe po të zbatohen me përpikëri, atëherë besoj që në këta kapituj nuk do të ketë probleme. Prandaj, problemi kryesor është te kapitujt që kanë të bëjnë me kontrollin, me mbrojtjen e konsumatorëve dhe me cilësinë e metaleve.

Prandaj, Grupi i Aleancës në parim do ta përkrahë dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet e përhershme dhe funksionale. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah në parim Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara.

KRYESUESI: Nga “6+”, zoti Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa “6+” podržaće Nacrt ovog zakona i svoj doprinos daćemo u radu Komisije.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Më lejoni që lidhur me drafligjin për punimet nga metalet e çmuara të praqes disa vërejtje dhe propozime konkrete.

Vërejtja e parë ka të bëjë me vetë emërtimin e ligjit, sepse në emërtimin e tij kemi fjalën “punimet”, ndërsa në përmbajtje hasim shprehje të ndryshme, në të shumtën e rasteve shprehjen “punime”, ndërsa në disa vendet, si për shembull në nenin 8.7, pastaj në nenin 25, 28, haset shprehja “produkte”.

Kurse në vetë ligjin të cilin hartuesi e ka pasur model për këtë draft përdoret shprehja “sendi”.

Andaj, propozoj që titulli i ligjit të riformulohet dhe të bëhet Ligji për sendet nga metalet e çmuara.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me unifikimin e terminologjisë së përdorur, që do të thotë se për çështjet, dukuritë dhe institutet e njëjta të përdoren shprehje të njëjta, e jo në një nen fjala “punime”, kurse në tjetrin fjala “produkte”.

Më tutje, paragrafi 4, i nenit 5, është paksa i paqartë, sepse kështu si është paraqitur nënkupton që agjencia është organi i cili vendos në rastet kur është në kontest me organet e tjera, e në të vërtetë duhet të kemi formulim sipas të cilit bëhet e qartë se agjencia vendos në procedurat administrative nga fusha e kontrollit të sendeve prej metaleve të çmuara.

Komenti tjetër ka të bëjë me nenin 12, në paragrafin e parë të të cilit theksohet: “Prodhuesi, para vendosjes në treg, është i obliguar që punimin ta dërgojë për ekzaminim dhe shenjim në laboratorin e metaleve të çmuara”. Kështu siç është rregulluar nënkupton që çdo prodhim apo çdo send i metalit të çmuar duhet të dërgohet për ekzaminim dhe shenjim në laborator, gjë që do ta vështirësonte punën e të gjithë prodhuesve të sendeve të kësaj natyre, por edhe punën e laboratorit, sepse më duket tejet e rëndë që të gjitha prodhimet të kalojnë nëpër këtë laborator.

Prandaj, është mirë që ky ligj të ketë edhe dispozita me të cilat përcaktohet që prodhuesi, i cili disponon me dokumentet përkatëse, të lëshuara nga ministria, nuk ka nevojë ta dërgojë çdo prodhim të tij në ekzaminim dhe shenjim, por vetëm ato për të cilat nuk ka dokumentacion adekuat. Njëherësh, me këtë dokumentacion ai duhet të obligohet që prodhimet e veta t’i shënjojë me shenjën e prodhuesit dhe shenjën e pastërtisë së sendit, si dhe obligohet që ta mbajë evidencën e saktë për të gjitha prodhimet e tij.

Po ashtu, këtij ligji i mungojnë dispozitat me të cilat rregullohet procedura se si duhet vepruar laboratorit pas kryerjes së ekzaminimit, qoftë në rastet kur sendi është në pajtueshmëri me shenjën e pastërtisë, e sidomos në rastet kur sendi nuk është në pajtueshmëri me shenjën e pastërtisë, respektivisht kur nuk i plotëson kushtet e tjera të përcaktuara me ligj. Dispozitat e këtilla duhet inkorporuar pas nenit 14 të këtij draftligji dhe me to duhet theksuar se në situata të tilla laboratorit merr vendim mbi refuzimi e kërkesës. Po ashtu, duhet përcaktuar që prodhuesi kundër vendimit të tillë ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, për të cilën vendos ministri, kurse ndaj vendimit të ministrit mund të iniciohet kontest gjyqësor.

Gjithashtu, këtij drafti duhet shtuar dispozitat me të cilat përcaktohet se pas shënimit të sendit nuk bën që sendit të tillë t’i shtohen pjesë nga metalet, qoftë të çmuara apo të rëndomta, e as materiale të tjera që nuk mund të shihen apo dallohen. Ndërsa neni 17, me të cilin rregullohet çështja e plotësimit të formularit, respektivisht kërkesës për ekzaminim dhe shenjim, propozoj që të bartet në nenin 12, pas paragrafit të parë, sepse në aspektin procedural, kohor dhe logjik kjo çështje duhet trajtuar në këtë pjesë të ligjit.

Gjithashtu, te nenet 23 dhe 24, përveç rregullimit të përgjegjësive të Inspektoratit të Metrologjisë, mendoj se duhet përcaktuar edhe disa prej përgjegjësive të Inspektoratit të Tregut në raport me sendet prej metaleve të çmuara. Krejtësisht në fund i kam edhe disa vërejtje të natyrës teknike dhe atë, konkretisht në nenin 22, paragrafi i parë, versionin në gjuhën shqipe dallon në masë të madhe nga versionin në gjuhën serbe. Gjithashtu, edhe në neni 25, paragrafi dy, në gjuhën shqipe bëhet fjalë për produktet që u ndalohej shitja, kurse në të njëjtin paragraf në gjuhën serbe flitet për afatin kohor të paraqitjes së kërkesës. Kurse, në nenin 25, paragrafi katër, në versionin shqip bëhet fjalë mbi një vendim për prishjen e punimeve që nuk janë konform ligjit, gjë që duket e palogjikshme që sendet e caktuara të prishen. Kurse, në versionin në gjuhën serbe dhe atë angleze bëhet fjalë për një vendim me të cilin konstatohet se prodhimi nuk është në pajtim me kërkesat teknike të këtij ligji, gjë që është më i logjikshëm dhe më i pranueshëm. Po ashtu, duhet theksuar se edhe paragrafi 2 i nenit 26 është i paqartë dhe paksa i pakuptimtë në të dy gjuhët, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë serbe.

Njëherësh, neni 29, paragrafi 1.3, në gjuhën shqipe thekson: “Laboratori i masës”, ndërsa në gjuhën angleze dhe serbe “Drejtoria e Metrologjisë së Kosovës”, andaj është mirë që këto mospërputhje ndërmjet versioneve gjuhësore në procedurën e mëtutjeshme të përmirësohen dhe të njëjtat të harmonizohen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë, zonja ministre, e doni fjalën? Jo! Nuk kemi kuorum. I kemi 53 deputetë, tash 55. është mirë që deputetët të hyjnë në sallë, sepse duhet ta votojmë Ligjin për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal, të gjitha janë amendamente. Nuk mund të futemi në votim pa kuorum.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Tani në sallë janë 63 deputetë. Lus regjinë që të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara. Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kisha kërkuar mirëkuptim - të mos dilni nga salla, sepse duhet të kemi kuorum gjatë gjithë kohës së miratimit të amendamenteve.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar

miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Kryetari i Komisionit për Legjislacion nuk është këtu. Atëherë zoti Demolli e ka fjalën, në emër të Komisionit për Legjislacion.

HAKI DEMOLLI: Unë do të flas në emër të Komisionit për Legjislacion, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Komisionit për Legjislacion, duke vepruar në pajtim me nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me propozimin që pas shqyrtimit të amendamenteve përkatëse ta aprovojë projektligjin në tërësi, me të cilin do të shfuqizoheshin nenet mjaft të kontestuar të Kodit Penal të Kosovës, dhe atë nenet 37 dhe 38. Andaj, ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta aprovojnë këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Është çështja më e përfolur në Kuvendin e Kosovës, po ashtu është çështja më e ngritur për mbrojtjen e dinjitetit të deputetit dhe qytetarëve të Kosovës, më e ngritur si çështje për shpifjet, të cilat ua bëjnë deputetëve, ua bëjnë të gjithëve. Prandaj, me këto nene, me keqardhje mund të them që Kuvendi i Kosovës po i nënshtrohet presionit të atyre që janë shpifës, të atyre gazetarëve të cilët merren me keqpërdorimin e profesionit të tyre, meqë ne si standarde të kërimit për të shkuar drejt BE-së i marrim modelet e tyre, dhe i keqpërdorim po ashtu modelet e tyre.

Nëse nenet 37, 38, dhe 39 hiqen nga Kodi Penal i Kosovës, do të thotë që ne e kemi lejuar mundësinë e terrorit që t'u bëhet qytetarëve të Kosovës nga mjetet e informimit, nga gazetarët e papërgjegjshëm dhe nga çdokush që merret me shpifje. E them këtë duke pasur parasysh televizionet, të cilat merren me terrorizimin e Kuvendit të Kosovës, kur deklaron drejtpërdrejt, pa kurrfarë përgjegjësie, pa kurrfarë mase, as ndërgjegje të veten, dhe thotë që një deputet dhe një polic janë vrasës të filan fishekut apo i "x" njeriu. Prandaj, të pranohen këto kode edhe të mos merren masa ndaj këtyre njerëzve, do të thotë që ne si Kuvend, ne si deputetë e ulim dinjitetin tonë, e ulim përgjegjësinë tonë dhe u japim mundësi atyre ta terrorizojnë qytetarin e Kosovës, ta terrorizojnë Kuvendin dhe të mos marrin përgjegjësi ndaj askujt.

Mund të them që nga disa vende, përgatitja e këtij kodi, qoftë edhe nga bashkëpunëtorë ndërkombëtarë, duke mos përfshirë reputacionin nga persona privatë, apo gazetarë, është për shembull Gjermania, që i parasheh këto veprime të kundërligjshme në nenet 185, 187, 188 në Kodin Penal, edhe pse aty nuk përmenden ekskluzivisht gazetarët. Ndërsa, personi, duke përfshirë edhe gazetarët, redaktorët dhe kryeredaktorët e tyre, Austria, si shtet demokratik, i parasheh këto veprime të kundërligjshme në nenet 31, 111, 115, 297, 301 etj., të dënueshme edhe me nenin 6 të Ligjit austriak të medieeve. Në Lihtenshtajn, vend është shumë më i vogël se ne, këto veprime të kundërligjshme i parasheh në nenet 111, 112, 283 të Kodit Penal. Zvicra, që ne e kemi marrë si model, dhe Serbia e ka marrë

po ashtu model, i parasheh në nenet 173, 174, 175, 28a, 322 etj. Pra, të gjithë shtetet e lartpërmendura i kanë paraparë dhe rregulluar këto çështje me kodet e tyre penale.

Është e rëndësishme të ceket se sidomos Zvicra e ka të rregulluar këtë çështjen në Kodin Penal, në mënyrë shumë më të zgjeruar dhe të detajuar, sidomos kur kemi të bëjmë me çështjen e medieve, në nenet 28, 28a, 322 etj., të cilat janë në thelb të ngjashme me nenet e miratuara të Kodit Penal të Kosovës: 37, 38 dhe 39. Nëse Kosova i ka marrë këto nene prej Zvicrës, cila është arsyeja që ato të hiqen? Unë propozoj që nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës të mos hiqen, por të plotësohen, duke ua shtuar shpifjen, ofendimin, fyerjen dhe dëmtimit e reputacionit të çdokujt që e ka të drejtë të mbrohet.

Madje duhet të mësojnë përgjithmonë se ata nuk mund të shkruajnë apo ta shkatërrojnë jetën duke shpifur apo ofenduar në mënyrat më të poshtra të mundshme. Një poshtërsi më e mundshme, më e poshtër që i është bërë Kuvendit të Kosovës është kur mediet deklarojnë se duhet të arrestohet “x” deputeti i kësaj, ose i asaj partie. Cili deputet? Nga 120 deputetë, secili mund të jetë vrasës i Xhemajl Mustafës. Kush do të japë përgjigje? Kush do të arrestohet? Kur do të arrestohet ai? Këto medie kanë shpifur, e ne i tolerojmë. I lejojmë të shpifin përsëri për këto çështje!

Ky është ligj dhe produkt i ndërkombëtarëve, të cilët e kanë paraparë të nevojshëm të jetë këtui. Prandaj, kërkoj nga Komisioni i Ligjeve dhe deputetët që të mos i aprovojnë këto amendamente, por ta fuqizojmë Kodin Penal, i cili është miratuar dhe të mbeten këto nene, me këto dënime, se përndryshe ne jemi pjesë e terrorit shpirtëror, e terrorit mendor, e terrorit psikik në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në Raportin e Komisionit Funkcional. Në sallë janë 78 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër një.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër një.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 63 vota për, 3 abstenime, 1 kundër, konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, deputetin Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i ka shfrytëzuar në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të gjitha mundësitë dhe detyrimet që i ka pasur për ta trajtuar këtë projektligj, i ka bërë amendamentet në bashkëpunim me të gjithë, edhe me institucionet e Qeverisë dhe institucionet tjera dhe me grupet e interesit. I falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar. Ka goxha shumë amendamente. Komisioni ka pasur edhe debate të gjata, në disa prej tyre, që kanë qenë më delikate. Ka pasur edhe amendamente unanime ose me shumicë unanime nga komisioni. Kanë qenë dy amendamente të propozuara brenda komisionit nga zonja Kostiq, të cilat po ashtu janë miratuar nga Kuvendi.

Dua të theksoj se njëri prej amendamenteve nuk e ka pasur mbështetjen e plotë të komisionit, por si do që të jetë Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i propozon amendamentet dhe kërkon nga Kuvendi dhe deputetët që t'i aprovohen.

Në ndërkohë, ju njoftoj se Komisioni për Legjislacion nuk e ka trajtuar fare këtë ligj. Ne kemi kërkuar që bashkë me komisionet tjera ta procedojmë, meqenëse nuk kemi marrë një shpjegim të veçantë pse nuk është proceduar prej Komisionit për Legjislacion. Ne mendojmë që ky ligj i ka plotësuar të gjitha kushtet që sot të aprovohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka kërkuar fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues!

Unë kisha dashur që vetëm te amendamenti 54, kur të vijmë, nëse ma jepni fjalën, një sqarim të shkurtër, meqë kam qenë kryesues i grupit, ose nëse bën edhe tash mund ta sqaroj.

KRYESUESI: Paraqitu kur të vijë radha e amendamentit.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, fillojmë me votimin.

Amendamenti 1.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 30.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 31.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 32.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 33.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 34.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 35.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.
Amendamenti 36.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 37.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 38.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 39.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 40.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 41.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 42.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 43.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 44.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 45.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 46.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 47.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 48.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 49.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 50.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 51.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 52.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 53.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 54, fjalën e ka zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse unë kam qenë udhëheqës i grupit punues për këtë projektligj, ne kemi arritur që bashkë me anëtarët e grupit punues t'i amendametojmë 62 amendamente. Kemi pasur normalisht edhe vërejtje nga anëtarët e komisionit dhe nuk kemi mundur të merremi vesh në amendamentin 54. Këtë amendament e kemi dërguar në komisionin tonë, ku kemi pasur disa vërejtje nga disa deputetë, meqë kemi qenë kundër unë dhe Visari dhe disa kanë abstenuar, por me shumicë ky amendament është votuar që të shkojë në Kuvend.

Sa për sqarim, e kisha pas parasysh se me këtë amendament kërkohet që të vihen gjobat prej 300 - 3 000 euro, nëse në një mall nuk përdoret dygjuhësia e artikullit.

Unë pajtohem me atë që shumë mallra duhet ta kenë dygjuhësinë, por ka edhe mallra të tjera që nuk ka nevojë për dygjuhësi, apo njëgjuhësi. Por, dogana e ka rregullin e vet ka ligjin e vet, që asnjë mall nuk mund të importohet, nëse nuk i ka këto të dhëna: kush e importon, emrin e mbiemrin, adresën e mallit dhe çfarë malli është dhe kush e eksporton,

apo kush e ka prodhuar. Kështu, mallrat që nuk i kanë këto të dhëna ndalohen në Doganë dhe nuk mund të hyjnë në Kosovë.

Për këtë arsye unë propozoj që amendamenti 54 të mos pranohet nga deputetët, për arsye se ne po shkojmë për çdo ligj apo amendament me gjoba, me të cilat do t'i gjobitim tregtarët apo prodhuesit. Unë pajtohem që ligji është për ta mbrojtur konsumatorin, por ka shumë mallra, edhe një herë po e përsëris, në të cilët nuk ka nevojë të shënohen ato detaje. Si shembull jua jap, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Maqedoni e në rajon, ka mallra në të cilët nuk shkruhet, edhe pse ai shtet e ka vetëm njëgjuhësinë.

Merreni si shembull “Palomën”, që në popull njihet si “Palloma”. Nuk ka nevojë të shkruhet aty se duhet kjo apo ajo. Atë e ndalon Dogana, e jo tash ne t'ia mundësojmë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo departamentit të saj që nëse nuk i ka ato detaje të dënohet apo të gjobitet.

Po bëjmë vetëm ligje që sa më shumë t'i gjobitim tregtarët apo prodhuesit, prandaj i ftoj deputetët që ky amendament të mos pranohet nga komisioni që e ka paraqitur. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Kao što je predsednik komisije već naglasio da je ovo predlog amandmana naše Parlamentarne grupe, ono što smo mi zahtevali i insistirali jeste da mi tražimo samo ono što je u skladu sa ustavom, i ono što je u skladu sa zakonom o upotrebi zvaničnih jezika na Kosovu, koji jasno govore da je srpski i albanski jezik u potpunosti ravnopravni sa svim svojim alfabetima, međutim svedoci smo loše tržišne prakse na Kosovu, da se taj zakon uopšte ne primenjuje.

Ono što mi insistiramo jeste da na ceo Nacrt zakona bude u upotrebi i Nacrt zakona o zvaničnim jezicima na Kosovu, što podrazumeva da proizvodi moraju da imaju svoju deklaraciju, uputstvo i sve ostalo što pruža informacije na drugom zvaničnom jeziku, bude i na srpskom jeziku.

Samim tim, to je regulisano amandmanom 11 u članu 4, naravno da ukoliko ovlašćeno lice neće ispuniti svoje obaveze, ukoliko nema kaznena odredba koja ih može sankcionisati ili kazniti. Tako da mislim da je ovo zakon koji štiti potrošače a ne lične interese pojedinih poslanika ovde u Parlamentu uz dužno poštovanje, i oni poslanici koji pozivaju da se ovaj član ne usvaja, ovo je član koji je u skladu sa ustavom članom 5, koji reguliše upotrebu zvaničnih jezika na Kosovu, jer uzimajući kao primer papirne maramice, možemo da uzmemo i primer apoteke gde se nalaze samo deklaracija i uputstva na albanskom jeziku, gde više nije stvar političkih pitanja, već se ovde radi o ugrožavanju života, jer ja možda nisam u mogućnosti da na svom jeziku pročitam uputstvo o određenom leku ili o drugim stvarima. I ujedno želim da naglasim da je ovaj

amandman podržan od strane komisije i svih ostalih stalnih komisija u Parlamentu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Të tjerë të paraqitur nuk ka. Atëherë shkojmë në votim me elektronikë, për amendamentin 54. Votojmë tash!

Me 37 vota për, 23 kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti 54.

Amendamenti 55.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 56.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 57.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 58.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 59.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 60.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 61.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 62.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

E votojmë tani ligjin në tërësi. Të pranishëm janë 76 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 69 vota për, asnjë kundër, një abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011

Raportin vjetor të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe ia ka rekomanduar Kuvendit që të shqyrtohet në mbledhjen plenare me vërejtjet e theksuara në raportin e vet.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Në vend të Arbenit, fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të flas në emër të Komisionit për Legjislacion, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në rregullën 72 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011 dhe ka vlerësuar se raporti nuk ofron informacione të mjaftueshme për punën dhe funksionimin e KQZ-së për shkarkimin e kryeshefit ekzekutiv të sekretarit të KQZ-së dhe për emërimin e ushtruesit të detyrës për këtë pozitë.

Prandaj, i ka rekomanduar Kuvendit që të shqyrtohet Raporti i punës së komisionit për vitin 2011.

Komisioni e ka arsyetuar këtë rekomandim me faktin se i njëjti ka vlerësuar se në raport janë përfshirë probleme dhe vështirësi, që e kanë përcjellë punën e KQZ-së në vitin 2011. Mirëpo, pas shqyrtimit të raportit plotësues, në mbledhjen e datës 19 shtator 2011, i cili ofronte informacione lidhur me bazën juridike të shkarkimit të kryeshefit ekzekutiv të sekretarit të KQZ-së dhe të emërimit të ushtruesit të detyrës në këtë pozitë, komisioni vendosi që raporti me vërejtje për punën, funksionimin dhe bazën juridike të shkarkimit dhe të emërimit të zyrtarëve të sekretariatit të KQZ-së të procedohet për shqyrtim në seancën e Kuvendit.

Në anën tjetër, propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është që pas shqyrtimit në Kuvend të aprovohet raporti i Komisionit Qendror për vitin 2011, e jo i Komisionit për Legjislacion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin dhe të njëjtin do ta aprovojë.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton KQZ-në të jetë institucion i pavarur, kurse neni 139, paragrafi 1 i kësaj Kushtetute, e përcakton KQZ-në si organ të përhershëm, që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe referendumeve, si dhe shpall rezultatet e tyre.

Gjithashtu, Ligji për zgjedhjet e përgjithshme definon qartë përgjegjësitë dhe detyrat e këtij institucioni.

Se sa larg është ky institucion në kryerjen e obligimeve, që dalin nga Kushtetuta dhe ligji, këtë besoj më së miri e tregon gjendja e rëndë në KQZ. Ne jemi dëshmitarë të mosaprovimit nga Kuvendi të raportit të KQZ-së për vitin 2010 dhe ky mosaprovim i raportit ka pasur të bëjë pikërisht me mungesën e transparencës, llogaridhënies së KQZ-së, e ne nuk kemi parë ndonjë reflektim të këtij institucioni deri më tash.

Tani e kemi para nesh Raportin e punës së KQZ-së për vitin 2011. Ky raport, për dallim nga ai i kaluari, së paku në aspektin teknik duket që është më i përgatitur. Mirëpo, shqetësimi më i madh qëndron, jo aq shumë në atë që shohim në raport, por në atë që nuk është përfshirë, apo nuk thuhet në të.

Procesi i zgjedhjeve të vitit 2010, e dimë të gjithë, u dhunua nga pushteti i sotëm dhe u ndihmua po nga KQZ-ja. Edhe pse në letër është institucion i pavarur, në fakt KQZ-ja është shndërruar në leckë, e cila i shërben pushtetit dhe klaneve tjera, për t’ia pastruar të bëmat në proceset zgjedhore. Pra, krejt çfarë KQZ-ja ka bërë deri më tani është legalizimi i vjedhjes së votave nga partia në pushtet.

Gjasat për t’u përmirësuar janë tashmë të pashpresa. Pra, mungon minimumi moral, profesional e institucional në të gjitha vendimet dhe veprimet e këtij institucioni. Gjatë vitit 2011, ky institucion, në vend që ta bënte një analizë mbi problemet e tij profesionale e organizative, në vend që të identifikonte shkaqet e performansës së dobët, në vend që të dërgonte në përgjegjësi administrative e penale zyrtarët e tij të të gjitha niveleve, që janë të ndërlidhur ngushtë me keqpërdorimet dhe vjedhjet e votave, ky institucion vetëm sa u

mundua t'i mbulojë gjurmët e krimit, duke u futur në një aventurë vendimesh e veprimesh, që janë sa të kundërligjshme, po aq edhe të dëmshme.

KQZ-ja është përfshirë në një numër vendimesh, që kanë të bëjnë me ndërprerjen e punës dhe shpalljen e vendeve të punës së kryeshefit ekzekutiv, zëvendëskryeshefit ekzekutiv dhe drejtorit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, vendime këto në kundërshtim me Ligjin e zgjedhjeve, por në kundërshtim edhe me Ligjin për shërbyesit civilë.

Duhet theksuar që këtyre zyrtarëve nuk u është bërë asnjë vlerësim paraprak për performansën e tyre, ashtu siç është paraparë me ligj. Pas ankesave të palëve, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës vendosi dhe e urdhëroi KQZ-në që t'i kthejë mbrapsht vendimet e tij dhe t'i kthejë në punë të larguarit. Mirëpo, ajo që ndodhi është që KQZ-ja në shtator vendosi për vazhdimin e kontratave për vetëm 3 muaj, prapë pa bërë vlerësimin e punës së tyre dhe përsëri në kundërshtim me ligjin.

Pas skadimit të këtyre kontratave, që ishin më shumë hapësirë për shantazh ndaj SKQZ-së dhe pazare ndërmjet KQZ-së, kryeshefi i SKQZ-së shtron kërkesë që t'i gjendet një pozitë në stafin administrativ të SKQZ-së, duke u shprehur qartë se ka presione politike brenda KQZ-së si kryeshef. Përsëri nuk bëhet vlerësimi i punës së kryeshefit, por merret vendim që t'i jepet një pozitë në SKQZ, që bëhet me konkurs dhe përzgjidhet nga SKQZ-ja, e jo nga KQZ-ja. Kurse drejtoreshës së ZRPP-së i vazhdohet kontrata pa vlerësim të punës, kuptohet bazuar në pazar dhe joprofesionalizëm. Për më tepër, asaj i jepet edhe detyra e ushtrueses së detyrës së kryeshefit, të cilën ende e mban, me gjithë kalimin e të gjitha afateve, me gjithë shkeljet e bëra gjatë këtij procesi, me gjithë ankesat e vazhdueshme brenda KQZ-së për këtë çështje.

Pra, si mund të shpallësh vend pune pa bërë vlerësim paraprak të zyrtarëve, të cilëve ua shpall vendin e punës? Me çfarë baze ligjore bëhet kjo dhe me çka arsyetohet kjo?

Kjo është kronologjia e një procesi, i cili ka qenë i fshehur për publikun, i fshehur edhe nga ne, me gjithë kërkesat e shumta për informata shtesë nga KQZ-ja. Kjo përbën një bazë të fortë për hetim, jo vetëm të këtij procesi, por edhe të shumë vendimeve tjera të KQZ-së, të ndërmarra më parë, pa e përjashtuar edhe procesin zgjedhor të vitit 2010.

Situata nuk qëndron aspak më mirë edhe në nivelin organizativ, ku edhe nëpërmjet medieve kemi parë e dëgjuar për udhëtime pune turistike, shpenzime të panevojshme, të cilat do të duhej të orientoheshin në ngritjen e kapaciteteve materiale e njerëzore. Pra, kemi të bëjmë me një institucion, në të cilin organizimi e ka vetëm një emër, dhe ai është kaosi.

Ndikimi politik në KQZ ka marrë dimensione të tilla sikur edhe në çdo institucion tjetër publik, sa ata që refuzojnë t'i nënshtrohen raportit padron-shërbëtor shpesh anatemojnë publikisht nga po ata që e kanë e kapur dhe zhvatur këtë institucion tash e sa vjet. Një institucion në të cilin ka mungesë të njohurive bazë mbi raportet brenda institucioneve, në të cilin punëtori administrativ trajtohet si pronë e këtij apo atij subjekti dhe i cili shtyhet për t'u shërbyer qarqeve të pushtetit apo të partive, ai institucion është natyrisht i destinuar të dështojë, e ky dështim, në rastin tonë, do të kishte pasoja të gjera.

Rruga e vetme e KQZ-së mbetet reflektimi mbi veprimet dhe vendimet e tij në të kaluarën, respektimi i ligjeve përkatëse që e rregullojnë funksionimin dhe vendimmarrjen, që i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e secilit punonjës, që e specifikojnë përgjegjësinë institucionale dhe individuale të secilit anëtar të KQZ-së, e mbi të gjitha të kryetares së KQZ-së.

Deri më tani, nuk kemi parë shenja përmirësimi dhe reflektimi, e për më tepër me këtë nivel të papërgjegjësisë, me këtë nivel të ulët profesional e moral, ne mendojmë se KQZ-ja nuk do të jetë në gjendje t'i kryejë funksionet bazë, të caktuara me Kushtetutë.

Andaj, duke i marrë parasysh të gjitha këto që u thanë më lart, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje do të votojë kundër këtij raporti.

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Ahmet Iufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke pasur parasysh Raportin e punës të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2011, teknikisht është më i përgatitur se raporti paraprak, por, megjithatë, puna në KQZ, e cila ka qenë sidomos gjatë mbajtjes së zgjedhjeve, ka treguar se kemi të bëjmë me një institucion, i cili është përcjellë me imazhin e zgjedhjeve që kanë qenë.

Duke pasur parasysh po ashtu se kemi pasur vërejtje të mëdha, sidomos në punën e Komisionit, kur dihet se kemi pasur zgjedhje të jashtëzakonshme dhe të cilat janë theksuar edhe nga kryetarja e KQZ-së, e cila ka deklaruar se Komisioni Qendror Zgjedhor nuk është i përgatitur dhe duke e ditur paraprakisht se do të ketë pengesa të mëdha, megjithatë e ka marrë përsipër barrën e mbajtjes së zgjedhjeve, organizimit të tyre dhe po ashtu e dimë se në çfarë niveli ka dalë KQZ-ja.

Nga përvoja e kaluar duhet ta kemi parasysh edhe angazhimin e mëtutjeshëm, sepse duhet ta kemi një komision, i cili e merr barrën e përgjegjësisë për të pasur zgjedhje fer, demokratike dhe të përgatitura mirë. Është momenti kur të gjitha ato pengesa, të cilat janë në Komisionin Qendror Zgjedhor dhe të gjitha ato që kanë qenë shkelje ligjore edhe nga KQZ-ja duhet të riparohen dhe të veprohet në bazë të ligjit, në mënyrë që ta kemi një Komision Qendror Zgjedhor, i cili është i përgatitur mirë, profesional, valid dhe i cili organizon zgjedhje, të cilat janë të pranueshme edhe nga publiku.

Prandaj, ky raport duhet të shërbejë si një shembull që situata në KQZ duhet të ndryshohet në të mirë dhe të kemi zgjedhje, të cilat do të jenë demokratike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011 dhe të njëjtin do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke takođe je razmotrila ovaj izveštaj i podržaće isti sa jednom velikom primedbom da dopunski izveštaj koji je zatražen od Komisije za zakonodavstvo da se dostavi od strane CIK-a je poslat samo na albanskom jeziku, opet ne poštujući dva službena jezika i obaveznost javnih institucija da svi izveštaji moraju biti poslati na dva službena jezika. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2011 dhe duke pasur parasysh se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar në pajtim me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, Grupi Parlamentar “6+” do ta përkrahë këtë raport pune. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë i kam dy motive për t’u inkuadruar në këtë temë. Motivi i parë është niveli i raportit të KQZ-së që më ka impresionuar, sepse është mjaft korrekt dhe ka mjaft detajime, të cilat të impresionojnë, dhe natyrisht që s’mund t’i iku dhe s’mund ta fsheh, e të mos e them publikisht - korrektësia e kryetares për 17 muaj që kemi bashkëpunuar rreth gjithë atyre problemeve që i kemi trajtuar me mjaft përkushtim.

Unë për veten time, kur ngrihet shqetësimi që i takon çështjes së shërbyesve civilë, natyrisht se nuk mund të mos inkuadrohem në debat dhe të konstatoj që çështja e kryeshefit është çështje e shërbyesve civilë, që nuk do të duhej të trajtohej nga ne, sepse aty ka edhe detaje që ne nuk i dimë.

Është një fakt që duhet ta njohim, se kryeshefi ka ofruar dorëheqje me shkrim dhe natyrisht që KQZ-ja pastaj ka vepruar në harmoni me kërkesën e ish-kryeshefit dhe natyrisht që është bërë edhe trajtimi ligjor i asaj kërkesë.

Dhe, si shembuj, do t’ merrija dy rastet e zgjedhjeve të parakohshme, rastin e zgjedhjeve në Ferizaj dhe rastin e zgjedhjeve në Kaçanik, kur ne kemi parë një impenjim të jashtëzakonshëm dhe mjaft korrekt të KQZ-së, si në raportime, ashtu edhe në analiza tjera, që janë të njohura për opinionin.

Unë për veten time do ta çmoja shumë këtë përmirësim në KQZ dhe do ta vlerësoja jashtëzakonisht lart. Njëherësh, edhe do ta inkurajoja stafin e KQZ-së që të vazhdojë me

këtë qasje dhe me këtë angazhim dhe nivel që ka manifestuar me rastin e zgjedhjeve të parakohshme në Ferizaj dhe në Kaçanik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dyshim që Komisioni Qendror Zgjedhor është një agjenci shumë e rëndësishme e vendit, një agjenci kushtetuese dhe përgjithësisht unë kam opinionin se raporti i vitit 2011 është më i mirë se ai i vitit 2010.

Ne e kemi diskutuar gjatë në Komisionin e Ligjeve, madje më shumë se dy-tri herë, dhe unë do ta mbështes këtë raport me tri sugjerime, që i kam thënë edhe në mbledhjet e Komisionit, por po i përsëris edhe në seancë plenare.

E para, tanimë ky komision duhet të jetë i përgatitur në të gjitha segmentet, edhe në segmentet teknike, edhe profesionale për administrimin e zgjedhjeve kurdo që ato kërkohen me vendime kushtetuese. Pra, nëse do të kemi cikle të rregullta të zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka më lehtë, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i autorizuar që të jetë i gatshëm sa herë që organet kushtetuese e deklarojnë nevojën e mbajtjes së zgjedhjeve.

Unë i dalloj tri faza të punës të këtij komisioni: faza në periudhën jozgjedhore; faza në periudhën zgjedhore, dhe faza në periudhën paszgjedhore, kur nevojitet administrimi i mirë i procesit zgjedhor.

Në periudhën jozgjedhore, që në vendet me demokraci të konsoliduara është 4 vjet, Komisioni Qendror Zgjedhor ka kohë të mjaftueshme për ta përmirësuar infrastrukturën për zgjedhje sa më të mira, qoftë të infrastrukturën teknike, ashtu edhe resurset humane.

Dhe unë uroj që tani Komisioni Qendror Zgjedhor ka përfunduar me të gjitha proceset e trajnimit, përgatitjes së kuadrove dhe është i gatshëm për t'u ballafaquar.

Në periudhën zgjedhore, KQZ-ja është në fazë emergjente, në një fazë kur duhet t'i tregojë kapacitetet e veta menaxhuese, kërkohet që KQZ-ja të punojë edhe më tepër që ta administrojë dhe menaxhojë më mirë procesin zgjedhor, që të jetë më efektiv, qoftë në shpejtësinë e dhënies së rezultateve e deri te administrimi dhe modernizimi i qendrës së numërimit të votave. Sepse ne e dimë që zgjedhjet e kaluara kanë qenë me plot probleme dhe pjesë e problemeve ka qenë edhe vetë KQZ-ja. E ne e dimë edhe si ka shkuar edhe procesi i numërimit në qendrat e numërimit. Nuk kanë qenë problemet vetëm në qendrat në zona, në komuna apo në vende tjera, por një pjesë e problemeve apo e parregullsive në procesin zgjedhor ka qenë pikërisht në qendrën e numërimit në Prishtinë, ku menaxhimi i rezultateve zgjedhore është dashur të pritët me muaj të tërë.

KQZ-ja duhet të kalojë nga metoda manofakturale apo manuale e administrimit të sistemit zgjedhor në metodën elektronike apo digjitale, siç e kanë bërë shumë shtete dhe unë uroj që menaxhmenti i KQZ-së të ketë kryer trajnime edhe në këtë drejtim, të ketë

aftësuar njerëz që të fillojë plotësisht administrimi elektronik i të dhënave, që nga pastrimi i listës së zgjedhësve, e deri te procesimi i të dhënave zgjedhore.

Thjesht, jam i sigurt që kjo agjenci do të ketë mjaft sfida që ta japë kontributin e vet në përmirësimin e performansës së zgjedhjeve të kaluara, sepse një nga segmentet e performansës së dobët komplet të procesit zgjedhor ka qenë edhe administrimi i ngadalshëm i procesit zgjedhor nga vetë KQZ-ja. Së paku, pjesën e vet të obligimeve që i ka KQZ-ja duhet ta plotësojë dhe të jetë i gatshëm që të mos lejojë stërgjatje, shkelje apo gabime teknike, por edhe gabime tjera, që janë bërë në procesin e kaluar të zgjedhjeve.

Prandaj, me shpresë se këto vërejtje e këto sugjerime do të merren parasysh, uroj që raporti i ardhshëm për vitin 2012, i cili si duket do të përfundojë pa cikël të zgjedhjeve, të jetë i gatshëm dhe uroj që KQZ-ja në vitin 2013 të jetë i përgatitur së paku për një cikël të zgjedhjeve të rregullta, zgjedhjet lokale, por KQZ-ja nuk duhet të befasohet nga kërkesa e institucioneve kushtetuese edhe për zgjedhje të tjera, jo vetëm në afate të rregullta, por edhe në afate kur krijohen rrethanat kushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Të tjerë të paraqitur për fjalë nuk ka. Si Kuvend ne e miratojmë raportin me vërejtjet e Komisionit Funkcional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 65 deputetë.

Me 47 vota për, 10 kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Raportin e punës të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2011, me vërejtjet e Komisionit Funkcional.

Ju njoftoj se për shkak të mungesës së kuorumit, dy ligjet që kanë të bëjnë me Fondin Monetar Ndërkombëtar mbeten për seancën e radhës.

Të nderuar deputetë,

Unë dua që para jush dhe para opinionit ta tërheq fjalën e djeshme për ministrat. Pa marrë parasysh nëse fjala ime e ndryshon apo nuk e ndryshon gjendjen, unë e tërheq fjalën.

Ju faleminderit!

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim e Lekturë